

REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E MIRËQENIES  
SOCIALE DHE RINISË



Agjencia Shtetërore  
për Mbrojtjen e të  
Drejtave të Fëmijëve

# Raporti i Implementimit të Planit të Veprimit për Fëmijë


## 2012- 2015



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



**Save the Children**



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E MIRËQENIES  
SOCIALE DHE RINISË



Agjencia Shtetërore  
për Mbrojtjen e të  
Drejtave të Fëmijëve

# Raporti i Implementimit të Planit të Veprimit për Fëmijë 2012- 2015



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



**Save the Children**

Botimi i këtij raporti u mundësua nga Save the Children

TIRANË, 2015

Ky raport publikohet në kuadër të projektit “Rritja e Investimeve Publike për realizimin e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Save the Children në partneritet me Institutin e Studimeve Bashkëkohore dhe Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

2

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Save the Children.

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e institucioneve financuese, zbatuese dhe bashkëpunuese si burim.

# Përmbajtja

---

Hyrje.....	5
Përmbledhje Ekzekutive.....	6
Të dhëna të përgjithshme mbi situatën e fëmijëve.....	10
Konteksti rregullator dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.....	16
E drejta për mbrojtje dhe përfshirje sociale .....	21
E drejta për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik.....	28
E drejta për zhvillim dhe edukim .....	44
E drejta për kujdes shëndetësor .....	53
E drejta për mbrojtje ligjore .....	60
Progresi i treguesve të Planit të Veprimit.....	67
Shtojca A Kuadri Ndërkombëtar për të Drejtat e Fëmijëve.....	88
Shtojca B Kuadri rregullator kombëtar.....	90
Shtojca C Kuadri strategjik lidhur me fëmijët.....	91

## Lista e shkurtimeve

<b>AFP</b>	Arsimit Fillestar Profesional
<b>ASHMDF</b>	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
<b>DPSHSSH</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>IEVP</b>	Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale
<b>ILO</b>	Organizata Ndërkombëtare e Punës
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>IOM</b>	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
<b>ISHP</b>	Instituti i Shëndetit Publik
<b>IST</b>	Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme
<b>KKMDF</b>	Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
<b>KSHB</b>	Komiteti Shqiptar i Birësimit
<b>LSMS</b>	Sondazhi i Matjes së Standardeve të Jetesës
<b>MAS</b>	Ministria e Arsimit dhe Sportit
<b>MDG</b>	Objektivat e Zhvillimit të Milleniumit
<b>MMSR</b>	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>NE</b>	Ndihmë Ekonomike
<b>NJDF</b>	Njësia e të Drejtave të Fëmijëve
<b>NJMF</b>	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve
<b>OBSSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetit
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>PVF</b>	Plani i Veprimit për Fëmijë
<b>SKDSH</b>	Studimit Kombëtar Demografik Shëndetësor
<b>SHSSH</b>	Shërbimit Social Shtetëror
<b>VKM</b>	Vendimi të Këshillit të Ministrave

Të gjithë fëmijët, pa asnjë dallim, gëzojnë të drejta të plota dhe në veçanti ata gëzojnë të drejtën për të qenë të mbrojtur.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, të cilën Shqipëria e ka ratifikuar që prej vitit 1992, është traktat ndërkombëtar që përcakton standardet e të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësinë e Shteteve Palë për përmbushjen e tyre. Zbatimi dhe konsiderimi në praktikë i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve është një çështje serioze dhe kërkon përgjegjshmëri dhe angazhim të qartë.

Masat e planifikuara në Planin e Veprimit për Fëmijë 2012-2015 kanë synuar realizimin e këtyre të drejtave. Plani i ka kushtuar rëndësi të veçantë realizimit të të drejtës së fëmijëve për përkujdes, për të qenë të mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit, për të gëzuar një edukim cilësor dhe gjithëpërfshirës, për të patur akses në shërbime shëndetësore cilësore dhe për të patur mbrojtje të përshtatshme ligjore. Në përfundim të periudhës 4 vjeçare të zbatimit të Planit, është e rëndësishme të bëjmë një vlerësim të arritjeve të deritanishme, mangësive në implementim dhe detyrimeve që rrjedhin për të ardhmen.

Raporti i përgatitur nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve analizon zbatimin e objektivave të identifikuar dhe situatën aktuale në të cilën gjenden fëmijët sot. Raporti tregon se janë hedhur shumë hapa përpara në promovimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, megjithatë ai identifikon dhe mangësitë dhe bën rekomandime që do t'i shërbejnë institucioneve për të orientuar veprimet e tyre në të ardhmen. Ky raport do të shërbejë si pikënisje për konceptimin e objektivave të reja të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2016-2020.

Për të ndërmarrë politika që do të jenë në interesin më të lartë të fëmijëve, është e rëndësishme që vetë fëmijët të jenë pjesë aktive e përcaktimit të të ardhmes së tyre. Pjesëmarrja e fëmijëve është një parim themelor i të drejtave të tyre, ndaj raporti i kushton një vend të rëndësishëm zërit të fëmijëve dhe botëkuptimit të tyre.

Çështjet e fëmijëve janë në vëmendjen e qeverisë më shumë se kurrë më parë. Kemi para ne procese të rëndësishme të cilat do të na mundësojnë të përmirësojmë jetën dhe mirëqenien e fëmijëve tanë. Një nga hapat kyç do të jetë ndërtimi i një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijëve, ku të gjithë institucionet dhe shoqëria kanë një rol për të luajtur për të siguruar mirëqenien e fëmijëve.

Matësi më i mirë i progresit të vendit tonë drejt rrugëtimit për në Europë është mënyra se si i trajtojmë dhe i mbrojmë fëmijët sot, dhe çfarë të ardhmeje u garantojmë atyre nesër. Pesëvjeçari i ardhshëm, do të jetë vendimtar në ndërtimin e shërbimeve, strukturave dhe sistemeve që garantojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Për këtë do të jetë e nevojshme që të krijojmë një axhendë të qartë me prioritetet kryesore për fëmijët, dhe të forcojmë rrjetin e bashkëpunimit dhe partneritetit me të gjitha institucionet në nivel qendror dhe vendor, por edhe me aktorët jopublik.

## Përmbledhje Ekzekutive

Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Fëmijë 2012- 2015 ka përqafuar një qasje të re në monitorimin e situatës së të drejtave të fëmijëve. Ai nuk kufizohet vetëm në analizën e zbatimit të objektivave të identifikuara në PVF, por hedh një vështrim më të gjerë mbi situatën e të drejtave të fëmijëve, me qëllim për të kuptuar në mënyrë sa më të plotë këtë situatë dhe problematikat e saj. Raporti ka në fokus situatën e të drejtave të fëmijëve, ndërhyrjet dhe arritjet që do të shërbejnë si bazë për planin e ri të veprimit.

Në tërësi vlerësohet se për realizimin e të drejtave të fëmijëve në vend janë ndjekur drejtimit politike të përcaktuara. Rreth 62% e masave të përcaktuara në Planin e Veprimit vlerësohet se kanë përfunduar apo dhe janë në vazhdimësi për realizimin e tyre si masa afatgjata, të cilat shkojnë përtej periudhës 4 vjeçare.

Në fushën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale janë përmbushur dhe janë në vazhdimësi si masa afatgjata rreth 70 % e masave, në fushën e mbrojtjes nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik rreth 70% e masave. Në kuadër të realizimit të të drejtës për arsim rreth 60% e masave, për të drejtën për kujdes shëndetësor 70%, ndërsa në fushën e drejtësisë për të mitur rreth 35% e masave.

Disa nga çështjet kryesore që trajton raporti kanë të bëjnë me të dhënat mbi situatën e fëmijëve, kuadrin rregullator dhe institucional, të dhëna mbi realizimin e të drejtave të fëmijëve në fushat e përmendura më sipër. Raporti është i strukturuar në mënyrë të tillë që të evidentojë arritjet në fusha të ndryshme të të drejtave. Ai nuk kufizohet vetëm në analizën e zbatimit të objektivave të identifikuara në Planin e Veprimit 2012-2015, por hedh një vështrim më të gjerë mbi situatën e të drejtave të fëmijëve, me qëllim pasqyrimin sa më të plotë të situatës dhe problematikave të saj.

Arritjet ndiqen nga rekomandimet prioritare që duhet të pasqyrohen në planin e ri të veprimit.

**Të dhënat mbi situatën e fëmijëve** tregojnë pjesërisht situatën e të drejtave të fëmijëve. Informacioni është i kufizuar, por problematika si ato të dhunës, varfërisë, shfrytëzimit të fëmijëve, etj., aksesit ndaj shërbimeve bazë janë evidente. Të dhënat identifikojnë edhe kategori më të rrezikuara apo përjashtuara si: fëmijët me aftësi të kufizuara, romë dhe egjiptianë, ata në zonat rurale.

**Në kuadrin ligjor/rregullator** raporti evidenton njohjen e protokollit opsional mbi procedurat e komunikimit, si edhe miratimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri”. Sipas kësaj rezolute Kuvendi vlerëson si shumë të rëndësishëm detyrimin e shtetit për të mbrojtur, respektuar dhe promovuar të drejtat e fëmijës, që burojnë nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës e OKB-së, konventat e Këshillit të Evropës, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe nga legjislacioni i brendshëm.

Ndryshimet e miratuara së fundmi në Kodin Penal me ligjin Nr. 144/2013, dt. 20.5.2013, ofrojnë garanci për mbrojtjen adekuate të fëmijëve nga krimet seksuale dhe shfrytëzimi ekonomik. Së fundmi është miratuar ngritja e Seksionit për të Miturit pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Ky është një lajm mjaft pozitiv në garantimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, megjithatë kjo strukturë nuk është ngritur akoma.

Në **realizimin e të drejtës për mbrojtje dhe përfshirje sociale** përfshihen kryesisht përpjekjet për përmirësimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit social për fëmijët. Deinstitutionalizimi është një nga synimet e reformës së shërbimeve sociale dhe PVF. Është hartuar draft plani i deinstitutionalizimit për fëmijët 0-6 vjeç.

Deri më tani është punuar drejt transformimit të këtyre shërbimeve në tipologji të tjera shërbimesh si shtëpi – familje. Në vitin 2012 -2013 në gjithë rrjetin e institucioneve të përkujdesit për fëmijë ekzistonin rreth 12 shërbime të llojit Shtëpi – Familje (10 nga këto shërbime ofroheshin nga OJF, ndërsa 2 ishin shërbime publike). Në vitin 2015, në institucionet rezidenciale publike dhe jo publike për fëmijë janë ngritur 26 shtëpi familje ku marrin shërbim 309 fëmijë.

**Mbrojtja e fëmijëve** nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi ka qenë në hije të politikave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për një kohë të gjatë. Me miratimin e Ligjit “Për të drejtat e fëmijëve”, u bë një hap i madh përpara, pasi për herë të parë u shpreh qartë në legjislacionin kombëtar e drejta e fëmijëve për të qenë të mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, përfshirë edhe ndaj ndëshkimit trupor. Në përmbushje të objektivave strategjike janë ndërmarrë një spektër i gjerë aktivitetesh. Si ndër më të rëndësishmet mund të përmenden ato të lidhur me përmirësimin e kuadrit rregullator.

Lehtësimi i procedurave për regjistrim dhe mbështetja e familjeve për të regjistruar fëmijët mbetet një veprimtari e rëndësishme në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve. Ndryshimet legjislative dhe masat praktike të prezantuara që prej vitit 2008<sup>1</sup> kanë kontribuar për uljen e numrit të romëve të paregjistruar, si kategori më e prekshme ndaj këtij fenomeni.

ASHMDF është fokusuar në plotësimin e kuadrit nënligjor për zbatimin e ligjit. Në bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse në ministri, ka qënë bashkëautore në hartimin e 5 VKM-ve<sup>2</sup> në zbatim të ligjit. Përmes një *udhëzimi katërmintor*<sup>3</sup> janë miratuar në 2015 ‘Mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve’.

Miratimi i *standarteve të shërbimeve të NJMF-ve*<sup>4</sup> shënoi një hap të rëndësishëm në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Standartet e punës së NJMF, do të shërbejnë për të matur dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në bashki dhe do të krijojnë bazën për inspektimin e tyre nga strukturat në nivel qendror.

1. Raporti i katërt i ECRI-t për Shqipërinë f. 28.
2. VKM Nr. 263 datë 12.04.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për bashkëpunimin midis mekanizmave institucionale dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave”  
VKM Nr. 264 datë 12.04.2012 “ Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”  
VKM Nr. 265 datë 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit”  
VKM Nr. 266 datë 12.04.2012 “ Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”  
VKM Nr. 267 datë 12.04.2012 “Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga agjencia e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor
3. Udhëzimi 10, datë 25 shkurt 2015, ndërmjet Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, Ministrisë të Shëndetësisë dhe Ministrisë të Punëve të Brendshme. Grupi ndërinstitutional për hartimin e udhëzimit është ngritur me Urdhër të ministrit të MMSR Nr.158 Prot, datë 06.08.2014.
4. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.573, datë 24.6.2015 “Për miratimin e standarteve të shërbimeve të njëjësive të mbrojtjes së fëmijëve”. Standardet, fillimisht u hartuan nga ASHMDF dhe MMSR, në bashkëpunim me një ekspert ndërkombëtar, të mbështetur nga Terre des hommes dhe më pas u diskutuan me aktorë të tjerë institucionale dhe përfaqësues të shoqërisë civile.



Për të adresuar problematikat e funksionimit të grupeve teknike multidisiplinare, ASHMDF ka ndërmarrë iniciativën për hartimin e “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e grupit teknik multidisiplinar për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie”<sup>5</sup>.

Të dhënat tregojnë për një rritje graduale të mbulimit me shërbime të NJMF dhe NJDF. Është rritur bashkëpunimi në nivel ndërinstitucional në nivel qendror dhe vendor si dhe aktorët janë më të qartë për rolin e tyre dhe detyrimet për bashkëpunim.

Bazuar në ndarjen e re territoriale, sipas Ligjit Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” si dhe duke marrë parasysh ndryshimet strukturore që do të ndodhin edhe në kuadër të Reformës së Shërbimeve Sociale, funksionimi i Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) në nivel vendor, ka nevojë të rishikohet me qëllim rritjen e efektivitetit të shërbimit të ofruar nga këto njësi.

Gjatë këtyre viteve çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në situatë rruge kanë marrë një fokus të veçantë në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve. Disa nga shërbimet e ofruara për familjet në situatë rruge gjatë menaxhimit të rasteve kanë qenë: këshillim, ofrim shërbimesh nga qendrat ditore, regjistrim i fëmijëve në shkolla, kopshte, çerdhe, pajisje me certifikata, vaksinim i fëmijëve, transferim dokumentash, paketa ushqimore, aplikim për ndihmë ekonomike, ndërhyrje për asistencë mjekësore, referim dhe ndërmjetësim për punësim në Zyrat e Punës.

**Arsimi** përbën një faktor thelbësor të zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve njerëzore, mirëqenies ekonomike, zhvillimit të vlerave universale dhe përmirësimit të cilësisë së jetës në nivel individual, familjar e shoqëror. Njohja e nevojave dhe problematikave për shërbimet e fëmijëve në çerdhe vlerësohet si një hap pozitiv, duke marrë në konsideratë ‘errësirën’ e deritanishme për shërbimin e ofruar për këtë grupmoshë, si në kuadër të frekuentimit dhe atë të cilësisë së shërbimeve të marra. Një arritje e rëndësishme në arsimin parashkollor shënon përfundimi i hartimit të Standarteve të Zhvillimit dhe Edukimit të Hershëm. MAS, MMSR dhe UNICEF kanë bashkëpunuar në përmirësimin e përfshirjes së hershme të fëmijëve Romë të moshës parashkollore në Shqipëri nën ndërhyrjen “Çdo fëmijë Rom në kopësht”.

Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar është produkt i harmonizimit të politikës arsimore të Shqipërisë dhe të politikës arsimore të Kosovës dhe ka si bosht qendror kompetencat themelore të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Në kuadër të gjithëpërfshirjes, ofrimi i shërbimit arsimor për anëtarët e komunitetit romë është mbështetur në krijimin real të mundësive të barabarta në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, duke u bazuar veçanërisht në zbatimin e “Planit Kombëtar të Veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2009-2015”, si dhe në plotësimin e rekomandimeve të seminarit mbi ndërgjegjësimin për përfshirjen e komuniteteve romë, në kuadër të integritetit të Shqipërisë në BE.

Braktisja e shkollës vazhdon të jetë shqetësuese dhe është e pranishme dukuria e fëmijëve aktualisht jashtë sistemit arsimor, çfarë ka bërë që arsimi bazë të mos frekuentohet kryesisht nga fëmijët e shtresave në nevojë. Fenomeni është më shqetësues për vajzat romë dhe për fëmijët e familjeve me të ardhura të pakta, të zonave të thella malore, për vajzat në zonat me mentalitet të prapambetur dhe me probleme të tjera sociale<sup>6</sup>.

5. Raporti i realizimit të masave të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për periudhën janar – qershor 2015

6. Dokument i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020 (Draft). MAS

Politikat e **kujdesit shëndetësor** të nënës dhe fëmijës kanë synuar përmirësimin e vazhdueshëm të treguesve të ushqyerjes dhe shëndetit të nënës dhe fëmijës me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. I gjithë shërbimi i kujdesit për shtatzaninë dhe lindjen dhe kujdesi për mirëritjen e fëmijës ofrohet pa pagesë<sup>7</sup> (përfshirë edhe gratë pa sigurim shëndetsor). Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve dhe arritjeve, sistemi i kujdesit shëndetsor, në veçanti, sistemi i kujdesit shëndetsor të nënës dhe fëmijës, përballet me probleme kritike<sup>8</sup>.

Në kuadër të bashkëpunimit të Qeverisë me OKB, për reduktimin e Kequshqyerjes për Fëmijët është miratuar “Dokumenti Strategjik i Komunikimit Për Ushqyerjen”<sup>9</sup>, nëpërmjet të cilit synohet që problemet e ushqimit, të sigurisë ushqimore të bëhen më të rëndësishme në axhendën e qeverisë.

Përqindja e fëmijëve të vaksinuar sipas kalendarit rutinë vazhdon të jetë mbi 97%. Për të gjithë fëmijët e lindur që nga 1 mars 2014 dy dozat e para të vaksinës së poliomielitit bëhen me IPV. Kjo përbën një element të rëndësishëm në lidhje me përditësimin e kalendarit me vendet e BE dhe rritjen e sigurisë të vaksinave.

Të drejtat e fëmijëve kanë pësuar përmirësime të ndjeshme përmes iniciativave dhe reformave të gjithanshme ligjore dhe institucionale, duke i afruar ato me standartet Evropiane. Ministria e Drejtësisë, së fundmi, ka përfunduar një draft të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, e cila përbën një hap të rëndësishëm në lidhje me zgjidhjen e të gjitha çështjeve ligjore që lidhen me fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijëve nën 14 vjeç si dhe fëmijët viktimë dhe dëshmitarë. Pavarësisht draftit të këtij dokumenti strategjik, sfida më e madhe në praktikë mbetet ngritja e një sistemi të drejtësisë miqësor, i cili merr parasysh si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës si dhe zbatimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse me qëllim identifikimin e hershëm të fëmijëve me sjellje delinkuente dhe trajtimin e tyre jashtë sistemit të drejtësisë.

## Metodologjia e hartimit të raportit

9

Metodologjia e raportit vlerësues është bazuar në një sërë të dhënash mbi të drejtat e fëmijëve të mbledhura nga raportet e mëparshme të zhvilluara nga ASHMDF, të dhëna administrative të institucioneve shtetërore përgjegjëse sipas masave të përcaktuara në Planin e Veprimit, informacione nga studime të shoqërisë civile duke plotësuar kështu të dhënat në lidhje me çështje specifike.

Në hartimin e raportit janë marrë parasysh edhe pikëpamjet e fëmijëve dhe prindërve, nëpërmjet konsultimeve që janë organizuar në bashkëpunim me partnerët<sup>10</sup>.

Gjetjet paraprake të raportit janë bërë subjekt i diskutimit me institucionet, të cilat kanë dhënë informacion mbi përmbushjen e të drejtave të fëmijëve. Më tej këto gjetje janë diskutuar edhe në një workshop ku kanë marrë pjesë aktorë të ndryshëm që kanë patur mundësi të njihen me të dhënat e mbledhura nga raporti. Kjo jo vetëm me qëllimin për të vlerësuar gjetjet dhe rekomandimet me anë të një procesi përfshirës, por edhe për të forcuar përgjegjshmërinë, për ta bërë raportin një dokument, i cili do t'i shërbejë reflektimit mbi masat, që duhen marrë nga këto institucione në adresimin e mangësive të identifikuara.

7. Urdhër i Ministrisë të Shëndetsisë, Nr. 528, datë. 9/10/2013.

8. Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, 2013-2014

9. Urdhërin e Ministrisë të Shëndetsisë Nr.86, dt.20.02.2012

10. Takime me fëmijët dhe prindërit: 20.07.2015 takim me të mitur në IEVP Kavajë; 21.07.2015 takim me prindërit në minibashkinë nr. 6, Tiranë; 22.07.2015 takim me fëmijët e Zëri 16+ Elbasan; 11.09.2015 takim me të rinj në Qendrën Rinore Tiranë; 18.09.2015 takim me fëmijët në institucionin e fëmijëve Sarandë.

# Të dhëna të përgjithshme mbi situatën e fëmijëve

## Të dhëna demografike

Popullsia e Shqipërisë është relativisht e re - 27% e popullatës i përkasin grupmoshës 0-18 vjeç (856, 600 fëmijë nga 3, 162, 100 në total)<sup>11</sup>. Censusi 2011 tregoi që numri i fëmijëve që jetojnë në zonat urbane është më i lartë se në zonat rurale (426,529:420,783). Shkaku kryesor për këtë është migrimi i brendshëm në masë i familjeve drejt zonave urbane gjatë 20 viteve të fundit. Në 2009, INSTAT dhe Instituti i Shëndetit Publik raportoi se një në pesë familje (21%, ose 9% e popullsisë së përgjithshme) kishte të paktën një ish pjesëtar që kishte migruar brenda Shqipërisë. Rreth dy në pesë (42%) kishin të paktën një pjesëtar që kishte emigruar.

Një tjetër tipar i rëndësishëm i lidhur edhe me emigrimin është rënia e popullsisë së përgjithshme në vite. INSTAT raporton një rënie prej 8% midis 2001 dhe 2011<sup>12</sup>. Për të njëjtën periudhë kohore, popullsia nën moshën 15 vjeç ka zbritur nga 29% (2001) në 21% (2011). Rënia e shkallës së lindshmërisë (nga 2.1 – viti 2001 në 1.7% - viti 2011) ka rezultuar në uljen e lindjeve nga 53,000 (viti 2001) në rreth 34,000 (viti 2011).

## Mbi Varfërinë

Prekshmëria nga varfëria e familjeve me fëmijë konfirmohet nga përqindja e lartë e familjeve me fëmijë nën moshën 18 vjeç – afërsisht një në pesë – që marrin ndihmë ekonomike<sup>13</sup>. Një studim i vitit 2013 duke përdorur të dhënat e Studimit të Matjes së Standarteve të Jetesës (LSMS/SMSJ) tregon se, varfëria absolute ka arritur në 14.3% në vitin 2012<sup>14</sup>. Hendeku i varfërisë për fëmijët nuk matet në Shqipëri, por hendeku i varfërisë së përgjithshme është rritur nga 2.3% në 2008 në 2.9% në 2012<sup>15</sup>.

Një vlerësim i kohëve të fundit i statusit të mirëqënies së fëmijëve në Shqipëri nga Observatori i Fëmijëve nxorri përfundimin se proporcioni i fëmijëve që jetojnë në varfëri absolute (d.m.th. që jetojnë në familje me të ardhura më pak se 125 USD në muaj) është 17.4% ose 147, 432 fëmijë.

Një prej shpjeguesve të këtij fenomeni janë shifrat e lidhura me papunësinë. Nga 2008 deri në 2013 shkalla e papunësisë është rritur respektivisht nga 12.5% në 16.9%<sup>16</sup>. Papunësia tek të rinjtë mbetet e lartë. INSTAT raportoi se, për tremujorin e parë të vitit 2014, shkalla e papunësisë tek mosha 15 deri 29 vjeç ishte 33.9%, një rritje prej 5.8% gjatë së njëjtës periudhë të 2013<sup>17</sup>.

11. Statistikat Shtetërore të UNICEF për Shqipërinë <http://www.unicef.org/infobycountry/albaniastatistics.html> (Aksesuar 20 Prill 2015)

12. INSTAT, 2011. Censusi i popullsisë dhe familjeve 2011, Tirana: INSTAT, f7.

13. Ymeri, S dhe Jorgoni, E. Analiza Buxhetore dhe Shpenzimet për Fëmijët: Rasti i Elbasanit (2013) f16 (më pas Analiza Buxhetore dhe Shpenzimet për Fëmijët)

14. INSTAT, 2013. Shqipëria: tendencat në varfëri 2002-2005-2008-2012. Tirana: INSTAT & Banka Botërore

15. Po aty, f. 3.

16. Grupi i Partneritetit i Bankës Botërore (BB), 2014. Albania program snapshot (s.l.): BB, f3

17. INSTAT, <http://www.instat.gov.al/all/themes/tregu-i-punës/publications/books/2014/rezultate-të-anketës-së-forcave-të-punës,-t4-2014.aspx> (Aksesuar 16 maj 2015)

## Shëndeti dhe ushqyerja e nënës dhe fëmijës

Treguesit e vdekshmërisë foshnjore tregojnë për një ulje me 3% në vitin 2014 nga niveli bazë i vitit 2012, raportohet që për vitin 2012 treguesit ishin 7.9 vdekje për 1000 lindje të gjalla, për vitin 2013 ishin 7.3 vdekje për 1000 lindje të gjalla dhe për vitin 2014 ishin 6.5 vdekje për 1000 lindje të gjalla<sup>18</sup>. Raportohet zvogëlim i vdekshmërisë amtare me 2% në vitin 2014 nga viti 2012:

Megjithatë, sipas Studimit Kombëtar Demografik Shëndetësor (SKDSH) 2008-2009 ekzistojnë ndryshime rajonale domethënëse për këto tregues, si për shembull vdekshmëria e fëmijëve nën pesë vjeç në rajonet malore është afërsisht dy herë më e lartë se në zonat rurale. Ndryshime domethënëse evidentohen ndër familjet që i përkasin indekseve të ndryshme pasurore, p.sh. shkalla e vdekshmërisë foshnjore dhe e fëmijëve nën pesë vjeç tek familjet që i përkasin indeksit më të ulët pasuror është 40% më e lartë sesa tek familjet në indeksin më të lartë pasuror<sup>19</sup>.

Për sa i përket aksesit në shërbimet kryesore shëndetësore, më shumë se 99 përqind e grave shtatëzëna lindin në praninë e stafit të kualifikuar mjekësor dhe 97 përqind e tyre marrin të paktën një vizitë para lindjes<sup>20</sup>. Treguesit e kujdesit antenatal gjithashtu tregojnë se gratë e varfra (indeksi më i ulët pasuror) kanë më pak mundësi për të marrë suplemente gjatë shtatëzanisë në krahasim me gratë e familjeve me indeksin më të lartë pasuror – 21% : 55% marrin suplement hekuri. Problematik shfaqet aksesit i ekzaminimit mjekësor pas lindjes kur krahasohen këto dy kategori (17-18% e nënave të varfëra nuk aksesojnë shërbimin përkundrejt 3% të atyre që i përkasin grupit më të pasur<sup>21</sup>.

Pabarazitë ndërmjet zonave urbane dhe rurale janë të dukshme në peshën e lindjes së sapolindurve, ku pesha e ulët në lindje haset në dyfishin e fëmijëve që vijnë nga familje të varfra sesa në fëmijët e tjerë.

Prevalenca e diarresë dhe infeksioneve respiratore akute – shkaku kryesor i vdekshmërisë foshnjore në Shqipëri – është më e lartë tek fëmijët nga familje në grupin me pasurinë më të ulët<sup>22</sup>. Një studim i thelluar në problematikat e fëmijëve të varfër tregon se nënushqyerja e fëmijëve të familjeve të varfra dhe statusi i tyre shëndetësor, mbeten problematike<sup>23</sup>. 56,7 përqind e familjeve në ndihmë ekonomike deklarojnë se nuk mbulojnë nevojat për ushqim dhe 88,9 përqind deklarojnë se nuk mbulojnë nevojat për shërbime shëndetësore të fëmijëve. Studimi nxjerr në pah se 29 përqind e fëmijëve që vuajnë të paktën një sëmundje kronike dhe më shumë se gjysma e fëmijëve me sëmundje kronike, janë nga familje të nivelit më të ulët të shpenzimeve. Gjithashtu rezultojnë se 50 përqind e fëmijëve që vuajnë nga sëmundje kronike dhe që nuk përfitojnë rregullisht konsultime mjekësore i përkasin familjeve të grupit më të ulët të shpenzimeve, të cilat shpenzojnë përkatësisht për kujdesin shëndetësor të fëmijëve sa 1/3 e shpenzimeve mesatare.

Fëmijët që ushqehen në përputhje me praktikën e ushqyerjes për të porsalindurit dhe fëmijës janë në nivel të ulët, vetëm 19 përqind e tyre ushqehen sipas këtyre praktikave dhe vajzat kanë

18. Statistikat administrative Ministria e Shëndetësisë 2015

19. Vokopola Z. et al. përdorimi efektiv i ndihmës ekonomike për të përmirësuar statusin shëndetësor dhe ushqimor të fëmijëve në familjet e varfëra. Instituti Kërkimor Urban/NCSS (2012), Tiranë, f. 18.

20. Statistikat administrative Ministria e Shëndetësisë 2015

21. INSTAT dhe ISHP (2009) Studimi Kombëtar Demografik Shëndetësor 2008-2009

22. Po aty, f. 18.

23. UNICEF, Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Qendra Kombëtare të Studimeve Sociale dhe Instituti i Kërkimeve Urbane (2012) "Reformimi i ndihmës ekonomike: Nga mbijetesa tek investimi në reduktimin e varfërisë", Tiranë

më pak gjasa se sa djemtë të ushqehen sipas tri praktikave të rekomanduara të ushqyerjes së të porsalindurve dhe fëmijëve<sup>24</sup>. Po kështu fëmijët në zonat rurale dhe ato që i përkasin indeksit të ulët pasuror kanë më pak gjasa se ato në zonat urbane dhe të indeksit të lartë të pasurisë që të ushqehen në përputhje me këto praktika.

Një vlerësimi i fokusuar tek obeziteti i fëmijëve në 2013<sup>25</sup> tregon sipas vlerave kufi të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, se 21.6 % e fëmijëve 7-10 vjeç janë mbipeshë dhe 7.7% e tyre janë obezë. Prevalenca e mbipeshës është dukshëm më e lartë te fëmijët e moshës 8-9 vjeç, në zonat urbane në raport me zonat rurale dhe tek meshkujt në raport me femrat. Një vlerësim tjetër<sup>26</sup> që fokuson grupmoshën e fëmijëve 11-15 vjeç raporton se 3.2% e tyre klasifikohen si obezë.

Rasti i parë i diagnostikimit të një fëmije me HIV/AIDS ishte në vitin 1997. Deri në maj 2015 janë raportuar 39 fëmijë të infektuar me HIV/AIDS. Rrugët e infektimit janë nëpërmjet transmetimit vertikal nga nëna tek fëmija dhe nëpërmjet transfuzionit të gjakut.

Treguesit e shëndetit mes popullatës Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri janë më të ulët sesa të pjesës tjetër të popullsisë. Shkaqet janë të lidhura me varfërinë, kushtet e vështira të jetesës, mundësinë e kufizuar për të përdorur shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor, nivelin e ulët arsimor dhe mungesën e infrastrukturës. Një vlerësim i fundit me fokus fëmijët Romë 0-6 vjeç evidenton se largësia nga Qendrat Shëndetësore është një faktor që vështirëson aksesin. 14,4% e qendrave shëndetësore janë mbi 2 km distancë nga vendbanimet Rome. 61.7% e fëmijëve kanë marrë vaksinat sipas kalendarit, për rreth 17% të fëmijëve stafi shëndetësor nuk ka informacion mbi statusin e vaksinimit të fëmijëve. Në rreth 68.8% të rasteve fëmijët gëzojnë shëndet të mirë, por kjo nuk qëndron për 5.4% të tyre<sup>27</sup>.

## Zhvillimi dhe Edukimi

12

Numri i çerdheve dhe fëmijëve që frekuentojnë këtë shërbim është i paraportuar në nivel kombëtar nga pushteti vendor<sup>28</sup>. Vlerësimet mbi shërbimin evidentojnë problematika të lidhura me mungesën e një kornize të mirëorganizuar dhe të përditësuar; kushte të papërshtatshme për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve si edhe mungesë të standarteve të cilësisë së kujdesit.

Të dhënat për përfshirjen/aksesin e fëmijëve në kopshte, shifrat e raportuara variojnë, 33% (LSMS 2012), dhe 76% (INSTAT, 2013). Sipas burimeve të LSMS (2012), arsyet kryesore që prindërit nuk i regjistrojnë fëmijët në kopsht vjen nga besimi se ata janë akoma të vegjël (21%), mungesa e kopshteve (23%), se është më mirë për ta kujdesi në familje (35% e prindërve), veçanërisht kjo e shprehur tek prindërit me fëmijë 3-4 vjeç. Për sa kohë zgjedhja prindërore predominon si arsye për mosndjekjen e kopshteve nga fëmijët, është evidente mungesa e të kuptuarit nga ana e tyre e rëndësisë së programeve të zhvillimit dhe edukimit në këtë moshë. Kjo është analizuar në varësi të nivelit të edukimit të nënave – 51% e fëmijëve me nënat që kanë përfunduar arsimin bazë ndjekin

24. INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik (2010) "Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri 2008-2009, Shqipëri

25. Jolanda Hyska J., Burazeri G., Mersini E. (2013) "Vlerësimi i obezitetit në moshën femërore", Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, United Nations, Tiranë.

26. Qirjako G., Burazeri G., Mihali E., Bukli M., Agolli E. (2014) "Sjelljet e shëndetshme tek fëmijët e moshës shkollore 11, 13, 15 vjeç" UNFPA, UNICEF Shqipëri.

27. Hazizaj A., Elezi P., Ballo M., Vlerësim Kombëtar 2014: Aksesit i fëmijëve romë në Shërbimet e edukimit dhe shëndetësisë në Shqipëri, UNICEF / CRCA / YWCA / Observatori, Tirana 2014.

28. VKM Nr. 267, datë 12.04.2012 "Llojet dhe mënyrën e shkëmbimit të informacionit e të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF-ja e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor"

edukimin parashkollor në krahasim me 83% e fëmijëve me nënat që kanë përfunduar nivele më të larta arsimore<sup>29</sup>.

Përqindja e fëmijëve të grupmoshës 3, 4, dhe 5 vjeç jashtë sistemit parashkollor është përlogaritur për vitin 2012 respektivisht 86.8%, 69.3% dhe 41.5%<sup>30</sup>.

Të dhënat<sup>31</sup> e Censurit të 2011 tregojnë një përfshirje pothuajse prej 100% në arsimin bazë dhe një përqindje të braktisjes së shkollës në shkallë vendi prej më pak se 1%. Megjithatë, shifrat reale të lënies së shkollës mund të jenë deri në 2.5 herë më të larta sesa ato të raportuara zyrtarisht, për arsye se drejtuesit e shkollave shpesh raportojnë shifra më të ulëta të lënies së shkollës për të shmangur reduktimin e stafit të mësuesve<sup>32</sup>. Statistikat zyrtare gjithashtu tregojnë përqindjet<sup>33</sup> e lënies së shkollës për fëmijët romë prej rreth 4% dhe 3.4% për fëmijët egjiptianë dhe deri në 7% për fëmijët me aftësi të kufizuara. Përqindja neto e përfshirjes (NER) në edukimin bazë për këtë arsye raportohet në 86% me një shifër pak më të ulët (82%) për vajzat<sup>34</sup>. Ndërkohë që vlerësimi PISA në 2012 tregoi një progres prej 12 pikësh nga 2009, Shqipëria u rendit e 57-ta nga 65 vende pjesëmarrëse pas Malit të Zi (54), Bullgarisë (47) dhe Serbisë (43) dhe rreth 100 pikë (20%) poshtë mesatares OECD në Matematikë, Lexim dhe Shkencë.

## Dhuna dhe siguria e fëmijëve

Fëmijët në Shqipëri përballen me forma të ndryshme të dhunës në familje, në shkollë në komunitet. Një studim<sup>35</sup> i OBSH-së në 2012 zbuloi se prevalenca e abuzimit fizik dhe seksual gjatë 18 viteve të para të jetës ishte përkatësisht 41.5% dhe 6% .

Dhuna psikologjike është forma e dhunës, që raportohet më së shpeshti nga fëmijët<sup>36</sup>. Rreth 61,69% e fëmijëve kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës psikologjike një herë në jetën e tyre. Por po aq e lartë është edhe dhuna fizike; 48,42% e fëmijëve kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës fizike gjatë jetës së tyre dhe 59,45% e fëmijëve raportojnë se kanë përjetuar dhunë fizike gjatë vitit të kaluar. 11.4% e fëmijëve kanë përjetuar ngacmim seksual dhe 4.88% e fëmijëve dhunë seksuale me kontakt, të paktën një herë gjatë jetës së tyre.

Sipas një studimi të fundit mbi sigurinë e fëmijëve online<sup>37</sup>, 85% e fëmijëve 13-18 vjeç kanë akses në internet nëpërmjet një kompjuteri në shtëpi, që në shumicën e rasteve gjendet në dhomat e tyre. Internet kafetë janë gjerësisht të aksesueshme si në zonat rurale dhe ato urbane. 44 % e fëmijëve përdorin internetin për të shikuar material pornografik çdo ditë. Vetëm gjatë vitit të fundit 47 % e 13-18 vjeçarëve janë kontaktuar në internet nga persona të panjohur që në 40 për qind të rasteve, ishte një i huaj. Vërehet nivel i ulët i informimit të fëmijëve lidhur me shkëmbimin e informacionit të sigurt në internet dhe strukturave përgjegjëse ku duhet të raportojnë incidentet online. Familjarët dhe miqtë janë personat e parë ku fëmijët raportojnë një problem, ndërkohë që mësuesit dhe punonjësit e policisë janë figurat që ka më pak të ngjarë që fëmijët të drejtohen për ndihmë e të raportojnë.

31. INSTAT, op. cit., f. 78.

32. UNICEF, Profili i Shtetit 2010, cituar në Analiza e situatës së të drejtave të fëmijëve. Save the Children (2012), Tiranë.

33. Plani i aksionit për lënien e shkollës. MES (2011), Tiranë.

34. Analiza e situatës së të drejtave të fëmijëve. Save the Children (2012), Tiranë.

35. Qirjako G. et al. Community survey on prevalence of adverse childhood experiences in Albania. WHO (2013), Copenhagen.

36. Cenko E., Hazizaj A., Haxhiymeri E., Çoku B. (2013), Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri. Studimi Epidemiologjik në Ballkan mbi Abuzimin e Fëmijëve dhe Neglizhencën (BECAN), CRCA Shqipëri, Tiranë.

37. Studim për sigurinë në rrjet të fëmijëve, World Vision (2014)

## Fëmijët që punojnë

Sondazhi i parë kombëtar për fëmijët që punojnë, i kryer në maj të 2010 (publikuar maj 2013), tregoi se 7.7% e të gjithë fëmijëve shqiptarë të moshës 5-17 vjeç punojnë<sup>38</sup>. I njëjti burim dëshmon se numri total i fëmijëve 16-18 vjeç që punojnë, duke përfshirë edhe ata që punojnë në mënyrë informale, mund të arrijë në disa mijëra.

Sidoqoftë, të dhënat zyrtare mbi fëmijët që punojnë në rrugë mungojnë. Studimi kombëtar për fëmijët në situatë rruge<sup>39</sup> llogariti që shifrat aktuale janë në ekstremin më të lartë: midis 2000 dhe 2500 fëmijë. Fëmijët në Tiranë përbëjnë proporcionin më të lartë (31.5%) të 12 qarqeve në Shqipëri (i dyti me vlerat më të larta ishte Durrësi me 18.6%).

Sipas të njëjtit burim 7.7% e të gjithë fëmijëve shqiptarë të moshës 5-7 vjeç punojnë dhe se mbi 5% janë punëtorë krahu, të cilët punojnë në aktivitete ekonomike të rrezikshme, me orë të tejzgatura dhe në kushte pune të rrezikshme.

## Fëmijët e trafikuar apo në rrezik trafikimi

Sipas Koordinatorit Kombëtar Antitrafik numri i fëmijëve të trafikuar në vitin 2012 ka qenë 26 fëmijë. Për vitin 2013 kjo shifër ka qenë 43 fëmijë dhe për vitin 2014 numri i fëmijëve të trafikuar është 62 fëmijë.

Organizatat që punojnë me viktimat e trafikimit raportojnë se të rriturit dëshmojnë për fillimin e trafikimit të tyre që në vegjëli. Ka raportime për prindër dhe pjesëtarë të tjerë të familjes që i martojnë vajzat për trafikim ose i detyrojnë fëmijët e tyre të lypin.<sup>40</sup>

14

Vetëm për vitin e fundit (shtator 2013-shtator 2014) 60 referime janë bërë në gjykatë për trafikimin e të rriturve dhe fëmijëve dhe 58 referime në zyrat e prokurorive të rretheve për “shfrytëzim për prostitucion”. Në 2013, Gjykata e Krimeve të Rënda lëshoi shtatë vendime për shkelje për trafikimin e të rriturve, grave dhe fëmijëve. Dhjetë persona u dënuan (nuk ka informacion për kombësinë ose gjininë e tyre)<sup>41</sup>.

## Fëmijët në konflikt me ligjin

Gjatë vitit 2013 numri i fëmijëve të denoncuar, bazuar në statistikat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka qenë 1437 në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2014 vetëm 123 raste.

Numri i fëmijëve të dënuar në vite tregon se ka një tendencë në rritje të problematikës, sidomos nga viti 2012 në vitin 2013, nga 380 në 624 fëmijë të dënuar. Ata janë kryesisht djem të dënuar për vepra penale, ndonëse dënimet për kundravajtje kanë ardhur duke u rritur. Vepra penale dominuese e kryer nga të miturit është vjedhja e ndjekur nga posedimi dhe shpërndarja e lëndëve narkotike.

38. EC, 2013, f33. Op cit

39. Sondazhi kombëtar i përbashkët i Save the Children dhe UNICEF në 2014, në partneritet me MMS

40. Arsis et al *Studimi Kombëtar për Situatën e Fëmijëve në situatë rruge*. Tirane: UNICEF, Save the Children

41. <http://www.punetebrendshme.gov.al/all/te-rejat/fjalime/gjebrea-trafikimi-i-personave-eshte-krim-bashkohu-dhe-ti-per-ta-ndalur-ate&page=5> (Aksesuar 24 maj 2015, të dhëna nga 18 tetor 2014)



Numri i të miturve në parburgim mbetet shqetësues. Nga statistikat e Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve rezulton se në vitin 2014, numri mesatar i fëmijëve në parburgim çdo muaj është rreth 96 dhe numri mesatar i fëmijëve që vuajnë dënimin me burgim çdo muaj rreth 14.

Raportohet se periudha e parburgimit përgjithësisht i kalon 6 muajt. Për më tepër shumica e të miturve ndodhet në parburgim për vjedhje ose krime ndaj pronës private.

## **Fëmijët Romë dhe me Aftësi të kufizuar**

Gjithashtu është e qartë se në Shqipëri, ashtu si në të gjitha shoqëritë, fëmijët brenda disa grupeve të popullsisë dhe kategorish sociale janë më të cënuar sesa të tjerët.

Treguesit kryesorë për fëmijët e komunitetit rom janë që ata kanë pesë herë më shumë gjasa të jenë duke jetuar në varfëri në krahasim me fëmijët që nuk janë pjesë e këtij komuniteti; ata kanë katër herë më tepër gjasa për të qenë nën-peshë; ata kanë gjasa 50/50 për të përfunduar arsimin bazë dhe vetëm një në gjashtë kanë gjasa të përfundojnë arsimin e mesëm. Fëmijët romë gjithashtu kanë më pak gjasa sesa fëmijët e tjerë për spektrin e plotë të vaksinimit dhe një e treta e vajzave romë kanë gjasa të marthohen përpara moshës tetëmbëdhjetë vjeçe. Pa ndërhyrje të qëndrueshme, të vazhdueshme dhe të shënjestruara për të rritur standartet e jetesës për fëmijët romë, ata kanë mjaft gjasa që të rrisin fëmijët e tyre në të njëjtën gjendje varfërie dhe deprivimi si prindërit e tyre<sup>42</sup>.

Sipas të dhënave të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), për vitin 2014 janë nën skemën e përfitimit të pagesave të aftësisë së kufizuar 17,777 fëmijë. Problematike për këtë kategori mbetet mungesa e një vlerësimi koherent dhe të përshtatshëm të nevojave të tyre. Duke marrë parasysh numrin e limituar të fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkolla, kopshte dhe qendra ditore, supozimet janë që pjesa më e madhe e fëmijëve me aftësi të kufizuar qëndrojnë në shtëpi dhe familjeve u duhet të kompensojnë mungesën e mjediseve ose shërbimeve publike për fëmijët me nevoja të veçanta. Ndërkohë që këta dy grupe ndajnë shumë karakteristika të përbashkëta me të gjitha familjet e varfëra në Shqipëri, nivelet më të larta të stigmës dhe përjashtimit social me të cilat ata përballen i shtohen vështirësive me të cilat ata përballen si pasojë e deprivimit dhe varfërisë nga të ardhurat<sup>43</sup>.

42. Byrne, K. 2014. "Analiza e politikave dhe reformave mbi situatën e fëmijëve në Shqipëri". Tirane: UNICEF Albania (draft)

43. Po aty.



# Konteksti rregullator dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

## Kuadri Rregullator

Shqipëria ka ratifikuar konventat dhe protokollet kryesore të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës (*Shtojca A*), të cilat theksojnë, se fëmijët gëzojnë të drejta të plota dhe për shkak të veçorive, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore.

Kushtetuta e Shqipërisë siguron për mbrojtjen e të drejtave pavarësisht nga mosha dhe specifikisht për nevoja të veçanta të fëmijëve. Artikulli 122 specifikon se konventat ndërkombëtare kanë fuqi superiore mbi legjislacionin në vend. *Shtojca B* pasqyron legjislacionin shqiptar që mbështet/prek të drejtat e fëmijëve.

Me vendim Nr. 63 datë 26.11.2013 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar **Rezolutën “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri”**. Sipas kësaj rezolute Kuvendi vlerëson si shumë të rëndësishëm detyrimin e shtetit për të mbrojtur, respektuar dhe promovuar të drejtat e fëmijës, që burojnë nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës e OKB-së, konventat e Këshillit të Evropës, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe nga legjislacioni i brendshëm. Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë angazhohen për të përmirësuar legjislacionin në mbrojtje të fëmijëve, për të nxitur dhe monitoruar qeverinë, veprimtarinë e institucioneve dhe mekanizmave të zbatimit të ligjit, që bëjnë të mundur mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

16

Për t'u përmendur janë ndryshimet e miratuara në Kodin Penal me ligjin Nr. 144/2013, dt. 20.5.2013, të cilat ofrojnë garanci për mbrojtjen adekuate të fëmijëve nga krimet seksuale dhe shfrytëzimi ekonomik. Këto ndryshime e sjellin legjislacionin penal shqiptar në linjë me legjislacionin ndërkombëtar, në veçanti me Konventën e Këshillit të Evropës (Lanzarote) “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”<sup>44</sup>.

Tek Neni 1 shtohen fjalët “*të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve*”. Gjithashtu në Nenin 50, bëhen këto ndryshime: “*e/1) kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje;*”. Ligjvënësi ndër të tjera, ka vendosur që të forcojë masën e dënimit për krimin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve, vepër e cila nga 15 vjet burg tashmë dënohet me 25 vjet burg. Në Kod është shtuar edhe një vepër e re penale Neni 107, që ka të bëjë me dhunën me natyrë seksuale, ndërkohë që Neni 108 është ndryshuar i gjithi për të ofruar një mbrojtje nga krimet seksuale për fëmijët e moshës 14 -18 vjeç. Po në këtë vepër penale është përfshirë edhe tentativa për të takuar fëmijën për të patur marrëdhënie seksuale me të. Një shtesë tjetër në Kod është edhe ngacmimi seksual, përfshi edhe fëmijët, në paragrafin e ri C të Nenit 108 të Kodit Penal. Një rregullim të plotë ligjor ka pësuar edhe pornografia e fëmijëve në Nenin 117 të Kodit Penal, i

44. Ligji Nr. 10071, datë 9.2.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës (Lanzarote) “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”

cili në ndryshimet e tij të fundit, e konsideron edhe posedimin, rekrutimin e një serë formash të tjera të pornografisë së fëmijëve si një krim.

Po ashtu një zgjidhje adekuate është gjetur edhe për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik. Neni 124, paragrafi C i Kodit, është përmirësuar, duke përfshirë të gjithë format e shfrytëzimit të fëmijëve. Neni i ri thotë: “Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”

Në respektim të bazës ligjore, një sërë strategjish, plane veprimi dhe programe janë hartuar të cilat adresojnë çështjet e fëmijëve. *Shtojca C* pasqyron një përmbledhje të atyre më kryesore.

## **Kuadri Institucional**

Në ligjin Nr. 10347 datë 4.11.2014 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” përcaktohen cilat janë mekanizmat institucionalë në nivel qendror dhe vendor dhe mënyrën e bashkëveprimit të tyre për të siguruar realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

**Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve** (KKMDF) është organ këshillimor ndërministror ad hoc<sup>45</sup>. KKMDF nëpërmjet një qasjeje të koordinuar ndërsektoriale synon bashkëpunimin si nga institucionet shtetërore por edhe nga shoqëria civile për të punuar më fort për respektimin dhe në realizimin e të drejtave të fëmijëve. Në përbërje të KKMDF janë 9 ministra, përfaqësues nga Avokati i Popullit, Shoqata e Bashkive dhe 2 përfaqësues nga shoqëria civile. Këta të fundit përzgjidhen pas një procesi konkurimi të hapur dhe kanë mandat 4 vjeçar.

Në 3 Shtator 2012 u mbajt mbledhja e parë e KKMDF ku u diskutuan problematikat për njohjen dhe zbatimin e kuadrit rregullator për të drejtat e fëmijëve<sup>46</sup>, koordinimi ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor për zbatimin e PVF 2012-2015. Gjatë takimit u diskutuan gjithashtu dhe problematikat e shtrirjes së shërbimit të NJMF në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.

Në mbledhjen e dytë, në 3 tetor 2014, KKMDF diskutoi për domosdoshmërinë e ndërmarrjes së nismave konkrete për të respektuar të drejtat dhe jetën e fëmijëve në Shqipëri, si edhe sfidat për realizimin e këtyre të drejtave. Duke marrë në konsideratë situatën në vend, rekomandimet e Raportit Periodik Universal dhe treguesit e prioritetit 5 (Udhërrëfyeni për Integrimin Evropian), u evidentuan përparësitë në ndërhyrje të lidhura me fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë miratimin e Protokollit për Mbrojtjen dhe Kujdesin për Fëmijët, buxhetimin me fokus fëmijët dhe koordinimin funksional të strukturave vendore.

Në mbledhjen e tretë të KKMDF, në 8 korrik 2015, një ndër çështjet e diskutimit ishte dhe rasti i dhunës së ushtruar në shtëpinë e fëmijës Shkodër dhe nevojën për një monitorim të shërbimeve nga struktura vendore. Disa nga çështjet që dolën gjatë këtij takimi kishin të bënin me reformën

45. I ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr. 238, dt 11.12.2013 “Për krijimin e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”.

Këshilli kryesohet nga Ministri i MMSR dhe përbëhet nga: Ministri i Punëve të Brendshme; Ministri i Arsimit dhe Sportit; Ministri i Drejtësisë; Ministri i Shëndetësisë; Ministri i Integritimit Evropian; Ministri i Financave; Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore; Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit; Avokati i Popullit; 1 përfaqësues nga Shoqata Kombëtare e Bashkive; 2 përfaqësues nga shoqëria civile.

46. Ligji Nr 10347 datë 4.10.2010, VKM Nr. 263, 264, 265, 266 të miratuara në fillim në 2012

territoriale dhe një strukturë të mirëmennduar të shërbimeve sociale pranë bashkive të reja, zhvillimi i mëtejshëm i planit të veprimit për fëmijët në situatë rruge, krijimi i një regjistri të krimeve seksuale, mundësia e krijimit të gjykatës apo seksioneve për të miturit, ofrimi gjithmonë e më shumë për të miturit i formave të zgjidhjes alternative me qëllim që të miturit të mos shkojnë në burg.

**Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës** është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili koordinon me të gjitha ministritë përgjegjëse çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Për arsye të rolit dhe funksionit që kanë ministrat në kabinetin qeveritar, në qeverinë aktuale këtë pozicion e mban Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (MMSR), i cili, nëpërmjet strukturës politikbërëse që ka për këtë qëllim harton politika dhe programe shtetërore në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, dhe nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Nismat e shumta që janë ndërmarrë me iniciativën e Ministrit të MMSR janë shtjelluar në kapitujt përkatës e veçanërisht në kapitullin e mbrojtjes sociale. Gjatë kësaj periudhe Ministri i MMSR i ka dhënë prioritet dëgjimit të zërit të fëmijëve për çështje që i përkasin atyre dhe kanë ndikim në jetën e fëmijëve. Ministri në bashkëpunim me Agjencinë<sup>47</sup> gjatë periudhës 2013-2014 ka organizuar 5 takime e dëgjesa me fëmijë të moshave dhe grupeve të ndryshme të interesit, me të cilët kanë diskutuar rreth shqetësimeve të tyre, por edhe për çështje të rëndësishme, si buxhetimi i aktiviteteve dhe shërbimeve të nevojshme për realizimin e të drejtave të fëmijëve për vitet 2014 dhe 2015.

**Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF)** është institucion, në varësi të MMSR. Ky është institucioni kyç i cili ka për qëllim monitorimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si dhe koordinimin e veprimeve mbi mbrojtjen e fëmijëve. ASHMDF u plotësua me staf dhe filloi funksionimin në fund të majit 2011. Aktualisht pranë ASHMDF ka një staf prej 7 persona.

ASHMDF është fokusuar në plotësimin e kuadrit nënligjor për zbatimin e ligjit. Në bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse në ministri, ka qënë bashkautore në hartimin e 5 VKM<sup>48</sup> në zbatim të ligjit dhe një nga aktorët më të rëndësishëm për hartimin e PVF 2012-2015.

- 
47. 13 dhjetor 2013, Dëgjese më fëmijët për buxhetin e MMSR, për çështjet e fëmijëve, në MMSR  
19 nëntor 2013, Takim i ministrave të MMSR, MSH, MAS, MB me fëmijët dhe diskutim mbi problematikat që i shqetësojnë ata, në MMSR  
27 maj 2014, Seancë dëgjimore me fëmijët dhe deputetët e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në Kuvendin e Shqipërisë,  
1 Qershor 2014, Takim dhe diskutim me fëmijët i ministrit të MMSR, në kuadër të 1 Qershorit  
19 Nëntor 2014, Dëgjese me fëmijët dhe Ministrin e MMSR, zëvendësministren e MAS, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, për buxhetin 2015
48. VKM Nr. 263 datë 12.04.2012 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për bashkëpunimin midis mekanizmave institucionale dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave"  
VKM Nr. 264 datë 12.04.2012 "Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve"  
VKM Nr. 265 datë 12.04.2012 "Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e proçedimit"  
VKM Nr. 266 datë 12.04.2012 "Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qëndror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës"  
VKM Nr. 267 datë 12.04.2012 "Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga agjencia e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qëndror dhe vendor"

Një prej prioriteteve kryesore të ASHMDF ka qenë **ndërtimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve** me vizionin për të shkuar drejt një sistemi që ofron mbështetje, sipas një qasje multidisiplinare për plotësimin e nevojave të fëmijës dhe familjes. ASHMDF ka drejtuar procesin e hartimit të Udhëzimit 4-Ministror Mbi Procedurat për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Standarteve të Shërbimit të Ofruar nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve.<sup>49</sup>

ASHMDF ka zbatuar, në bashkëpunim me partnerët e saj, një sërë aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve të njësive për fëmijët në nivel vendor (NJMF dhe NJDF) si dhe përfundimit të ndërhyrjes multidisiplinare, për të siguruar mbrojtjen e vazhdueshme të të gjithë fëmijëve. Aktualisht po zhvillohet një plan kombëtar për të ngritur kapacitetet e të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e mbrojtjes së fëmijëve dhe grupeve multidisiplinare, në njësitë e reja administrative.

ASHMDF ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e Planit të Veprimit dhe të situatës së të drejtave të fëmijëve, duke reflektuar situatën përmes raporteve vjetore të publikuara.

Bazuar edhe në funksionet e saj, ASHMDF ka punuar për sensibilizimin dhe mobilizimin e aktorëve të ndryshëm publike dhe jopublike në nivel qendror dhe vendor lidhur me ligjin e ri për të drejtat e fëmijëve dhe Planin e Veprimit për Fëmijë.

ASHMDF i ka dhënë më shumë rëndësi në 2013-2015 rritjes së ndërgjegjësimit të përgjithshëm mbi të drejtat e fëmijëve dhe përfundimit të mekanizmave të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të fëmijëve në vendimmarrje në nivel qendror, për të sjellë zërin e fëmijëve pranë institucioneve dhe autoriteteve përgjegjëse për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

ASHMDF ka përmbushur gjithashtu detyrimin ligjor të saj, lidhur me raportimet ndërkombëtare mbi çështjet e të drejtave të fëmijëve. ASHMDF mori pjesë në delegacionin që u paraqit në Gjenevë në prill 2014 në kuadër të Mekanizmit të Raportimit Periodik Universal (UPR) dhe ju përgjigj pyetjeve mbi të drejtat e fëmijëve, që zunë një vend të rëndësishëm në shqetësimet e ngritura nga vendet anëtare të Këshillit të të Drejtave të Njeriut.

Kryetarja e ASHMDF përfaqëson shtetin Shqiptar dhe ka raportuar pranë Komitetit Monitorues të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual, Komiteti i Lanzarotes. Që prej prillit 2014, Shqipëria është anëtare e Bordit Drejtues të Komitetit të Lanzarotes.

Së fundmi, Kryetarja e ASHMDF ka përfaqësuar Shtetin Shqiptar në Komitetin, që do të hartojë Strategjinë e re të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve, ku është përzgjedhur në vendin e Zv. Presidencës së Komitetit.

Nëpërmjet Ligjit Nr. 155/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit është miratuar ngritja e Seksionit për të Miturit pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Ky përbën një hap mjaft pozitiv në garantimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, pasi më në fund edhe vendi ynë ka një zyrë të veçantë pranë Avokatit të Popullit, që do të mund të presë ankesat për të drejtat e fëmijëve dhe të bëjë monitorim të pavarur mbi shkeljet e këtyre të drejtave.

49. Me shume mbi kete do te permbaje kapitulli i dyte.

**Njësitë e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijës** (NJDF dhe NJMF) janë struktura të nivelit vendor, të cilat përgjigjen për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimin e rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme, që veprojnë në nivel vendor. Institucionalizimi i strukturave për fëmijët në nivele të ndryshme të qeverisjes vendore ka qenë një nxitje e rëndësishme në marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e fëmijëve. Vëzhgimet në terren dhe diskutimet me grupet e ndryshme të interesit tregojnë se pas ngritjes së NJDF në qarqe ka pasur ndryshime cilësore në perceptimin e të drejtave të fëmijëve nga institucionet dhe shoqëria, si dhe një rritje të bashkëveprimit dhe bashkërendimit institucional edhe pse jo me të njëjtin ritëm në të gjithë vendin.

NJMF-të funksionojnë brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës, si njësi të posaçme ose si njësi të strukturave të ngarkuara me çështje sociale dhe kanë për detyrë, të identifikojnë dhe menaxhojnë rastet e fëmijëve në rrezik, që ndodhen brenda zonës ku kjo njësi shtrin juridiksionin e saj. AMSHDF ka patur në fokus zhvillimin e shërbimeve të NJMF-ve përmes një qasjeje sistemike, duke krijuar mekanizma që të mund të identifikojnë dhe referojnë dhunën e fëmijëve në të gjitha kontekstet ku ajo ndodh apo ku identifikohet, në familje, në shkolla, në institucione, etj.

## E drejta për mbrojtje dhe përfshirje sociale

E drejta për mbrojtje dhe përfshirje sociale është një nga të drejtat themelore, përcaktuar edhe nga instrumente të rëndësishëm ndërkombëtar. Politikat kombëtare për mirëqenien e fëmijëve kanë në fokus uljen e varfërisë, pabarazisë dhe mbështetjen e familjes që të sigurojnë përfshirjen sociale dhe të garantojnë një standard jetese në përmbushje me të drejtat e fëmijëve.

PVF 2012 – 2015 parashtron një perspektivë të gjerë të ndërhyrjeve për të përmirësuar mbrojtjen dhe përfshirjen e fëmijëve. Ai përmban kryesisht përmirësimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit social për fëmijët. Masat janë bazuar si në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale dhe në Dokumentin e Politikave të Përfshirjes Sociale.

Miratimi i PVF u shoqërua me hartimin e 7 strategjive rajonale për të drejtat e fëmijëve, me miratimin nga këshillat e qarqeve<sup>50</sup>. Këto strategji kishin për synim identifikimin e ndërhyrjeve specifike, bazuar në situatën aktuale të fëmijëve në rajone. Raporte vlerësimi mbi zbatueshmërinë e strategjive janë zhvilluar vetëm nga dy qarqe, Fier dhe Shkodër për vitet 2013, 2014<sup>51</sup>. Nuk ka informacion të saktë për zbatimin, monitorimin apo vlerësimin e këtyre strategjive. Në përgjithësi, raportohet vështirësi për hartimin e strategjive rajonale, duke patur parasysh mungesën e të dhënave ndihmëse me fokus fëmijët<sup>52</sup>.

MMSR ka prezantuar për miratim Strategjinë e Mbrojtjes Sociale bashkë me Planin e Veprimit 2015-2020, pas një konsultimi të gjerë me grupet e interesit dhe shoqërinë civile. Kjo strategji adreson çështjet që kanë të bëjnë me (i) pagesat e ndihmës sociale (të ndihmës ekonomike dhe asaj të aftësisë së kufizuar), (ii) shërbimet e përkujdesit shoqëror (për ekzistueset dhe ato që propozohen në të ardhmen), dhe (iii) çdo çështje tjetër të rëndësishme në lidhje me këto fusha.

Në dokumenta të ndryshëm politikë, përfshirë PVF nënvizohet domosdoshmëria për vëmendje të vecantë mbi nevojat e fëmijëve në programin e Ndihmës Ekonomike (NE), me qëllim që ky program të ndikojë në zbutjen e varfërisë dhe parandalimin e fenomeneve sociale negative që rrisin përjashtimin e fëmijëve të varfër.

Në qershor 2014 u zbatua pilotimi i skemës së re të NE në tre qarqe - Tiranë, Durrës dhe Elbasan, në të cilat banon afërsisht 40% e popullsisë së vendit. Kjo reformë synon të përmirësojë barazinë dhe efikasitetin e NE dhe në këtë mënyrë, të kontribuojë në reduktimin e varfërisë dhe vulnerabilitetit.

Skema e NE gjithashtu synon që të përmirësojë disa nga kushtet e mirërritjes së fëmijëve<sup>53</sup>. Kështu, fëmijët e familjeve të varfra, të përfshira në skemën e NE, marrin një pagesë shtesë prej 300 lekë në muaj gjatë periudhës që ndjekin shkollën dhe 100 lekë për çdo vaksinë të kryer sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit.

50. Raporti i ASHMDF, Raporti Vjetor i Monitorimit të Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015, Qershor 2012 - Maj 2013

51. Rishikim Afatmesëm i Treguesve të Progresit të Planit Kombëtar të Veprimit të Fëmijëve 2012 – 2015, Save the Children, ASHMDF, 2014

52. Qendra Kombëtare për Studime Sociale "Harta e përditeësuar e shërbimeve të kujdesit social" (2013) Tirana: NCSS & UNICEF

53. Sipas VKM Nr. 376, datë 11.6.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 787, datë 14.12.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", të ndryshuar

Bazuar në vlerësimin e kërkesave për NE nën skemën e re, evidentohet se familjet përfituese janë me më shumë fëmijë, me nivel më të ulët arsimor, me strehim më të keq dhe me shpenzime familjare më të ulëta sesa ato të përjashtuara nga përfitimi<sup>54</sup>.

Institucionet e Përkujdesit Shoqëror që operojnë në fushën sociale janë: 266 subjekte jopublike dhe private të mbështetur nga donatorë të ndryshëm të liçensuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit dhe MMSR; 27 institucione publike që financohen me fonde nga buxheti i shtetit, në varësi të pushtetit vendor janë 19 institucione dhe 8 të tillë janë institucione kombëtare në varësi të MMSR dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror<sup>55</sup>.

MMSR është përfshirë në reformën e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për t'iu përgjigjur nevojave të individëve në vështirësi, veçanërisht fëmijëve. Njëkohësisht, ky proces merr rëndësi të veçantë edhe si pjesë e procesit të njohjes së Shqipërisë si një shtet kandidat për në BE, ku del domosdoshmëri përmirësimi i situatës së respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Në kuadër të shërbimeve rezidenciale, reforma synon deinstitutionalizimin e fëmijëve. Për këtë, është hartuar draft plani i deinstitutionalizimit me masat konkrete që duhet të ndërmerren me qëllim që në vitin 2020, fëmijët të mos jenë pranë institucioneve rezidenciale, por të integruar në familjet biologjike apo forma alternative të kujdesit.

Deri më tani është punuar drejt transformimit të shërbimeve rezidenciale në tipologjinë e shërbimit si shtëpi – familje. Në vitin 2012-2013<sup>56</sup> në gjithë rrjetin e institucioneve të përkujdesit për fëmijë ekzistonin rreth 12 shërbime të llojit Shtëpi – Familje (10 nga këto shërbime ofroheshin nga OJF, ndërsa 2 ishin shërbime publike). Në vitin 2015<sup>57</sup>, në institucionet rezidenciale publike dhe jo publike për fëmijë janë ngritur 26 shtëpi familje ku përfitojnë shërbime 309 fëmijë. Për të realizuar këtë ndryshim janë ndërmarrë ndërhyrje në infrastrukturë, strukturë dhe shërbime.

Së fundmi, në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr 55 datë 02.03.2015 “Për Miratimin e Planit të Veprimit të Deinstitutionalizimit për Shtëpinë e Fëmijës Zyber Hallulli”, MMSR, dhe partnerët<sup>58</sup> kanë filluar implementimin e aktiviteteve për transformimin e shërbimeve rezidenciale në shërbime komunitare në këtë institucion. Praktikrat e reja do të përfshijnë deinstitutionalizimin, riorganizimin e pjesshëm nga qendra rezidenciale në forma të kujdesit të tipit shtëpi - familje dhe komunitare.

Një tjetër prioritet në kuadër të deinstitutionalizimit ka qënë hartimi i planeve të përkujdesit për nxitjen e integritit të fëmijëve e rikthimin e tyre në familjen biologjike ose birësimin e tyre.

Të dhënat tregojnë se 80 % e fëmijëve në institucionet janë jetimë social dhe procesi i rikthimit në familje ka hasur pengesa për shkak të mungesës së vlerësimeve të familjeve nga Administratorët Socialë në nivelet rajonale, si edhe mungesës së hartimit të programeve të fuqizimit të familjes nga pushteti vendor. Vështirësi raportohen edhe në procesin e integritit të fëmijëve pas kthimit të tyre në familjet biologjike.

54. T. Jantzi, *Initial Baseline Report: Albanian Ndihma Ekonomike – Social Assistance Modernization Project*, 2014.


55. Të dhëna administrative Drejtoria e Inspektimit të Standarteve dhe të Shërbimeve Shoqërore, 2015

56. Raporti vjetori I monitorimit të planit të veprimit për fëmijë 2012 – 2015, për periudhën qershor 2012 – maj 2013, ASHMDF, MPCSSHB

57. Të dhënat administrative të Shërbimit Social Shtetëror, 2015

58. Terre Des Hommes, SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri

Aktualisht, janë 9 institucionet rezidenciale publike dhe 15 institucione jopublike që kanë hartuar listat e familjeve të fëmijëve të vlerësuar si potencial për rikthim në familje<sup>59</sup>.



Përpjekjet për konsolidimin e mëtejshëm të procesit të deinstitutionalizimit janë mbështetur edhe përmes masave konkrete të projektit “Shërbime sociale inovative për grupet në nevojë: standartet për decentralizimin” duke mundësuar ngritjen e shërbimeve të reja në qendrat rezidenciale për personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe të moshuarit.

Shërbimi i kujdestarisë, i pilotuar në 2011 në dy bashki (Tiranë, Shkodër), tashmë është shtrirë në gjithë vendin. Aktualisht këtë shërbim e kanë përfutur 100 fëmijë<sup>60</sup> krahasuar me 66 në vitin 2012. Nga analizimi i të dhënave të disponueshme evidentohet se shërbimi i kujdestarisë ofrohet kryesisht nga familjet me lidhje biologjike me fëmijën (të afërm).

Birësimi dhe procedurat e tij po bëhen më të lehta dhe më efektive. Komiteti Shqiptar i Birësimit (KSHB) ka bërë të mundur që brenda fundit të vitit 2013 të realizohet liçensimi i të gjitha agjencive ndërmjetësuese në Fushën e Birësimit Ndërvendas duke lehtësuar dhe përsheptuar këtë proces. Gjithashtu KSHB ka paraqitur propozime konkrete për përmirësime dhe ndryshime ligjore që kanë të bëjnë me çështjen e birësimit brenda dhe jashtë vendit. Këto propozime janë përcjellë pranë institucionit të Ministrisë së Drejtësisë dhe janë në proces për të ndjekur hapat e nevojshëm sipas praktikës së hartimit të legjislacionit. Takimi me gjyqtarët e seksionit të familjes në Gjykatat e Rretheve me qëllim ndërgjegjësimin për eliminimin e vonesave në proceset gjyqësore për “deklarim braktisjeje dhe birësim fëmije”, ka rezultuar prej muajit prill 2014 në përsheptimin e procedurave që garantojnë mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve.


KSHB raporton mbi monitorime periodike të institucioneve publike dhe jopublike për zbatimin e afateve ligjore për fillimin e procedurave për birësimin. Për periudhën raportuese të këtij raporti, KSHB dëshmon për rritje të raporteve pasvlerësuese të familjeve/fëmijëve pas birësimit.

59. Sipas urdhërit me Nr. Prot 601 dt. 18.03.2014 nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror drejtuar Drejtorive Rajonale për ndjekjen dhe zbatimin e planit për rikthim të fëmijëve në familje biologjike

60. Po aty



Numri i birësimeve të realizuara në tre vitet e fundit dëshmonë për përmirësimin e këtij shërbimi.



Për të përmirësuar *monitorimin* e Institucioneve publike dhe jopublike rezidenciale për fëmijë, në SHSSH është krijuar një sistem i plotë dhe fleksibël me të dhëna për të gjithë përfituesit në rrjetin e institucioneve rezidenciale, gjë që lejon evidentimin e shpejtë të situatës dhe dinamikën e ndryshimeve në këto institucione. Është aplikuar si metodë e re monitorimi sistemi i pikëzimit të standarteve të përkujdesit për fëmijë mbështetur në tregues cilësorë.

24

Inspektoriati i Punës dhe i Shërbimeve Sociale, në funksion të *inspektimit* të standarteve të shërbimeve të kujdesit social ka realizuar 53 inspektime (29 në institucione rezidenciale dhe 24 në institucione ditore) në qendrat e përkujdesit për fëmijë<sup>61</sup>.

Qendrat e përkujdesit janë të fokusuar në zbatimin e standarteve që lidhen me aspektet fizike (ushqimi, veshja, akomodimi,) dhe kanë vështirësi në zbatimin e standarteve që lidhen me aspektet psikosociale të klientëve, me përfshirjen sociale, riintegrimin, pjesëmarrjen e prindërve/ të afërmeve në procesin e hartimit të planeve individuale, lidhjet me komunitetin etj. Gjatë inspektimit të subjekteve publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime rezidenciale për fëmijë, janë konstatuar që institucionet kanë nevojë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve për fëmijë bazuar në standartet e miratuara. Raportohet se mosrespektimi i standarteve vjen së pari nga mosnjohja e standarteve nga stafi dhe mungesa e kapaciteteve për ofrimin e një shërbimi cilësor.

61. Të dhëna administrative Drejtoria e Inspektimit të Standarteve dhe të Shërbimeve Shoqërore, Maj 2014-Maj 2015

Rasti i dhunës ndaj fëmijës në Institucionin e Përkujdesit Shoqëror për fëmijët 3-6 vjeç në Shkodër nga ana e kujdestareve të këtij institucioni solli në vëmendje se në institucionet e kujdesit për fëmijët ka prani dhune. Ushtrimi dhe pranimi i dhunës në grup nga punonjësit e të tilla institucioneve në ambiente publike është një tregues i rëndësishëm i përdorimit jo rastësor apo episodik të dhunës, që ushtrohet ndaj fëmijëve, pikërisht nga ata të cilët kanë detyrën të garantojnë mirëqenien dhe mbrojtjen e tyre. Rasti tregon domosdoshmërinë për ngritjen dhe/apo vënien në funksion të mekanizmave të monitorimit, identifikimit dhe të ankimit të çdo rasti dhune, neglizhimi, abuzimi, shfrytëzimi apo trajtimi poshtëruar ndaj fëmijëve.

Në këtë kuadër ka filluar një testim i përgjithshëm i stafëve të qendrave të përkujdesit social në të gjithë vendin.

Në kuadër të shërbimeve të reja sociale, gjatë 2012-ës janë ngritur me fonde nga qeverisja vendore dhe qendrore, 2 qendra të përkujdesit shoqëror për fëmijët autikë në Elbasan dhe Gjirokastrë.

### **Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të përkujdesjes shoqërore**

Në Qendrën e Zhvillimit për fëmijët me aftësi të kufizuar në Tiranë janë përmirësuar kushtet e jetesës nëpërmjet ndërhyrjeve në infrastrukturë duke realizuar transformimin e pjesshëm nga shërbimi rezidencial në atë ditor. Në këtë shërbim janë punësuar 4 të rinj me aftësi të kufizuar, dhe kanë marrë arsim profesional edhe 10 të tjerë.

Transformimi i shërbimit nga rezidencial në 2 Shtëpi-Familje në Qendrën e Fëmijëve 3-6 vjeç në Shkodër u shoqërua me ndërhyrje në infrastrukturë. Qendra Ditore ofron shërbime për fëmijë të komunitetit Romë dhe fëmijët në situatë rruge. Përmes fuqizimit të familjeve janë kthyer në familjen biologjike 3 fëmijë dhe është siguruar mbështetje për një periudhë 3 vjeçare për fëmijët dhe familjen.

Në kuadër të një bashkëpunimi ndërmjet MMSR dhe Ministrisë së Mbrojtjes u siguroi një vendqëndrim i përkohshëm për 53 familje të komunitetit rom pas shpërnguljes nga banesat e mëparshme. Këshilli Administrativ i Shërbimit Social Shtetëror<sup>62</sup> miratoi hapjen e Qendrës Kombëtare Tranzitore të Emergjencës për Kategoritë në Nevojë. Në këtë kontekst, strukturave të shërbimeve që menaxhohen dhe administrohen nga SHSSH, i shtohet edhe një tipologji e re shërbimi.

Përmes masave të marra, tashmë në Qendër kanë mbetur 34 familje (80 fëmijë). Nga familjet e larguara, 6 prej tyre janë strehuar në banesat sociale, 6 të tjera kanë dalë drejt një jete të pavarur. Gjatë qëndrimit në qendër janë aksesuar dhe u janë ofruar paketat e plota të shërbimeve të gjithë fëmijëve të qendrës. Bashkëpunimi dhe ndihma e partnerëve si UNICEF dhe Terre des Hommes ka bërë të mundur që fëmijët të ndjekin arsimin 9 vjeçar publik ose atë parashkollor.

62. Vendimi Nr. 166/5 më datë 18.03.2014

Qendra do të shërbejë në të ardhmen si një bazë kalimtare për personat apo familjet që vijnë nga situata social-ekonomike të vështira. Hartimi i standardeve të shërbimeve në Qendrën Kombëtare Transitore të Emergjencës shënon një hap të rëndësishëm në garantimin dhe në zhvillimin e mëtejshëm të të drejtave të njeriut të sanksionuara në Kushtetutë, në legjislacionin shqiptar dhe në konventat ndërkombëtare, të ratifikuara nga qeveria shqiptare<sup>63</sup>.

Në kuadrin e politikëbërjes për grupet vulnerabël është hartuar mbi bazën e një konsultimi të gjerë Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale dhe Planit Kombëtar për Integrimin e **Komunitetit Rom dhe Egjiptian**. MMSR në bashkëpunimin me PNUD ka riaktivizuar sistemin RomAlb të targetuar për Romët dhe Egjiptianët, ku përfshihen indikatorë me grupmosha.<sup>64</sup> Sistemi do të shërbejë për hedhjen e të dhënave që do të gjenerohen nga çdo ministri linje dhe këshill qarku. Tashmë ngritja e kapaciteve për manaxhimin e sistemit në nivel qendror dhe vendor është realizuar. Miratimi i sistemit përmes një Vendimi të Këshillit të Ministrave (VKM) do të gjenerojë të dhëna çdo 6 muaj dhe do të shërbejë për hartimin e politikave efektive për integrimin e minoritetit Rom dhe Egjiptian në Shqipëri.

Në përmbushje të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, shënohet si arritje e rëndësishme miratimi i ligjit 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK”. Ligji trajton çështjet e aksesueshmërisë, edukimit shëndetësor dhe mbledhjes së të dhënave, që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë fëmijët e të gjitha grupmoshave.

Në kuadër të ligjit Për Arsimin Parauniversitar, me qëllim përmbushjen e të drejtës për arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, sfidues mbetet zbatimi i udhëzimit për mësuesit mbështetës<sup>65</sup>.

Ka vijuar bashkëpunimi për procesin e zyrtarizimit të gjuhës së shenjave duke bashkëpunuar me Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë<sup>66</sup>.

Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara 2015-2020 është në proces hartimi në konsultim me grupet e interesit. Kjo strategji në hapat e parë të formulimit reflekton fokusin tek fëmijët dhe qasjen e tyre në arsim dhe në shërbime të tjera.

63. Vendim Nr. 572, datë 24.6.2015 Për miratimin e standardeve të Shërbimeve në qendrën Kombëtare Transitore të Emergjencës

64. Të dhëna administrative nga Drejtoria e Përfshirjes Sociale

65. Udhëzim i Ministrisë të Arsimit dhe Sporteve nr. 38, datë 7 tetor 2014, “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

66. Të dhëna administrative nga Drejtoria e Përfshirjes Sociale

## Rekomandimet

Përmirësimi i instrumentave/mekanismave për identifikimin, mbështetjen dhe riintegrimin e kategorive të fëmijëve si: fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve të braktisur, fëmijëve në institucionet rezidenciale, fëmijëve të minoriteteve, fëmijëve që jetojnë në kushte varfërie, përmes rritjes së aksesit dhe cilësisë në shërbime.

Qartësimi i përgjegjësive, linjave të llogaridhënies të aktorëve në nivel kombëtar dhe vendor për të realizuar një bashkërendim funksional dhe efektiv ndërinstitucional për mbrojtjen dhe përfshirjen e të gjithë kategorive të fëmijëve në nevojë.

Buxheti i përshtatshëm në pushtetin qendror dhe vendor për të mundësuar realizimin e angazhimeve politike dhe programatike.

Fuqizimi i mekanismave dhe praktikave të monitorimit, inspektimit dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët. Monitorimi i institucioneve të përkujdesit shoqëror duhet t'i kushtojë një vëmendje të veçantë formave të dhunës dhe ndëshkimit trupor që prek fëmijët në institucione. Monitorimi duhet të përfshijë vetë fëmijët në procesin e monitorimit. Vlerësimi i aftësive profesionale të punonjësve të institucioneve të përkujdesit duhet të jetë i vazhdueshëm.

Përmirësimi i mëtejshëm i skemës së ndihmës ekonomike për të targetuar më mirë familjet e varfëra dhe fëmijët në nevojë, përmes vlerësimit më të mirë social të kushteve të familjeve, duke synuar rritjen e masës së ndihmës ekonomike. Skema inovative që nxit shkollimin dhe përkujdesin shëndetësor të fëmijëve duhet zgjeruar dhe aplikuar në të gjithë vendin.

Deinsitucionalizimi i fëmijëve të shoqërohet me zgjerimin e gamës dhe fuqizimin e formave alternative të shërbimeve, dhe nxitjen e integritit të fëmijëve. Rekomandohet në mënyrë të veçantë krijimi i formave alternative të përkujdesit, të përshtatshme për tu përkujdesur për fëmijët që vijnë nga kontekste dhune, abuzimi dhe neglizhimi, duke krijuar lidhje të forta me sistemin e mbrojtjes së fëmijëve. Gjithashtu, duhen shtuar përpjekjet për ngritjen e modeleve të familjeve kujdestare për të gjitha grupmoshat, por në vecanti, fëmijët 0-3 vjeç. Duhen krijuar programe trajnimi për familjet kujdestare si dhe mekanizma monitorimi në vazhdimësi.

Ndërtimi i platformave të qëndrueshme të përfshirjes së fëmijëve në proceset e hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave/programeve për fëmijët si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal.

## E drejta për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi ka qenë në hije të politikave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për një kohë të gjatë. Me miratimin e Ligjit “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, u bë një hap i madh përpara, pasi për herë të parë u shpreh qartë në legjislacionin kombëtar e drejta e fëmijëve për të qenë të mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, përfshirë edhe ndaj ndëshkimit trupor. Gjithashtu me anë të këtij ligji u identifikuan struktura të posaçme që do të kishin si përgjegjësi kryesore mbrojtjen e fëmijëve.

PVF 2012-2015 pasqyron një sërë masash për të përmbushur të drejtën e fëmijëve për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik. Masat janë bazuar edhe në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale. Ato janë grupuar nën objektivat e parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, abuzimi, si edhe mbrojtjes së fëmijëve nga format më të këqija të punës.

Në përmbushje të objektivave strategjike janë ndërmarrë një spektër i gjerë aktiviteteve. Si ndër më të rëndësishmet mund të përmenden ato të lidhur me përmirësimin e kuadrit rregullator në këtë fushë, të cilat përcaktojnë fushat, detyrat dhe aktorët përgjegjës për realizimin e funksioneve të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve.

Janë miratuar 4 Vendime të Këshilit të Ministrave<sup>67</sup> që mundësojnë implementimin e Ligjit Nr. 10347 datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, lidhur me :

- Rregullat e bashkëpunimit midis institucioneve dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e të drejtave të fëmijëve
- Kontrollin dhe vendosjen e sanksioneve nga ASHMDF
- Krijimin dhe funksionimin e mekanizmit për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik
- Bashkërendimin e institucioneve në nivel qendror dhe vendor për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.
- Të dhënat statistikore që mbledh ASHMDF

Me ndryshimet e Kodit Penal është rritur masa e dënimit për dhunën seksuale ndaj fëmijëve, (nga 15 vjet në 25 vjet burg). Nenet 107 dhe 108 të Kodit janë shtuar dhe ndryshuar për të ofruar një mbrojtje nga krimet seksuale ndaj fëmijëve. Një rregullim të plotë ligjor ka pësuar edhe Neni 117 “Pornografia”, i cili në ndryshimet e tij të fundit, e konsideron si krim edhe posedimin, rekrutimin e fëmijës dhe një serë formash të tjera të pornografisë së fëmijëve.

67. VKM Nr. 263 datë 12.04.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për bashkëpunimin midis mekanizmave institucionale dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave”  
VKM Nr. 264 datë 12.04.2012 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”  
VKM Nr. 265 datë 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit”  
VKM Nr. 266 datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”  
VKM Nr. 267 datë 12.04.2012 “Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga agjencia e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor

Neni 124, paragrafi C i Kodit, është përmirësuar, duke përfshirë të gjithë format e shfrytëzimit të fëmijëve, edhe mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik.

Janë miratuar *standartet të shërbimeve të NJMF*<sup>68</sup>, që do të shërbejnë për të matur dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në bashki dhe krijojnë edhe bazën për inspektimin e tyre nga strukturat në nivel qendror.

Standartet janë mbështetur në pesë fusha specifike, por të ndërlidhura midis tyre që përfshijnë kriteret për cilësinë. Standardi 1: Sigurimi i burimeve të mjaftueshme dhe i një mjedisi të përshtatshëm pune për të mundur që puna për mbrojtjen e fëmijëve të bëhet në mënyrë efektive, të përshtatshme dhe të sigurt. Standardi 2: Zbatimi i procedurave të referimit dhe të menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik, për të siguruar mbrojtjen e fëmijës në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme. Standardi 3: Përfshirja e fëmijës dhe familjes në mënyrë aktive dhe të plotë. Standardi 4. Përdorimi i një qasjeje multidisiplinare, gjatë procesit të menaxhimit të rastit, kur i ofrohen shërbime fëmijës dhe familjes. Standardi 5. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës ofron shërbim cilësor në përputhje me nevojat e fëmijës.

*Udhëzimi katërmistror Nr. 10 datë 25.02.2015* ‘Mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve’, përcakton rolin e çdo aktori në procesin e mbrojtjes së fëmijës si dhe udhëzimet e nevojshme në identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe kornizën ligjore që i mbron ata.

Për të adresuar problematikat e funksionimit të grupeve teknike multidisiplinare, ASHMDF ka ndërmarrë iniciativën për hartimin:

- *Rregullores TIP të funksionimit të Komiteteve Drejtues*, të cilat janë miratuar tashmë me Vendim të Këshillave të Qarqeve, si edhe
- *Rregullores për organizimin dhe funksionimin e grupit teknik multidisiplinar për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie*<sup>69</sup>.

Rregullorja e grupit teknik multidisiplinar do të dërgohet për miratim në organet e qeverisjes vendore pas konstituimit të bashkive të reja dhe këshillave të rinj bashkiakë në vend.

Në kuadër të reformës së Shërbimeve Sociale është duke u përgatitur ‘*Analiza e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri*’, mbështetur nga UNICEF e cila synon të paraqesë një panoramë të sistemit aktual të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri shtrirë në të gjithë sektorët.

Paralelisht, në bashkëpunim me Këshillin e Europës (KE), ASHMDF ka nisur punën për hartimin e një ‘*Dokumenti Politik mbi Sistemin e Mbrojtjes së Fëmijëve*’, i cili do të orientojë ndërtimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe do të informojë draftimin e Planit Kombëtar të Fëmijëve 2016 – 2020.

68. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.573, datë 24.6.2015 “Për miratimin e standarteve të shërbimeve të njësive të mbrojtjes së fëmijëve”. Standardet, fillimisht u hartuan nga ASHMDF dhe MMSR, në bashkëpunim me një ekspert ndërkombëtar, të mbështetur nga Terre des hommes dhe më pas u diskutuan me aktorë të tjerë institucionalë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.


69. Raporti i realizimit të masave të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për periudhën janar – qershor 2015

## Manaxhimi i rastit të mbrojtjes së fëmijëve

Ligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” institucionalizon NJDF dhe NJMF si struktura për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimin e rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme, që veprojnë në nivel vendor.

Si pjesë e strukturave brenda Këshillave të Qarqeve, NJDF-të u ngritën në 12 Qarqe të vendit, duke nxitur bashkëpunimin e aktorëve vendorë në realizmin e të drejtave të fëmijëve.


Në 2015 raportohen të jenë ngritur 202 NJMF. Kjo situatë pritet të ndryshojë për shkak të reformës administrative. Tashmë me 61 Bashki, ngritja dhe funksionimi i NJMF-ve ka nevojë të ridimensionohet. ASHMDF dhe partnerët në fushën e të drejtave të fëmijëve po punojnë për përcaktime të reja ligjore/rregullatore si edhe ngritjen e strukturave ‘të shëndetshme’ të NJMF, mbi mësimet e marra deri më tani për funksionimin efektiv të tyre.



Burimi: ASHMDF


Aktualisht vetëm rreth 53% e njësisve administrative të vendit (ndarja e vjetër administrative), mbulohen me shërbimin e NJMF-ve. Shpërndarja nëpër qarqe nuk ka qenë e njëjtë ndër vite.

### Numri i NJMF sipas Qarqeve për vitet 2012 - 2015



Burimi: ASHMDF

Menaxhimi i rasteve është një metodë/sistem i standardizuar i përdorur për të siguruar se rastet e fëmijëve në rrezik trajtohen në mënyrë kompetente, në afatet kohore të përcaktuara dhe standartet e shërbimit janë përmbushur<sup>70</sup>. NJMF drejton procesin e menaxhimit të rastit në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë të nevojshëm për adresimin e nevojave të rastit. Nga raportimet më të fundit (janar – mars 2015) rezulton se 131 NJMF kanë pasur të paktën 1 rast ose asnjë rast për të menaxhuar. Për të njëjtën periudhë, NJMF-të kanë raportuar menaxhimin e 849 rasteve të fëmijëve në rrezik. Nga këto 219 janë raste të reja. Rastet e menaxhuara janë kryesisht raste të fëmijëve në rrezik apo viktime të dhunës, abuzimit, neglizhencës apo shfrytëzimit. Nga analiza e raportimeve, disa nga faktorët e vulnerabilitetit, të cilët rezultojnë të rrisin rrezikun që fëmijët të jenë të ekspozuar ndaj dhunës, abuzimit apo neglizhimit janë: mungesa e dokumentave të identifikimit apo regjistrimit në gjendjen civile, migrimi dhe lëvizja e fëmijëve, diskriminimi, jetesa në mjedise të pasigurtë, etj.



ASHMDF në 2014 hartoi një instrument të ri monitorimi të punës në terren të NJMF-ve. Nga monitorimi në terren, u evidentuan një sërë problematikash të përmbledhura si më poshtë.

### Struktura dhe profile

- NJMF funksionojnë brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale dhe është përgjegjësi e kryetarit të bashkisë/komunës për ngritjen dhe funksionimin e saj, i cili jo gjithmonë i ka dhënë rëndësi ngritjes së kësaj njësie. Kjo është arsyeja pse vetëm 53% e njësive vendore mbulohen me shërbimin e NJMF-ve.
- Kriteret për punësimin e Punonjësit të NJMF lidhur me edukimin apo formimin profesional të tyre, nuk janë ndjekur nga bashkitë/komunat gjatë emërimit të punonjësve.
- Roli i NJMF mbivendoset me funksione të tjera, kryesisht rolin e administratorit social duke zbehur në disa raste rolin e NJMF. Kryesisht NJMF e bashkive të mëdha funksionojnë si njësi të posaçme.
- Me qëllim ofrimin e shërbimeve të integruara për fëmijët dhe familjet është me rëndësi të përcaktohen jo vetëm rolet dhe detyrat, por edhe mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet

70. Udhëzimi i përbashkët katërministror "Për mënyrën, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik"



specialistëve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në bashki: administratori i NE, NJMF, specialist për PAK, specialist për dhunën në familje.

### **Kapacitetet e NJMF**

- Mungesa e arsimit përkatës dhe eksperiencës së NJMF sjell vështirësi në menaxhimin e rasteve. Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës duhet të kenë mundësi të zhvillojnë kapacitetet e tyre profesionale sidomos për punën në terren.
- Ka diferencë të madhe në cilësisë e punës së NJMF. NJMF-të që kanë kohë që funksionojnë, kanë zhvilluar praktika shumë të mira, ndërsa për NJMF-të e reja mbetet shumë punë për t'u bërë në mënyrë që shërbimi të bëhet efektiv dhe i arritshëm.

### **Burime dhe shërbime**

- Edhe pse ligji përcakton ngritjen e një “njësie” (NJMF) që ofron një gamë shumë të gjerë shërbimesh si: sensibilizuese e parandaluese e deri tek menaxhimi i rasteve në rrezik, aktualisht ky funksion edhe në bashkitë e mëdha kryhet nga vetëm një person. Mungesa e përkohshme e këtij personi do të krijonte boshllëk të plotë në shërbim.
- NJMF-të nuk kanë asnjë mbështetje financiare nga buxheti vendor për trajtimin e rasteve. Mungojnë shërbimet e emergjences në rastet e fëmijëve në rrezik të lartë.
- Burimet ekzistuese të shërbimeve për fëmijë janë të pakëta. NJMF-të nuk arrijnë të adresojnë nevojat komplekse të fëmijëve në rrezik.

### **Koordinimi dhe bashkëpunimi**

- Shpesh dhe pse NJMF-të janë aktive për menaxhimin e rasteve të fëmijëve, shërbimet mbështetëse që mund të ofrohen janë të fragmentuara.
- NJMF-të është e nevojshme të promovojnë rolin e tyre në komunitet si edhe tek aktorët e tjerë vendorë. NJMF-të duhet të shërbejë si një qendër informacioni për fëmijët dhe familjet.

### **Mbikqyrja/Supervizimi**

- Mungon mbështetja, këshillimi i NJMF-ve nga persona të kualifikuar, veçanërisht për menaxhimin e rasteve të vështira. Drejtuesit e tyre janë bashkëpunues dhe ndihmojnë NJMF-të edhe gjatë procesit të menaxhimit të rasteve, por megjithatë monitorimi dhe mbikqyrja e punës për menaxhimin e rastit nga drejtues teknikë e të kualifikuar mbetet problem për të gjitha NJMF-të.

Nevoja për përcaktimin e një modeli për funksionimin e NJMF-ve të reja do të jetë një tjetër prioritet për forcimin e sistemit aktual të mbrojtjes së fëmijëve, prioritet i cili do të synohet të arrihet përmes vendosjes së mekanizmave të rregullt të kontrollit të NJMF: përcaktimit të standarteve dhe një metodologjie monitoruese për shërbimet e ofruara nga NJMF-të, sigurimit të alokimit të buxheteve të nevojshme për funksionimin e NJMF-ve, fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të punonjësve për mbrojtjen e fëmijës, miratimin e rregullores për funksionimin e grupeve multidisiplinare në nivel lokal që merren me çështjet e fëmijëve. Në kuadër të Reformës Territoriale dhe Reformës së Shërbimeve Shoqërore do të ndërmerret një vlerësim i thelluar i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

## Tematika të tjera të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve

### Parandalimi i dhunës në shkolla

Fëmijët në Shqipëri përballen me forma të ndryshme të dhunës në familje, shkollë dhe komunitet. Gjithmonë e më shumë ka një tendencë për evidentimin e rasteve të dhunës në shkollë, duke qenë se ka një shkallë më të lartë ndërgjegjësimi të fëmijëve mbi të drejtat e tyre. Gjithashtu, në vitin e fundit, falë teknologjive të komunikimit janë bërë publike disa raste të dhunës dhe ndëshkimit trupor në shkolla.

Të rinjtë raportojnë që ka dhunë fizike, emocionale, psikologjike si në shkollë dhe në familje. Është zvogëluar dhuna fizike por është shtuar ajo psikologjike duke qenë se të rinjtë janë shumë më të ndërgjegjësuar për ta raportuar dhunën. Mjaft shqetësuese është edhe dhuna që ndodh midis të rinjve<sup>71</sup>.

PVF 2012-2015 përfshin mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në shkolla si një komponent të rëndësishëm të mbrojtjes. Në këtë kuadër, zbatimi i programit Combi<sup>72</sup>: “Për një shkollë miqësore pro sjelljeve positive” ka patur në fokus të drejtën e fëmijëve për mbrojtje nga dhuna dhe abuzimi. Me ndihmën e UNICEF, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) është mundësuar njohja dhe sensibilizimi i strukturave arsimore në nivel Drejtori Arsimore Rajonale (DAR)/Zyra Arsimore (ZA), shkolle dhe kopshti lidhur me këtë program. Janë zhvilluar 66 seanca orientimi rajonale në të gjitha DAR të vendit, janë trajnuar 2645 drejtorë dhe nëndrejtorë shkollash, mësues, psikologë, staf nga DAR/ZA<sup>73</sup>. Në kuadër të programit janë hartuar instrumenta, materiale komunikimi të pranuar edhe nga Inspektoriati Shtetëror i Arsimit.

Në DAR/ZA është vendosur një specialist përgjegjës për trajtimin e problemeve të dhunës në institucionet arsimore, i cili koordinon punën me ASHMDF, si dhe raporton në MAS rastet e dhunës së evidentuar në institucionet arsimore, trajtimin e tyre dhe masat e marra për reduktimin e dhunës. Gjithashtu në shkolla është shpërndarë një paketë mësimore për dhunën, e cila përmban një program për edukimin e parandalimit të dhunës, si dhe veprimtari mësimore për klasat I-12 të arsimit parauniversitar Viti shkollor 2015-2016 do të jetë viti i “Shkollës pa dhunë”, që do të sjellë një fokus të vecantë në adresimin e dhunës në shkolla.

Gjatë këtyre viteve ka patur një fokus për të shkuar drejt ofrimit të shërbimit psiko-social në shkolla për një adresim më të mirë të nevojave që kanë fëmijët, stafet e shkollave, prindërit dhe komuniteti. Në zbatim të Ligjit për Arsimin Parauniversitar 69/2012, shkolla nuk ofron vetëm shërbim psikologjik por dhe shërbim të punonjësit social. Aktualisht shërbimi psiko-social funksionon në të gjithë zonën urbane dhe hap pas hapi po shtrihet edhe në zonën rurale, fillimisht në shkolla me numër të lartë nxënësish. Megjithatë, shërbimi shfaq problematika për shkak të mungesës së burimeve dhe kapaciteteve të mjaftueshme për të mbuluar insitucionet arsimore. Për të adresuar këto problematika, pranë MAS është ngritur një grup pune për shqyrtimin e paketës ligjore dhe hartimin e dokumentacionit të punës për shërbimin psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar.

71. Takime me fëmijët e Qendrës Rinore Tiranë

72. COMBI – communication for behavior change impact – Komunikimi për impakt në ndryshimin e sjelljes

73. Raporti vjetor i monitorimit të planit të veprimit të fëmijëve 2011 – 2012.ASHMDF

Gjatë vitit 2012 Fondacioni Terre des hommes dhe DAR janë fokusuar në ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve të psikologëve shkollorë, drejtuesve të shkollave si dhe nxitjen e iniciativave brenda shkollës në drejtim të promovimit të mbrojtjes së fëmijëve. Janë organizuar trajnime me tema: “Këshillimi individual dhe në grup i fëmijëve në shkollë; teknika”, “Abuzimi fizik dhe seksual i fëmijëve; identifikimi dhe adresimi”, si dhe është ofruar edhe një trajnim për drejtorët e shkollës “Komunikimi mes aktorëve lokalë në shkollë; nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bordit të shkollës për një mjedis miqësor dhe të sigurt për të mbrojtur fëmijët në mjedisin shkollor<sup>74</sup>.

## Regjistrimi

Fëmijët e paregjistruar në gjendjen civile janë një nga kategoritë më të ekspozuara ndaj abuzimeve apo krimeve të ndryshme. Lehtësimi i procedurave për regjistrim dhe mbështetja e familjeve për të regjistruar fëmijët mbetet një veprimtari e rëndësishme në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve. Si arritje e rëndësishme mund të përmendet Udhëzimi<sup>75</sup> për "Miratimin e procedurës dhe të procesverbaleve që do të plotësohen nga përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe të Bashkive/Njësi Bashkiake/Komunave, për rastet e fëmijëve të gjetur dhe të fëmijëve të paregjistruar në Gjendjen Civile". Nëpërmjet këtij Udhëzimi, u realizua ulja e rasteve të fëmijëve të paregjistruar të gjetur dhe të braktisur nga nëna. Në zbatim të Udhëzimit të mësipërm, u miratuan Procedurat Standarte<sup>76</sup> për "Regjistrimin e Fëmijëve të Paregjistruar në Gjendjen Civile"<sup>77</sup> që lehtësuan procesin e regjistrimit të fëmijëve dhe krijuan hapësirën e nevojshme për regjistrimin e tyre.

Ministria e Shëndetësisë miratoi “Çertifikatë-Asistencë në lindje”<sup>78</sup>. Në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), në këtë dokument, u shtuan edhe dy elementë shtesë, siç janë numri i identitetit të nënës dhe mbiemri i vajzërisë së saj, duke çuar në një evidentim më të mirë të lindjeve të fëmijëve<sup>79</sup>.

34

Ndryshimet legislative dhe masat praktike të prezantuara që prej vitit 2008<sup>80</sup> kanë kontribuar për uljen e numrit të romëve të paregjistruar, si kategori më e prekshme ndaj këtij fenomeni. Në periudhën nga viti 2010 deri më 2013 janë përfunduar më shumë sesa 1 700 çështje të regjistrimit civil, duke përmirësuar kështu aksesin e komunitetit rom në shërbimet sociale. Sipas autoriteteve, në shtator të 2014-ës kishte vetëm rreth 150 çështjet të mbetura të fëmijëve të paregjistruar<sup>81</sup>. Gjithsesi, mbetet problematika e rasteve të fëmijëve të lindur jashtë vendit, të fëmijëve të prindërve të pacelebruar, etj.

## Internet i sigurtë për fëmijët

Siguria e fëmijëve online është një çështje e re në Shqipëri që ka marr një vëmendje vetëm vitet e fundit. Aktualisht mungojnë praktikatat për rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë e fëmijëve të vegjël dhe për adoleshentët. Gjithashtu, ligji aktual për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nuk parashikon mbrojtje nga përdorimi i mundshëm i rrezikshëm i internetit. Edhe të rinjtë raportojnë<sup>82</sup>

74. Po aty.

75. Udhëzimi Nr.7, datë 10.01.2012

76. Urdhër Nr.173, date 27.04.2012, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit,

77. Raporti vjetori i monitorimit të planit të veprimit për fëmijë 2012 – 2015, për periudhën qershor 2012 – maj 2013, ASHMDF, MPCSSHB

78. Urdhri Nr. 508, datë 07.12.2011

79. Po aty.

80. Raporti i katërt i ECRI-t për Shqipërinë f. 28.

81. Raporti i ECRI-T (Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës ) Per Shqiperine (cikli i pestë monitorues). 2015

82. Takim me të rinjtë e Qendrës Rinore Tiranë

shumë problematika në lidhje me sigurinë online, sipas tyre: fëmijët shpesh luajnë në internet pa mbikëqyrjen apo kontrollin e prindërve, prindërit kanë mungesë informacionesh, njohurish në lidhje me teknologjinë, ka dhe shumë raste konfliktesh midis të rinjve që ndodhin për shkak të rrjeteve sociale.

Në vitin 2013 është miratuar Kodi i Sjelljes<sup>83</sup> “Për përdorim të sigurtë dhe të përgjegjshëm të rrjeteve të komunikimeve elektronike” ndërmjet operatorëve të komunikimeve elektronike. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse koordinuan procesin për hartimin dhe miratimin e Kodit të Sjelljes, i cili u nënshkrua në 7 shkurt 2013 nga operatorët kryesorë të komunikimeve elektronike në vend<sup>84</sup>. Nëpërmjet këtij Kodi ata sigurojnë që përmbajtja komerciale e ofruar nga ose nëpërmjet tyre do të kontrollohet e do të klasifikohet brenda një kuadri të përshtatshëm. Përmbajtja komerciale do të “shënjohet” për të dalluar nëse është i përshtatshëm për moshën nën 18 vjeç. Sipas këtij Kodi sipërmarrësit angazhohen të ndihmojnë fëmijët dhe prindërit lidhur me përdorimin e rrjeteve apo shërbimet e internetit, duke pasqyruar Udhëzimet për prindërit në faqet e tyre të internetit. Kodi i sjelljes së këtyre operatorëve është një hap i parë, por mbetet me rëndësi hartimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm për të siguruar internet të sigurtë për fëmijët<sup>85</sup>.

Në maj 2013 ndryshimet e nenit 117 të kodit Penal përcaktojnë si vepër penale mbajtjen apo përdorimin e materialeve pornografike. Më 11 shkurt 2014, Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike në bashkëpunim me AKSHI nënshkruan dy memorandume mirëkuptimi për bashkëpunim midis Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), dhe operatorëve celularë<sup>86</sup>. Mbetet për t’u monitoruar në të ardhmen zbatimi dhe efektshmëria e këtyre instrumenteve.

Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) në bashkëpunim me Ministren e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ka nisur punën për hartimin e Dokumentit e Politikave për Sigurinë Kibernetike 2015-2017 përmes një procesi konsultativ ndër-institucional. Qëllimi i këtij Dokumenti Politikash është të rishikojë dhe të koordinojë detyrimet që lindin nga angazhimet e marra për një hapësirë kibernetike të sigurt me qëllim që të sigurohet përmbushja e përgjegjësisive nga të gjithë aktorët në mënyrë të koordinuar.

KDIMDP është pjesë e grupit ndërkombëtar të punës “Mbi edukimin digjital”, i cili ndër të tjera, synon hartimin e një dokumenti mbi metodologjinë e ndërgjegjësimit të fëmijëve mbi të drejtën e mbrojtjes së privatësisë<sup>87</sup>.

Siguria dhe mbrojtja e të drejtave online të fëmijëve është integruar në kurrikulat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Lënda TIK, po pilotohet në arsimin bazë. Kjo lëndë duke qenë një lëndë thelbësore e kurrikulës, e cila shërben edhe si ndër-lëndë për të gjithë lëndët e fushave të tjera të kurrikulës dhe ndihmon zhvillimin e kompetencës dixhitale tek të gjithë nxënësit. Lënda TIK përmban si tematikë të veçantë tematikën ‘Mbrojtja dhe siguria e nxënësve nga interneti’.

83. VKM Nr 182 datë 13.03.2013

84. Raporti vjetor i monitorimit të planit të veprimit për fëmijë 2012 – 2015, për periudhën qershor 2012 – maj 2013, ASHMDF, MPCSSHB

85. Po aty.

86. Rishikim Afatmesëm i Treguesve të Progresit të Planit Kombëtar të Veprimit të Fëmijëve 2012-2015. ASHMDF, Save the Children

87. Raporti vjetor 2014. Komisioneri për të drejtën e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

ASHMDF në kuadër të ditëve të Internetit të Sigurt<sup>88</sup> ka zhvilluar aktivitete të ndryshme. Gjatë forumit kombëtar ‘Interneti që duam’, u paraqit edhe një draft-rezolutë me këshilla të fëmijëve dhe të prindërve se si duhet të jetë interneti që ata duan në Shqipëri. Gjithashtu, u organizuan tema diskutimi në media për të folur mbi rreziqet që mund të vijnë nga përdorimi i internetit si edhe disa nga mënyrat që prindërit mund t’i përdorin se si t’i evitojnë apo të ballafaqohen me rreziqet që mund t’u kanosen fëmijëve të tyre. Aktivitete dhe takime informuese në shkolla për të diskutuar mbi rreziqet që mund të sjellë përdorimi i internetit si dhe ndërgjegjësimin e fëmijëve lidhur me përdorimin e tij.

## Fëmijët në situatë rruge

Studimi kombëtar mbi fëmijët në situatë rruge në Shqipëri, mbështetur nga UNICEF dhe Save the Children, hodhi dritë mbi këtë fenomen të paeksploruar në thellësi më parë. Gjetjet e këtij studimi u përdorën nga aktorë të ndryshëm për të hartuar programe dhe ndërhyrje.

AMSHDF për të adresuar këtë fenomen ka koordinuar hartimin e një Plani Veprimi “Për Identifikimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Situatë Rruge”<sup>89</sup>, bazuar në marrëveshjen e nënshkruar nga MMSR dhe MPB. Ky plan parashikon masa me qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, nëpërmjet një qasje të plotë, të integruar dhe një ndërhyrje të koordinuar ndërsektoriale me strukturat e shërbimeve sociale, policisë, arsimit, shëndetësisë, punësimit, etj., për mbrojtjen e fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve të tyre. Në vitin 2015, kjo marrëveshje u zgjerua duke u përfshirë edhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, si një nga institucionet kryesore për integrimin e fëmijëve në situatë rruge në shkollë.

Në maj të 2014, nisi zbatimi i PV për Tiranën, ku fenomeni ishte shumë i përhapur. Sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit, për koordinimin e institucioneve në kuadër të nismës, është ngritur Task-Forca për Tiranën, ku bëjnë pjesë përfaqësues nga: Agjencia e Fëmijëve, SHSSH, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Koordinatori Kombëtar Antitrafik, Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë, Drejtoria Arsimore Rajonale, Autoriteti Shëndetësor Rajonal, Bashkia Tiranë dhe disa OJF si vëzhguese.

Agjencia monitoron ecurinë e Planit të Veprimit për fëmijë në situatë rruge dhe koordinon takimet periodike të Task- Forcës. Duke filluar nga maj 2014 e deri tani janë prezantuar 6 raportet e progresit dhe 6 mbledhje periodike të Task- Forcës<sup>90</sup>. Njëkohësisht aktorët e Task Forces kanë detyrimin të raportojnë për detyrat e lëna dhe për problematikat e adresura që vijnë nga terreni të gjejnë zgjidhje institucionale, në ndihmë të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge. Problemet e adresuara kanë gjetur zgjidhje falë bashkëpunimit, disa të tjera mbeten sfida të vazhdueshme.

Në bazë të raporteve rezulton se janë ngritur **skuadra terreni në njësitë bashkiake të Tiranës** ku janë evidentuar që ka numër më të madh fëmijësh<sup>91</sup>. Pjesë e skuadrave të terrenit janë NJMF-të përkatëse të njërive bashkiake dhe një punonjës social nga Agjencia e Fëmijëve, Shërbimi social Shtetëror si dhe nga OJF partnere në zbatimin e Nismës, nga ARSIS, SHKEJ, FBSH, Të ndryshëm & të Barabartë, Save the Children.

88. Raporti i realizimit të masave të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për periudhën janar – qershor 2015

89. Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, 2013-1014. Unicef

90. Raporti i realizimit të masave të ASHMDF për periudhën Janar –Qershor 2015

91. Raport mbi zbatimin e planit të veprimit për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge. ASHMDF

Drejtoria e Policisë Tiranë dhe komisaritet e policisë kanë treguar gadishmëri për të bashkëpunuar në kuadër të nismës për fëmijët në situatë rruge. Impakti pozitiv i këtij bashkëpunimi është parë që në fillimet e zbatimit të nismës. Në muajt në vijim është insistuar që ky bashkëpunim të forcohet, duke qenë se në disa raste Bërthama koordinuese dhe NJMF-të nuk mund ta menaxhojnë situatën pa ndihmën e policisë. Bëhet fjalë për raste që me gjithë ndërhyrjen e skuadrës së terrenit, familjet në rrugë bëjnë rezistencë dhe nuk pranojnë të ndihmohen apo të largohen nga rruga bashkë me fëmijët e tyre.

Në kuadër të Nismës janë ofruar trajnime për 60 profesionistë lidhur me punën me fëmijët në situatë rruge, që përfshijnë NJMF në Tiranë, punonjës të policisë dhe organizatave të shoqërisë civile, të cilat janë pjesë e ekipeve të terrenit.

**Bërthama** për koordinimin e Planit të Veprimit në Tiranë, është vendosur pranë SHSSH dhe ka funksion koordinues të të gjithë skuadrave të terrenit dhe aktorëve të tjerë të nevojshëm. Bërthama, gjithashtu luan një rol aktiv në mbështetjen, koordinimin, ekspertizë të drejtpërdrejtë në punën e të gjitha skuadrave të terrenit. Bërthama ka krijuar dhe përditëson databazën për fëmijët në situatë rruge, përmes së cilës monitorohet ecuria dhe hapat e ndjekur për secilin fëmijë dhe familje.

Disa nga shërbimet e ofruara për familjet në situatë rruge gjatë menaxhimit të rasteve kanë qenë: këshillim, ofrim shërbimesh nga qendrat ditore, regjistrim i fëmijëve në shkolla, kopshte, çerdhe, pajisje me çertifikata, vaksinim i fëmijëve, transferim dokumentash, paketa ushqimore, aplikim për ndihmë ekonomike, ndërhyrje për asistencë mjekësore, referim dhe ndërmjetësim për punësim në Zyrat e Punës.

Nisur nga eksperiencia pozitive në Tiranë, dhe nevojës për zgjerim të ndërhyrjes, me propozim të ASHMDF në konsultim të gjerë me aktorë nga instiucionet dhe organizatat jofitimprurëse, u realizua përditësimi i Planit të Veprimit për Fëmijët në Situata Rruge 2015-2017. Në 2015 modeli i Tiranës filloi të zbatohet edhe në 3 bashki të tjera: Durrës, Elbasan, Fier.

ASHMDF ka koordinuar në bashkëpunim me kryetarët e bashkive dhe aktorët lokalë zbatimin e Planit të Veprimit për fëmijë në situatë rrugë në tre bashkitë Durrës, Elbasan, Fier. Janë realizuar takime me kryetarët e bashkive dhe aktorët lokalë. Skuadrat e terrenit janë ngritur në tre bashkitë e reja dhe janë përcaktuar personat përgjegjës për koordinimin e tyre.

ASHMDF në bashkëpunim me OSBE, ka organizuar trainime me përfaqësuesit e grupeve të terrenit, në lidhje me procedurat e punës për fëmijët në situatë rruge në bashkitë, Durrës, Fier, Elbasan. Në bashkëpunim me Koordinatorin Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit, në qarqet Durrës, Elbasan, Fier, Korçë janë organizuar trajnime me temë “Fëmijët në situatë rruge, identifikimi i rasteve të trafikimit të brendshëm të tyre. Sfidat dhe zgjidhjet”. Synimi i këtyre trajnimeve është njohja në mënyrë të detajuar e funksionimit të modelit të zbatimit të Planit të Veprimit për Tiranën dhe bashkëpunimi me strukturat antitrafik për rastet e fëmijëve në situatë rruge<sup>92</sup>.

Në zbatim të PV janë identifikuar në gjithë vendin 485 fëmijë dhe është bërë e mundur largimi nga situata e rrugës dhe marrja në mbrojtje e 222 fëmijëve.

92. Raporti i realizimit të masave të ASHMDF për periudhën Janar –Qershor 2015

Në fillimin e vitit shkollor 2015-2016, ASHMDF në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve ka punuar për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë për fëmijët në nevojë, veçanërisht të fëmijëve në situatë rruge që janë në proces tranzitimi nga rruga drejt integritit të tyre.

Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashkëpunim me DAR, shkollat dhe komunitetin, identifikuan fëmijët e paregjistruar në shkollë për vitin 2015-2016. Një pjesë e fëmijëve mbi 9 vjeç nuk kishin ndjekur asnjëherë shkollën. Listat e mbledhura nga ASHMDF, u dërguan në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve për të ndjekur regjistrimin e fëmijëve.

### **Fëmijët që punojnë**

Ndryshimet në Kodin Penal (prill 2013) përcaktojnë shfrytëzimin e fëmijës për punë si vepër penale. Në mbështetje të përmirësimit ligjor, në 2014 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Policisë së Shtetit “Për procedurat e bashkëpunimit për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin e punës”.

Është drejt përfundimit dokumenti strategjik “Për sigurinë dhe shëndetin në punë 2014-2020” i hartuar në kuadër të IPA 2010. Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti strategjik është krijimi i një kursi të qartë veprimesh për aktorët kryesorë, për zhvillimin dhe orientimin e ardhshëm të sigurisë dhe shëndetit në punë në Shqipëri. Një nga qëllimet është edhe rritja e numrit të palëve të përfshira në mënyrë aktive në promovimin e SSHP dhe forcimi i rolit të tyre në këtë përpjekje. Është një kuadër i përbashkët për bashkëpunim, për rolet dhe detyrat e vetë Qeverisë, Ministrive të caktuara, institucioneve, organeve inspektuese, partnerëve socialë dhe aktorëve të tjerë. ASHMDF ka advokuar që të ketë aktivitete specifike në këtë dokument strategjik për të përfshirë në kurikulat e arsimit bazë dhe të mesëm terminologji në lidhje me konceptet bazë për një punë të sigurt dhe të shëndetshme.

38

### **Fëmijët në lëvizje**

Për herë të parë në vitin 2013-2014, ASHMDF, në bashkëpunim me partnerët Terre des Hommes dhe Save the Children është angazhuar në koordinimin e zbatimit të programit MARIO në Shqipëri, fokusuar në mbrojtjen e fëmijëve në lëvizje. Fillimisht, është bërë dokumentimi i situatës së fëmijëve në lëvizje në Shqipëri, duke ofruar një panoramë aktuale ligjore, strategjike, strukturore, programatike dhe kapacitetesh lidhur me çështjen. Kjo analizë ka ndihmuar për të formuluar rekomandime për të ndikuar në ndryshimin e situatës. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, për të siguruar pjesëmarrje dhe përjasje të integruar.

Në këtë kuadër, me iniciativë të Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës Kundër Trafikimit të Personave, janë realizuar takime<sup>93</sup> shumëpalëshe në Greqi (16-17 mars 2015) për vlerësimin e situatës së fëmijëve në lëvizje nga Greqia, Shqipëria, Rumania dhe Bullgaria. Përfaqësuesit nga katër vendet prezantuan analizën e situatës së fëmijëve në lëvizje. Referuesit u fokusuan në funksionimin e sistemeve kombëtare të vendeve përkatëse dhe palët e përfshira për mbrojtjen e fëmijëve, përgjegjësitë, pengesat dhe procedurat e kthimit të fëmijëve në shtetet palë. Takimi doli me disa rekomandime, të cilat do i përcillen shteteve palë për përmirësimin e situatës së fëmijëve në lëvizje dhe në Kosovë. Si rezultat i takimeve mund të përmendet ulja e rasteve të fëmijëve të pashoqëruar të deportuar (kthimit pa njoftim) nga Greqia.

93. Po aty



Në legjislacionin shqiptar nuk ekziston përkufizimi “fëmijë i pashoqëruar apo i ndarë” me përjashtim të atij të përdorur për shtetasit e huaj në Ligjin për të Huajt 108/2013 Neni 3/31<sup>94</sup> dhe në Ligjin për Azilin 121/2014 Neni 3<sup>95</sup>. Në legjislacionin shqiptar për fëmijët<sup>96</sup> nuk ka ndonjë parashikim ligjor të vecantë që të specifikojë formën e mbrojtjes që i sigurohet fëmijëve të pashoqëruar apo të ndarë nga prindërit, përveç rasteve kur ka elementë të trafikimit. Koncepti dhe detyrimet ndaj “fëmijës së pashoqëruar” vërehet se nuk janë shumë të njohura për NJMF-të. Prirja e fëmijëve të pashoqëruar për t'u larguar përtej kufijve të Republikës së Shqipërisë është e vazhdueshme. Nuk është e lehtë që të përcaktohet sesa prej këtyre fëmijëve janë trafikuar. Fëmijët e pashoqëruar janë të cënueshëm nga abuzimi, shfrytëzimi dhe janë në rrezik të lartë për tu trafikuar. Sipas Procedurave Standarte të Veprimit për Viktimat e Trafikimit dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit, fëmijët e pashoqëruar identifikohen si viktima ose viktima të mundshme të trafikimit dhe duhet të referohen tek Autoriteti Kombëtar Përgjegjës për Anti - Trafikimin<sup>97</sup> për mbështetje dhe hetim të mëtejshëm.

Për **fëmijët në rrezik dhe të riadhesuar**<sup>98</sup>, SHSSH ka vendosur një bashkëpunim ndër-institucional me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me nënshkrimin e Urdhrit të Përbashkët Nr. 332/3, datë 07.03.2014 “Për pritjen dhe trajtimin social të të miturve të pashoqëruar që kthehen/ripranohen nga vendet e tjera”. Urdhri duhet të përmirësohet për të përfshirë institucione të tjera të rëndësishme në këtë proces si Ministria e Jashtme, si edhe strukturat kyçe të mekanizmit të mbrojtjes së fëmijëve, NJMF-të<sup>99</sup>. SHSSH raporton hartimin e 11 raporteve vlerësuese në vitin 2014, dhe 19 të tillave në gjashtëmujorin e parë 2015.

Një vlerësim i ndërmarrë mbi situatën e fëmijëve të pashoqëruar në vend<sup>100</sup> ka evidentuar domosdoshmërinë e hartimit të një platforme për trajtimin e problemeve për këtë kategori fëmijësh, si edhe hartimin e procedurave standarte të identifikimit e mbrojtjes e tyre.

IOM në bashkëpunim me Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në Policinë e Shtetit dhe mbështetur në analizën e sipërpërmendur, organizoi katër seanca Workshopesh trajnuese me punonjës të kufirit dhe migracionit dhe punonjës socialë të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) në qarkun e Gjirokastrës dhe të Korçës në lidhje me pritjen dhe referimin e të miturve të pashoqëruar drejt shërbimeve të mbrojtjes, në veçanti të të miturve në situatë vulnerabel ndaj shfrytëzimit dhe trafikimit (siç janë Romët). Trajnimet kombinuan prezantimin dhe diskutimin e kuadrit politik dhe praktikës së Kombeve të Bashkuara<sup>101</sup> dhe Bashkimit Evropian mbi pritjen dhe trajtimin e të miturve të pashoqëruar me kuadrin rregullator dhe praktikën shqiptare në identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e të miturve të pashoqëruar që kthehen në Shqipëri<sup>102</sup>.

94. I mitur i pashoqëruar” është i mituri i huaj, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë i pashoqëruar nga një person madhor përgjegjës, sipas ligjit dhe për sa kohë që nuk merret efektivisht në përkujdesje prej tij, ose i mituri që lihet i pashoqëruar, pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.

95. “I mitur i pashoqëruar” është i huaj apo personi pa shtetësi nën 18 vjeç, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë i pashoqëruar nga një person madhor, përgjegjës për të, sipas ligjit ose sipas traditës, ose është lënë i pashoqëruar pasi ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për sa kohë ai nuk është efektivisht nën kujdesin e një personi të tillë.

96. Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

97. Këshilli i Ministrave Vendimi Nr. 258 mbi Procedurat Standarde Operative për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit dhe Viktimave të mundshme të Trafikimit 27.7.2011

98. Sipas përkufizimit dhe në zbatim të detyrave të “Strategjisë Për riintegrimin e Shtetasve Shqiptar të Kthyer 2010-2015

99. Dokument për diskutim në tryezë të rrumbullakët, 7 Korrik 2015, Ministria e Punëve të Brendshme.

100. Lenja, V. 2015. Profili i situatave të minorenëve të pashoqëruar dhe përpjekjet për përfshirje sociale. Tirane: Sësis Coopertion, MSËY, UN, MI, IOM

101. U konsiderua e nevojshme përkthimi dhe shpërndarja e Komentit Nr. 6 të KDF nga Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara “Trajtimi i fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë jashtë vendit të tyre të origjinës”

102. Dokument për diskutim në tryezë të rrumbullakët, 7 Korrik 2015, Ministria e Punëve të Brendshme.



## Fëmijët e trafikuar

Sipas Koordinatorit Kombëtar Antitrafik numri i fëmijëve të trafikuar në vitin 2012 ka qenë 26 fëmijë. Për vitin 2013 kjo shifër ka qenë 43 fëmijë dhe për vitin 2014 numri i fëmijëve të trafikuar është 62 fëmijë.

Për sa i përket trafikimit të brendshëm të fëmijëve dhe adresimit të problematikave të tjera që shoqërojnë fëmijët në situatë rruge, së bashku me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Koordinatori Kombëtar Antitrafik ka hartuar një plan veprimi që përmban veprime të qarta dhe konkrete si dhe afate për realizimin e tyre. Ky plan u formalizua me firmosjen në 17 shtator 2014 të një Marrëveshjeje Mirëkuptimi mes aktorëve. Për trajtimin e duhur të këtij fenomeni, në datë 14 korrik u organizua Workshop-i me temë “Lufta kundër trafikimit të brendshëm të fëmijëve: sfidat dhe zgjidhjet”. Ky aktivitet, i cili mbledhi për herë të parë bashkë prokurorë, punonjës të shërbimit social shtetëror rajonal, inspektorë të inspektoratit shtetëror të punës dhe punonjës të policisë antitrafik, u zhvillua në Qendrën e Formimit Policor Tiranë<sup>103</sup>.

Me miratimin e ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit”, ofrohen disa garanci shtesë për mbrojtjen dhe mbështetjen e plotë ndaj viktimave të trafikimit, sidomos atyre fëmijë. Në nenin 17/g parashikohet identifikimi, mbrojtja dhe referimi për asistencë në autoritetet përkatëse të viktimave të trafikimit.

Me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 179, datë 19.06.2014, “Për ngritjen e Komitetit Shtetëror kundër Trafikimit të Personave”, Komiteti Shtetëror Antitrafik është zgjeruar me anëtarë të rinj. Ky mekanizëm, i cili është mjeti më i rëndësishëm në nivelin politik, është përgjegjës për përcaktimin e prioritetëve strategjike që formësojnë veprimin e antitrafikimit në Shqipëri.

Për një identifikim dhe referim më proaktiv të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit me Udhëzimin e Përbashkët Nr. 3799, datë 08.07.2014, të Ministrit të Punëve të Brendshme, Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Ministrit të Shëndetësisë, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafikim, u riorganizua dhe u zgjerua Autoriteti Përgjegjës duke përshtatur rolin dhe detyrat e tij me Procedurat Standarte të Veprimit. Rishikimi i Autoritetit Përgjegjës (AP), synoi të mbështesë implementimin efikas të marrëveshjeve të nënshkruara për mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve viktimë të trafikimit, funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të mundshme dypalëshe dhe/ose shumëpalëshe të ardhshme, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera në rajon dhe më gjerë për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore.

Qeveria shqiptare vlerëson dhe mbështet përpjekjet dhe shërbimin e ofruar viktimave në luftën kundër trafikimit të personave, mbrojtjen dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Qendrës “Tjetër Vizion” iu akordua një fond prej 10 milion lekë nga qeveria shqiptare për mbrojtjen, asistencën dhe riintegrimin e fëmijëve viktimë të trafikimit dhe fëmijëve në risk<sup>104</sup>. Fondi është dhënë nga buxheti i MMSR.

103. [http://www.punetebrendshme.gov.al/files/programs\\_files/Materaili\\_i\\_MPB\\_në\\_kuadër\\_të\\_takimit\\_të\\_Komitetit\\_të\\_Stabilizim\\_Asociimit,\\_Mars\\_2015](http://www.punetebrendshme.gov.al/files/programs_files/Materaili_i_MPB_në_kuadër_të_takimit_të_Komitetit_të_Stabilizim_Asociimit,_Mars_2015)

104. Po aty.

## Fëmijët e abuzuar dhe shfrytëzuar seksualisht

Studimet tregojnë se problemi është shpesh i fshehur dhe se raportimet në institucione janë të pakta. Pothuajse në të gjithë vendin mungojnë shërbimet dhe programet e specializuara me financim të qëndrueshëm, me personel me profesionistë të trajnuar si pjesë e një mekanizmi efikas dhe efektiv ndërhyrjeje.

Në mbështetje të Reformës së Shërbimeve Shoqërore, MMSR, në bashkëpunim me ASHMDF, Terre des Hommes, UNICEF ka ndërmarrë një projekt tre vjeçar për ngritjen dhe mbështetjen e një sistemi të integruar me në qendër fëmijën, që ka si qëllim mbrojtjen e fëmijës nga çdo lloj forme, abuzimi, shfrytëzimi. Aktualisht ka filluar trajnimi dhe rritja e kapaciteteve për NJMF, administratorët socialë, personelin arsimor (mësuesit, psikologët e shkollave dhe drejtorëve), përfaqësues të policisë, personelin shëndetësor, personelin gjyqësor, prokurorë dhe të tjerë për të ndihmuar në identifikimin dhe adresimin e rasteve të abuzimit të fëmijëve, veçanërisht abuzimin seksual. Si rezultat i kësaj iniciative, po punohet për ndërtimin e një shërbimi të specializuar, funksional dhe cilësor për fëmijët viktimë të formave të rëndëa të abuzimit, veçanërisht të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual.

Këshilli i Europës ka filluar monitorimin e zbatimit të Konventës së Lanzarotes “Mbrojtja e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Shfrytëzimi Seksual”. Faza e parë e monitorimit ka në fokus çështjet e abuzimit seksual të fëmijëve në rrethin e besimit. Nga 15-17 qershor 2015 u mbajt mbledhja e 12-të e Komitetit, ku u diskutua drafti i raportit të monitorimit. Raporti, do të përmbajë rekomandime për të gjitha shtetet. Gjithashtu gjatë takimit të fundit, Komiteti miratoi një Opinion mbi ‘Solicitimin e fëmijëve për qëllime seksuale nëpërmjet teknologjise se komunikimit dhe informimit.

Me mbështetjen e ICITAP dhe Save The Children, është zhvilluar trajnimi për “Procedurat standarde që duhen zbatuar në rastet e dhunës seksuale ndaj fëmijëve”, ku përfitues kanë qenë punonjës të policisë, prokurorisë, shëndetësisë etj<sup>105</sup>.

## Fëmijët dhe media

ASHMDF monitoron çdo ditë mediat e shkruara dhe vizive për të identifikuar problematikat e fëmijëve. Shqetësuese mbetet mënyra sesi media i analizon ngjarjet dhe portretizon fëmijët. Kuadri legjislativ dhe rregullator për mediat audiovizive përcakton qartë përgjegjësitë e mediave në respektimin e të drejtave të fëmijëve. Mediat kanë detyrimin të ndalojnë transmetimin e programeve që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor, ose moral të të miturve, duhet të respektojnë me rigorozitet privatësinë e të miturve. Në disa raste raportimet apo transmetimet, kanë dhënë detaje që çojnë direkt apo indirekt në identifikimin e fëmijës viktimë. Shpesh ky ka qënë një faktor pengues për rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijës në një jetë normale, por edhe ka ndikuar negativisht në klimën apo marrëdhëniet brenda familjes.

105. [http://www.punetebrendshme.gov.al/files/programs\\_files/Materaili\\_i\\_MPB,\\_në\\_kuadër\\_të\\_takimit\\_të\\_Komitetit\\_të\\_Stabilizim\\_Asociimit,\\_Mars\\_2015](http://www.punetebrendshme.gov.al/files/programs_files/Materaili_i_MPB,_në_kuadër_të_takimit_të_Komitetit_të_Stabilizim_Asociimit,_Mars_2015)

## Rekomandimet

Fuqizimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në rrezik për të gjitha kategoritë e fëmijëve. Sigurimi i mekanizmave dhe burimeve të nevojshme për të realizuar mbrojtjen e tyre. Numri i NJMF-ve duhet rritur, duke siguruar punonjës të mbrojtjes së fëmijëve në profilin e duhur (punonjës socialë) dhe në numër të mjaftueshëm. Njësitë administrative duhet të kenë në strukturat e tyre punonjës të mbrojtjes së fëmijëve.

Hartimi i politikave të reja që kanë në fokus ngritjen e një sistemi të integruar dhe gjithëpërfshirës për mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë përcaktimin e përgjegjësive të qarta në nivel qendror lidhur me politikëbërjen, koordinimin, implementimin dhe monitorimin. Hartimi i politikave që kanë fokus parandalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe mbrojtjen e fëmijëve në kontekste të ndryshme duke përfshirë mbrojtjen e fëmijëve online, në institucione dhe në familje.

Ngritja e një sistemi unik për mbledhjen e të dhënave, duke evituar mbivendosjen e rasteve dhe disagregimin e të dhënave, me qëllim informimin mbi situatën e fëmijëve dhe informimin e politikave.

Përmirësimi i kuadrit ligjor që ka në fokus mbrojtjen e fëmijëve. Përcaktimi i qartë ligjor i përgjegjësive të strukturave të ndryshme në nivel vendor lidhur me mekanizmin e përgjigjes ndaj situatave të rrezikut që i kanosen fëmijëve. Përcaktimi ligjor i detyrimit për të raportuar rastet e fëmijëve të dyshuar si subjekt i dhunës, abuzimit apo neglizhimit. Përcaktimi i qartë ligjor i kategorive të fëmijëve në rrezik të cilët janë subjekt i masave mbrojtëse dhe përcaktimi i qartë i masave mbrojtëse për kategoritë e ndryshme të fëmijëve në rrezik.

Përmirësimi i kuadrit rregullator me synim qartësimin e procedurave dhe formave të bashkëpunimit për identifikimin dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge, për mbrojtjen dhe ri-integrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin.

42

Përmirësimi i nivelit profesional të punonjësve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijëve, në sektorët e shërbimeve sociale, rendit, arsimit dhe shëndetësisë. Rritja e kapaciteteve dhe nxitja e bashkëpunimit ndërmjet profesionistëve të Grupeve Teknike Multidisiplinare në nivel vendor. Ngritjen e kapaciteteve të strukturave në nivel vendor për zbatimin efektiv të udhëzimit katër ministror për procedurat për mbrojtjen e fëmijës dhe standardet e cilësisë së shërbimit të të NJMF. Qartësimi i përshkrimit të punës së punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve. Ndërtimi i mekanizmave të mbështetjes, motivimit, monitorimit dhe vlerësimit të NJMF për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

Ngritja e shërbimeve të specializuara dhe të integruara për forma të vecanta abuzimi, siç është abuzimi seksual, ku punonjës socialë, psikologë, avokatë, punonjës policie, prokurorë dhe gjykatës bashkëveprojnë në interesin më të lartë të fëmijës.

Fuqizimi i rolit koordinues dhe monitorues i ASHMDF, si edhe mbështetja me kapacitete të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare për të përmbushur në mënyrë efektive ndërhyrjet për të drejtat e fëmijëve në nivel kombëtar dhe vendor.

Promovimi i të drejtave të fëmijëve, me qëllim ndryshimin e normave shoqërore për respektimin e të drejtave të fëmijëve në çdo mjedis dhe kontekst.

Nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve në të gjitha proceset që lidhen me mbrojtjen e tyre. Ndërgjegjësimi i profesionistëve, prindërve, komuniteteve dhe fëmijëve mbi pasojat e dhunës në mirëqenien dhe mirëritjen e fëmijëve, nevojën për raportim dhe identifikim sa më të hershëm si dhe mbi mekanizmave për të kërkuar ndihmë.

## E drejta për zhvillim dhe edukim

Arsimi përbën një faktor thelbësor të zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve njerëzore, mirëqenies ekonomike, zhvillimit të vlerave universale dhe përmirësimit të cilësisë së jetës në nivel individual, familjar e shoqëror. Sistemi arsimor që ka në qendër nxënësin stimulon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe i shërben konsolidimit të shoqërisë demokratike.

Raporti i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (2012) rekomandon që shteti të rrisë financimin për sektorin e arsimit; të zhvillojë programe efektive dhe të qëndrueshme për tërheqjen e nxënësve që braktisin shkollën; të investojë në trajnimin e mësuesve, dhe në mirëmbajtjen e rinovimit e infrastrukturës arsimore, veçanërisht në zonat rurale; të sigurojë që fëmijët romë, fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje në programet gjithëpërfshirëse parashkollore për të lehtësuar socializimin dhe të nxënit që në moshë të hershme; të sigurohet aksesimi në arsimin e detyrueshëm gjatë gjithë viteve të shkollimit për të gjithë fëmijë<sup>106</sup>.

PVF 2012 – 2015 ka në fokus krijimin e një mjedisi që nxit zhvillimin e fëmijëve që në moshë të hershme, një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në procesin e vendimmarrjes në shkollë dhe jashtë saj. Masat në këtë fushë të drejtë bazohen edhe në masat e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar.

Evidencat ndërkombëtare mbështesin rëndësinë e ndërhyrjeve për kujdesin dhe edukimin në **fëmijërinë e hershme (0-6 vjeç)** me ndikim të konsiderueshëm në arritjet e mëtejshme pozitive tek fëmijët. Në Shqipëri mungon ende një mjedis i përshtatshëm veçanërisht për këtë grup moshë. Ka mekanizma të kufizuar për të harmonizuar politikbërjen shumësektoriale për nxitjen e zhvillimit të fëmijëve më të vegjël se gjashtë vjeç<sup>107</sup>.

Prindërit raportojnë<sup>108</sup> një sërë shqetësimesh në momentet që çojnë fëmijët në çerdhe, ata kanë frikë që nuk do ju ofrohet kujdesi i nevojshëm fëmijëve, numri shumë i madhe i fëmijëve në grupe, pamundësia ekonomike për të paguar çerdhen. Nën at nga ana tjetër shprehen se kanë nevojë për të punuar, për të qenë më të lira për tu marr me veten dhe me fëmijët e tjerë, fëmija ndjek programin edukativ të çerdhes dhe kopshtit, ka raste për familjet e varfëra që fëmija mund të ushqehet edhe me mirë në kopsht/çerdhe sesa në familje.

Shërbimet për **kujdesin dhe zhvillimin e fëmijëve 0-3 vjeç** janë organizuar përmes çerdheve (publike dhe private). Administrimi i çerdheve është një funksion i ushtruar plotësisht nga pushteti vendor<sup>109</sup>. Çerdhet përcaktohen si institucione përgjegjëse për rritjen, edukimin dhe zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve deri në 3 vjeç<sup>110</sup>. Dokumenti mbi rregulloren higjienosantare për çerdhet përcakton parametrat për siguri, infrastrukturë, higjenë dhe ushqyerje. Vitet e fundit, komponenti i ushqyerjes (menyja) është përditësuar, ndjekur nga mekanizma monitorime të kontrollit të cilësisë<sup>111</sup>.

106. Committee on the Rights of the Child, 2012. CRC recommendations

107. Banka Botërore (2014) "Raporti QSRMA – Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme", Tiranë, Shqipëri.

108. Takim me prindërit në njësinë bashkiake Nr. 6, Tiranë

109. Ligji Nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor"

110. Rregullorja higjieno-sanitare (26.10.1994) "Për ngritjen dhe funksionimin e çerdheve" Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit.

111. <http://www.shendetesia.gov.al/al/publikime/shendeti-publik/dokumenta-mbi-shendetin-publik>

Numri i çerdheve dhe fëmijëve që frekuentojnë këtë shërbim është i panjohur, edhe pse pushteti vendor duhet të raportojë këto të dhëna tek ASHMDF<sup>112</sup>. Për herë të parë ofrohen të dhëna për 46 fëmijë Romë të regjistruar në 9 çerdhe në 2014<sup>113</sup>.

Situata aktuale dhe nevojat për ndryshim në kuadër të organizimit dhe ofrimit të shërbimit për fëmijët 0-3 vjeç janë pasqyruar në një raport vlerësimi të mbështetur nga UNICEF<sup>114</sup>. Realizuar në perspektivën e zbatimit të standardeve të zhvillimit të fëmijës me fokus edukimin, prezantohen në rekomandimet për të promovuar kujdesin, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve. Njohja e nevojave dhe problematikave për shërbimet e fëmijëve në çerdhe vlerësohet si një hap pozitiv, marrë në konsideratë 'errësirën' e deritanishme për shërbimin e ofruar për këtë grupmoshë, si në kuadër të frekuentimit, dhe atë të cilësisë së shërbimeve të marra.

Në bashkëpunim me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, mbështetur nga UNICEF, janë hartuar standardet fizike të ndërtimit të çerdheve, që i përgjigjen nevojave zhvillimore të fëmijëve të vegjël sipas standardeve bashkëkohore<sup>115</sup>, por ato janë të paintegruara aktualisht në dokumentet rregullatorë të Ministrisë së Shëndetësisë.

Standartet e kujdesit dhe zhvillimit për fëmijët 0-3 vjeç janë zhvilluar nga një grup profesionistësh të fushës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Arsimit mbështetur nga UNICEF, por ende të pamiratuara nga ndonjë Këshillë Bashkiak në vend.

**Arsimi parashkollor** (publik dhe privat) është organizuar në kopshte dhe në klasa përgatitore ku edukohen fëmijët 3 deri 6 vjeç. Klasat përgatitore funksionojnë kryesisht në shkollat e arsimit bazë dhe frekuentohen nga fëmijë të moshës 5 vjeç që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor. Për vitin 2012<sup>116</sup> regjistrimi neto i fëmijëve në kopshte kundrejt grupmoshës së popullsisë (NER) është 76.3%.

44

Një arritje të rëndësishme në arsimin parashkollor shënon përfundimi i hartimit të Standardeve të Zhvillimit dhe Edukimit të Hershëm. Përmes mbështetjes së ekspertizës ndërkombëtare me ndihmën e UNICEF, këto standarde krahasohen me modelet më bashkëkohore të fushës.

Për më tepër, Draft Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 përcakton një sërë ndëhyrjesh për edukimin parashkollor në Shqipëri, të cilat synojnë:

- Universalizimin e vitit parashkollor (5-6 vjeç) në Shqipëri deri në 2018;
- Përgatitjen e kurrikulës së parashkollorit, bazuar në standardet;
- Hartimin e paketës trajnuese për mësuesit;
- Specifikimin e treguesve monitorues/vlerësues të cilësisë dhe rezultateve të të nxëniet
- Prezanitmin e një filozofie të re të gjithëpërfshirjes të grupeve të veçanta në parashkollor dhe klasat përgatitore (fëmijë romë, egjiptianë, fëmijët me aftësi të kufizuara, ata nga pakica kombëtare, etj.).

112. VKM Nr. 267, datë 12.04.2012 "Llojet dhe mënyrën e shkëmbimit të informacionit e të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF-ja e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor"

113. CRCA, YWCA, Observatory (2014), "Studimi kombëtar - Aksesi i fëmijëve Romë në arsim dhe shërbimet shëndetësore", UNICEF, Shqipëri

114. Haxhiymeri E., Ndrio M., Hallkaj E., Boci A., (2013) "Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve të kujdesit shëndetësor, çerdheve dhe institucioneve të kujdesit rezidencial për fëmijët 0-3 vjeç", UNICEF, Shqipëri, Nëntor 2013.

115. <http://www.unicef.org/albania/Standartet-e-Cerdheve.pdf>

116. Burimi INSTAT, vlera e disponueshme vetëm për vitin 2012

MAS, MMSR dhe UNICEF kanë bashkëpunuar në përmirësimin e përfshirjes së hershme të fëmijëve Romë të moshës parashkollore në Shqipëri nën ndërhyrjen “Çdo fëmijë Rom në kopsht”. Lehtësuar nga udhëzimi i MAS<sup>117</sup> për përfshirjen me përparësi të fëmijëve Romë në kopshte dhe monitorimin në vazhdim të situatës së frekuentimit, nga shtatori 2013 - shtatori 2014 janë regjistruar mbi 300 fëmijë.

Në kuadër të kësaj nisme, gjithë institucionet arsimore parauniversitare lokale hartuan për herë të parë një plan veprimi për rritjen e frekuentimit të kopshtit dhe integrimin e fëmijëve romë në kopshte për vitin shkollor 2014-2015<sup>118</sup>. Më konkretisht, plani i veprimit përmbante: objektiva të matshëm, statistikave të komunitetit rom, të dhënat për fëmijët romë 3-6 vjeç.

Çdo DAR/ZA duhet të dokumentojë progresin, si dhe ecurinë e realizimit të nismës. Gjithashtu, DAR/ZA-të janë ngarkuar të bashkëpunojnë me njësitë bazë të qeverisjes vendore për të menaxhuar rastet kur prindi nuk ka dokumentacionin e nevojshëm; të monitorojnë rastet e kopshteve dhe shkollave që nuk kanë të regjistruar fëmijë romë në kopsht, edhe pse këta fëmijë banojnë në zonat në juridiksion të tyre; të monitorojnë punën e kopshteve e të shkollave për integrimin e fëmijëve romë të regjistruar; të sigurojnë përkujdesje të posaçme nga shërbimi psikosocial për fëmijët romë që ndjekin kopshtin, si dhe të shohin me përparësi sigurimin e transportit për fëmijët romë të moshës parashkollore.

**Arsimi bazë** fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Numri i nxënësve që përfundojnë arsimin bazë dhe vazhdojnë arsimin e mesëm të lartë ka arritur në 92%. Raporti mësues nxënës për arsimin bazë është përafërsisht 1:16. Numri i shkollave private të arsimit bazë përbën 8.5%. Numri i nxënësve që ndjekin arsimin privat përbën 7.2% të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Ndryshimet në hartën e përqendrimit të popullsisë kanë sjellë rritje të numrit të nxënësve (veçanërisht në arsimin bazë) në shkollat e qendrave të mëdha urbane dhe ulje të numrit të nxënësve në zonat rurale. Nga 1070 shkollat me klasa të bashkuara (ku numri i nxënësve është nën 40), mundësia për përqendrim pranë një shkolle tjetër 9 vjeçare zbatohet vetëm në 321 shkolla<sup>119</sup>.

Draft Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 e hartuar pajtohet me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit në Europë dhe në botë. Si e tillë, ajo synon: (i) të përmirësojë cilësinë e arsimit për të gjithë; (ii) të identifikojë veprimtaritë kryesore dhe të planifikojë buxhetet e nevojshme; (iii) të ndihmojë bashkëpunimin mes agjencive qeveritare, partnerëve tanë dhe grupeve të tjera me interes ndaj arsimit, në drejtim të shtrirjes së veprimtarive dhe të investimeve në arsim, në kufijtë e një kuadri të njëzuar konceptimi, planifikimi dhe financimi<sup>120</sup>.

Ndryshimet e fundit ligjore<sup>121</sup> sjellin disa ndryshime që reflektojnë prioritetet aktuale të qeverisë dhe harmonizimin e koncepteve të kornizës kurrikulare, kompetencave themelore, qëllimin e arsimit parauniversitar, strukturën e arsimit bazë.

117. Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Udhëzim 21, datë 08.08.2014 “Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët Romë”

118. <http://www.arsimi.gov.al/al/neesroom/fjalime/fjala-e-ministres-lindita-nikolla-ne-konferencen-kombetare-per-arsimimin-e-femijeve-rom-nga-sfidat-drejt-mundesive&page=1>

119. Karameta, P. et al (2014) “Reforma e sistemit arsimor parauniversitar” – Raport Vlerësues paraprak, Grupi I punës për reformimin e arsimit parauniversitar, MAS

120. Dokument i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020 (Draft). MAS

121. Ligji nr. 56/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

Është hartuar **Korniza Kurrikulare** e arsimit parauniversitar e cila është produkt i harmonizimit të politikës arsimore të Shqipërisë dhe të politikës arsimore të Kosovës dhe ka si bosht qendror kompetencat themelore të nxënësve gjatë gjithë jetës. Është hartuar kurrikula bërthamë, e mbështetur në kornizën kurrikulare, me cilësinë e një dokumenti rregullator të ecurisë së zhvillimit të mëtejshëm të kurrikulës së arsimit parauniversitar. Kurrikula bërthamë përmban: rezultatet e të nxënësve për çdo kompetencë kyçe dhe fushë të nxënësve sipas shkallëve të kurrikulës, metodologjitë e zbatimit të kurrikulës, të vlerësimit të nxënësve dhe shpërndarjen kohore të sugjeruar për secilën fushë.<sup>122</sup>

Është përgatitur udhëzuesi me titull **“Të nxënësve me situata, kompetenca dhe situata e të nxënësve”**<sup>123</sup>, i cili paraqet konceptin e situatës së të nxënësve, rolin dhe funksionin e saj në procesin e të nxënësve, mënyrat e planifikimit, formatin e situatës së të nxënësve si dhe modele të situatave të të nxënësve në lëndë të ndryshme, për klasat I dhe 6. Ky udhëzues ka si qëllim të ndihmojë mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe prindërit, në konceptimin dhe planifikimin e veprimtarive mësimore që zhvillojnë kompetencat dhe të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe përmban modele të situatave të të nxënësve që shërbejnë si orientim për konceptimin dhe planifikimin e vazhdueshëm të tyre nga ana e mësuesve.

“Karta e Performancës së Shkollës” dhe “Udhëzuesi për Kartën e Performancës së Shkollës” ofron mundësinë për mbledhjen e të dhënave gjatë një viti shkollor. Ajo garanton cilësinë e ofertës së shkollës përmes treguesve të standartizuar dhe shërben si instrument për vetëvlerësimin e shkollës dhe inspektimin. Karta e Performancës së Shkollës përmban tregues të matshëm, objektivë, të verifikueshëm dhe të kuptueshëm në fushat e kurrikulës së përvetësuar, kurrikulës së zbatuar, menaxhimit të shkollës, zhvillimit të burimeve njerëzore, klimës dhe etikës, kujdesit ndaj nxënësve<sup>124</sup>.

46

Me qëllim përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, mbështetja me udhëzimet mbështetëse për përmirësimin e standardeve të përgjithshme të mësuesve<sup>125</sup> dhe kriteret e procedurat e kualifikimit për mësuesit<sup>126</sup>, ka vijuar me iniciativën më të re të MAS “Mësues për Shqipërinë”. Kjo iniciativë synon të nxisë përthithjen e profesionistëve në sistem, por edhe menaxhimin e burimeve njerëzore në arsimin parauniversitar, përmes ngritjes së një portali online për punësim.

Në kuadër të gjithëpërfshirjes, ofrimi i shërbimit arsimor për anëtarët e komunitetit romë është mbështetur në krijimin real të mundësive të barabarta në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, duke u bazuar veçanërisht në zbatimin e “Planit Kombëtar të Veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2009-2015”, si dhe në plotësimin e rekomandimeve të seminarit mbi ndërgjegjësimin për përfshirjen e komuniteteve romë, në kuadër të integritetit të Shqipërisë në BE. Statistikat flasin për tregues pozitivë në përmbushje të synimeve dhe prioriteteve të paravendosura në fushën e arsimit. Kështu, në vitin shkollor 2014-2015 janë regjistruar në arsimin parauniversitar 5766 fëmijë romë, rreth 1601 më shumë në krahasim me vitin e kaluar shkollor prej të cilëve: 921 fëmijë romë në arsimin parashkollor (312 më shumë se një vit më parë) prej tyre 298 në klasat përgatitore; 4437

122. Raporti vjetor 2014. IZHA

123. Raporti vjetor 2014. IZHA

124. Urdhëri Nr. 477, datë 06.12.2014 për miratimin e “Kartës së Performancës së shkollës” dhe “Udhëzuesit për kartën e performancës së shkollës.

125. MAS, Udhëzimi Nr. 5, datë 25.02.2013 “Për standardet e përgjithshme të mësuesit”

126. MAS, Udhëzimi Nr. 2, datë 05.02.2014 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”



nxënës romë në arsimin bazë; 408 nxënës romë në arsimin e mesëm. Tekstet shkollore falas përfitohej nga rreth 32/19 nxënës romë<sup>127</sup>, por edhe nga kategori të tjera si fëmijët egiptianë, të trafikuar, të miturit që vuajnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe paraburgimit etj)

Në dobi të rritjes së përfshirjes së fëmijëve romë në shkollat e arsimit parauniversitar është krijuar databaza e të dhënave për regjistrimin e fëmijëve romë, të moshës së detyrimit shkollor, në kopsht dhe shkollë, nga viti 2010 e në vijim.

MAS mbështetur nga aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë e vendorë kanë realizuar iniciativa të ndryshme me fokus familjet dhe fëmijët romë, si kampe verore, ofrimi i ushqimit në shkollë, veprimtari kulturore, kualifikime specifike për mësues<sup>128</sup>. Një projekt rajonal<sup>129</sup> do të trajtojë përjashtimin dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve romë dhe të grupeve të marginalizuara, duke përmirësuar qasjen për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, shëndetësinë dhe arsimimin<sup>130</sup>.

Në bordet e shkollave pranë komuniteteve Romë është inkurajuar përfshirja e prindërve në organet kolegjiale. 98 prindër Romë dhe Egjiptianë janë pjesë e bordeve të shkollave (nga rreth 63 shkolla ku rezulton prania e fëmijëve të komunitetit Rom)<sup>131</sup>.

Edhe nga konsultimet<sup>132</sup>, fëmijët raportojnë organizimin e aktiviteteve gjithëpërfshirëse për të rritur më shumë mundësinë e pjesëmarrjes së fëmijëve. Fëmijët shprehën se kontributi i fëmijëve është shumë i rëndësishëm për të zgjedhur aktivitetet që vetë fëmijët duan sipas nevojave të identifikuar nga vetë ata.

Braktisja e shkollës vazhdon të jetë shqetësuese dhe është e pranishme dukuria e fëmijëve aktualisht jashtë sistemit arsimor, çfarë ka bërë që arsimi bazë të mos frekuentohet kryesisht nga fëmijët e shtresave në nevojë. Fenomeni është më shqetësues për vajzat romë dhe për fëmijët e familjeve me të ardhura të pakta, të zonave të thella malore, për vajzat në zonat me mentalitet të prapambetur dhe me probleme të tjera sociale<sup>133</sup>. Për të adresuar braktisjen shkollore, marrëveshja<sup>134</sup> e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Shëndetësisë, është pasuar nga udhëzime specifike për Ministrinë dhe Urdhëri i Përbashkët Nr. 2, datë 5.01.2015 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit” datë 02.08.2013 “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”<sup>135</sup>.

Është hartuar udhëzimi që përcakton organizimin e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme<sup>135</sup>. Ky udhëzim u vjen në ndihmë nxënësve që kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë. Përforcohet në këtë kuadër edhe e drejta e ndjekjes së “shansit të dytë” për fëmijët deri në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç, për të gjithë ata që

127. <http://www.arsimi.gov.al/newsroom/fjalime/fjala-e-ministres-lindita-nikolla-ne-konferencen-kombetare-per-arsimimin-e-femijeve-rom-nga-sfidat-drejt-mundesive&page=1>

128. Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, 2013-2014

129. “Ndërprerja e ciklit të përjashtimit të fëmijëve romë përmes zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe arsimimit” financohet nga qeveria e Austrisë dhe zhvillohet përgjatë periudhës janar 2013 - dhjetor 2016 në Shqipëri, Maqedoni dhe Serbi.

130. Dokument i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020 (Draft). MAS

131. Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, 2013-2014

132. Konsultim me fëmijët e Zërit 16 +, Elbasan

133. Dokument i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020 (Draft). MAS

134. Marrëveshja e përbashkët (2013) “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë të moshës së detyrimit shkollor”

135. MAS, Udhëzimi Nr. 29, datë 02.08.2013, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme.



kanë braktisur shkollën, e ndërpresin ose nuk e kanë ndjekur dhe nuk kthehen në shkollën bazë me kohë të plotë dhe as nuk ndjekin shkollën bazë me kohë të pjesshme.

Një tjetër udhëzim<sup>136</sup> synon të garantojë gëzimin e të drejtës për të ndjekur arsimin bazë me kohë të plotë, brenda moshës së arsimit të detyruar, fëmijëve që për arsye të ndryshme nuk janë regjistruar në kohë, kanë ndërprerë shkollimin për më tepër se dy vite.

Edhe në kuadër të programit “Shkolla si Qendër Komunitare” janë ndërmarrë një sërë masash për zbutjen e fenomenit të braktisjes së shkollës. Një ndër qasjet e suksesshme të mbështetur, është organizimi i klasave suplementare/përforcuese për të frenuar braktisjen e shkollës nga fëmijët romë në bashkëpunim me pushtetin vendor<sup>137</sup>.

Janë dhënë falas tekstet për nxënësit romë, për nxënësit e shkollave të pakicave kombëtare, për fëmijët shqiptarë emigrantë, për nxënësit nga familjet me ndihmë sociale dhe për ata që kanë statusin e të verbërve. Çmimi i blerjes së tyre mbulohet nga buxheti i Ministrisë<sup>138</sup>.

Për të përmirësuar kushtet/mjediset fizike në shkolla, ndërtimin e shkollave të reja si edhe rehabilitimin e atyre ekzistuese, të dhënat e raportuara për vitin 2013 dëshmojnë për ndërtimin apo renovimin e 1336 objekteve arsimore, nga të cilat 359 janë objekte të reja dhe 977 objekte të rikonstruara.

Përsa i përket *infrastrukturës së mësimdhënies*, shkollat publike disponojnë laboratorë demonstrues të lëndëve fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi, por në shumë raste ata nuk janë funksionalë. Mosfunksionimi i laboratorëve vjen si rezultat i sasisë së pamjaftueshme të mjeteve laboratorike dhe mjediseve të nevojshme për ngritjen e klasave laborator. Jo gjithmonë mjetet laboratorike që ofrohen nga DAR-et, përputhen me kërkesat e programeve për këto mjete, apo të nevojave që kanë realisht shkollat<sup>139</sup>. Gjithashtu, koordinimi jo i mirë ndërmjet shkollave dhe DAR-ve, si dhe mungesa e fondeve ka bërë që bibliotekat të mos furnizohen me tituj të rinj librash që shërbejnë për nxitjen, motivimin dhe përjasjen e nxënësve ndaj librit.

Sot në sistemin arsimor parauniversitar ka 1496 laboratorë kompjuterësh; kështu, në më shumë se 1/3 e shkollave, nxënësit kanë mundësi të kufizuara për marrjen e informacionit online. Në laboratorët aktualë jo të gjithë kompjuterat janë funksionalë<sup>140</sup>.

Pothuajse në të gjitha shkollat e inspektuara nga IKAP në 2013<sup>141</sup>, janë ngritur organet kolegjiale si: Bordi i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli Pedagogjik, Qeveria e Nxënësve dhe Këshilli i Disiplinës, por funksionimi i tyre vazhdon të mbetet një sfidë e vazhdueshme. Mungesa e një bashkëpunimi efikas me to reflekton një hallkë “të këputur” të funksionimit të mirë të institucioneve arsimore.

Aktualisht, **arsimi i mesëm** ofrohet si *arsim i mesëm i përgjithshëm* (gjimnaz), *arsim profesional* dhe *arsim i orientuar*. Gjimnazet përbëhen nga 3 vite shkollimi, ndërsa arsimimi në shkollat me kohë të

136. MAS, Udhëzimi Nr. 31, datë 02.08.2013 “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasë të arsimit bazë.”

137. <http://www.arsimi.gov.al/al/neesroom/fjalime/fjala-e-ministres-lindita-nikolla-ne-konferencen-kombetare-per-arsimin-e-femijeve-rom-nga-sfidat-drejt-mundesive&page=1>

138. Dokument i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020 (Draft). MAS

139. Gjedia, R., et al (2013) “Raport Vlerësimi i fushave ‘Klima dhe Etika në Shkollë dhe ‘Kujdesi ndaj Nxënësit’” IKAP


140. Dokument i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020 (Draft). MAS

141. Gjedia, R., et al (2013) “Raport Vlerësimi i fushave ‘Klima dhe Etika në Shkollë dhe ‘Kujdesi ndaj Nxënësit’” IKAP

pjeshme zgjat 4 vjet. Koha e arsimimit të mesëm profesional është e organizuar në dy, tre dhe katër vjet. Arsimi i orientuar përfshin shkollat e gjuhëve të huaja dhe zgjat 3 vjet, ndërsa arsimi i mesëm për fushat e artit dhe sportit zgjat tre ose 4 vjet.

Vihet re rritje e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm vitet e fundit. Për vitin shkollor 2008-2009 tërheqja e nxënësve në arsimin e mesëm shënonte 80% të nxënësve që mbaronin arsimin e detyruar, ndërsa në vitin shkollor 2013-2014 ky tregues arriti vlerën 93%<sup>142</sup>. Megjithatë, përqindja e thithjes nga arsimi bazë mund të konsiderohet e ulët, e krahasuar me standartet evropiane (95 – 100%). Nga ana tjetër, gjimnazet vijnë të paraqesin probleme infrastrukture, duke vazhduar me mbipopullimin e klasave në qytetet e mëdha apo me numrin e paktë të nxënësve në zonat rurale, gjë që rrit shpenzimet për nxënës në to.

Rezultatet e nxënësve përfaqësojnë treguesin kryesor të cilësisë dhe të performancës së sistemit arsimor, sidomos, kur kjo lidhet me pajisjen e nxënësve me njohuri dhe me kompetenca për përballimin e kërkesave të kohës. Në vijim, paraqiten rezultatet në tre provimet e Maturës Shtetërore dhe në dy Provimet e Lirimit (kl. IX)<sup>143</sup>, duke reflektuar vlera të ulta të rezultateve në vitin e fundit të raportuar.



Të dhënat e vlerësimit të PISA vërtetojnë se performanca e përgjithshme e Shqipërisë mbetet e ulët. Shqipëria është rreth një vit shkollor mbrapa vendeve si Bullgaria, Rumania dhe Serbia dhe rreth dy vjet e gjysëm shkollorë (rreth 100 pikë PVNN) pas mesatares së OECD-së<sup>144</sup>.

Shërbimi psikosocial në kopësht dhe shkolla nuk ka numrin e mjaftueshëm të profesionistëve për adresimin e nevojave të fëmijëve siç është përcaktuar në Urdhrin Nr. 344, datë 19.08.2013 të Ministrisë të MAS. Nuk mbulohen me specialistë të gjitha institucionet arsimore, për shkak të numrit të kufizuar të profesionistëve në sistem, vështirësive infrastrukurore apo të pozicionit gjeografik të shkollave<sup>145</sup>.

142. Burimi: Zyra e Statistikave në MAS.

143. Raporti për rezultatet e Maturës shtetërore – AKP, 2014

144. Banka Botërore, (2014). *Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri*.

145. Dokument i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020 (Draft). MAS

Sipas urdhërit nr. 382, datë 23.09.2014 është ngritur grupi i punës për rishqyrtimin e paketës ligjore dhe hartimin e dokumentacionit të punës për shërbimin psiko-social në arsimin parauniversitar. Grupi i punës ka analizuar situatën në mbështetje të rekomandimeve të bëra nga DAR/ZA dhe sugjerimeve të dala nga takimi kombëtar për shërbimin psiko-social; ka rishikuar urdhërin “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”, dhe ka propozuar ndryshimet e nevojshme për organizimin e strukturës së shërbimit psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare. Projekturdhëri i ri do të përshkruajë funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet arsimore. Në mbështetje të këtij urdhëri, do të vijojë puna për hartimin e përshkrimeve të punës për psikologun shkollor, punonjësin social dhe supervizorin e njësisë dhe do të përgatitet manuali i punës për shërbimin psikosocial në mbështetje të urdhërit përkatës.

Që nga viti 2009/10, sistemi i **Arsimit të Formimit Profesional (AFP)** është 2+1+1, në mënyrë që t’u ofrojë studentëve si arsimin e përgjithshëm, ashtu edhe atë profesional (teorik dhe praktik), duke i përgatitur për punë dhe arsimim të mëtejshëm. AFP përbëhet nga Shkollat e Arsimit Profesional dhe Qendrat e Kualifikimit Profesional. Arsimi dhe formimi teknik-profesional ofrohet në 53 shkolla (44 publike, duke përfshirë degët në shkollat e mesme të përgjithshme dhe 9 private), kryesisht të gjitha me vendndodhje në zonat urbane. Shumica e shkollave ofrojnë dy deri në katër profile, ndër to vetëm një e katërta e të gjitha shkollave ofrojnë më shumë se tetë zgjedhje profesionale. Përsa i përket infrastrukturës vihet re se mjediset e reparteve të punës në shkolla janë të vjetruara dhe në shumë raste mësimdhënia ofrohet në ndërtesa tërësisht të amortizuara.<sup>146</sup>

Qeveria shqiptare ka shpallur në programin e qeverisë për periudhën 2013-2017 se do të zbatojë një model të ri, për rritjen e ekonomisë së vendit gjatë 15 deri 20 vitet e ardhshme, bazuar në politika të strukturuar dhe të përpunuara më mirë, me një gamë më gjithëpërfshirëse, për t’i dhënë një shtysë maksimale rritjes ekonomike, për të siguruar qëndrueshmëri të komponentëve të saj, për të rritur produktin e brendshëm dhe shkallën e eksporteve, si edhe për të krijuar kushtet për hapjen e një numri të madh vendesh pune në sektorët ekonomikë më strategjikë të vendit.

Në këtë kuadër është hartuar “Strategjia për Punësim dhe Aftësim 2014 – 2020”, e cila është konsultuar me grupet e interesit. Kjo strategji ka si qëllim të nxisë vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi për gjithë femrat dhe meshkujt shqiptarë gjatë gjithë ciklit të jetës dhe përbën një hap shumë të rëndësishëm për sistemin e AFP. Në kuadër të kësaj strategjie, janë hartuar politika që synojnë përmirësimin e perspektivave për punësim të cilat do të kenë një fushë më të madhe veprimi, ndërsa programet do të synojnë ata persona, të cilët janë në gjendje më të pafavorshme në tregun e punës, veçanërisht individët me nivel të ulët në arsim dhe kualifikim, si femrat, të rinjtë, grupet e tjera të cenueshme dhe ata persona, të cilët jetojnë në zonat rurale. Dizenjimi i një kuadri të ri për nxitjen e punësimit, do të sigurojë përdorimin e politikave më efikase dhe me më shumë burime për tregun e punës.

Objektivat dhe produktet e “Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi” do të bëhen funksionale nëpërmjet Planit të Veprimit dhe dokumenteve të tjera të planifikimit tematik, të cilat janë hartuar tashmë dhe pritet të miratohen së bashku me strategjinë. Zbatimi i Planit të Veprimit do të mbikëqyret nëpërmjet treguesve të arritjeve, të cilët masin rezultatet e programeve aktive të tregut të punës, caktojnë përgjegjësitë për zbatim dhe përcaktojnë burimet financiare.

146. MMSR “Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë femrat dhe meshkujt”, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2014-2020

## Rekomandime

Mbështetja nga struktura qendrore dhe lokale për të siguruar infrastrukturën fizike, materialet dhe pajisjet e nevojshme për të lehtësuar procesin e zhvillimit dhe të nxënimit të fëmijëve.

Ofrimi i shërbimeve të kujdesit dhe zhvillimit të fëmijëve (0-3 vjeç) në çerdhe përmes përcaktimit dhe zbatimit të standardeve bashkëkohore dhe të unifikuara për të gjitha bashkitë.

Hartimi dhe përdorimi i standardeve si instrumenta për të ofruar programe parashkollore cilësore, efektive, integrale dhe të vazhdueshme për të gjithë fëmijët 3 dhe 6 vjeç.

Përmirësimi i mekanizmave që sigurojnë aksesin në çerdhe, kopshte dhe shkolla, përfshirë skemat e mbështetjes financiare në nivel qendror dhe vendor për të realizuar të drejtën e zhvillimit dhe të arsimit edhe për grupet e fëmijëve më vulnerabël të shoqërisë.

Përmirësimi i monitorimit të ndjekjes dhe progresit të fëmijëve në kopësht dhe shkollë, për të siguruar që grupet më të cënueshme si vajzat, romë dhe fëmijët me aftësi të kufizuar, kanë mundësi të ndjekin të plotë ciklin e arsimit.

Krijimi i një mjedisi mbështetës të kujdesit, zhvillimit dhe arsimit përmes përmirësimit të praktikave përfshirëse dhe shërbimit psikosocial në institucionet e kujdesit, zhvillimit dhe arsimit të fëmijëve.

Zhvillimi i programeve edukuese mbi dialogun restaurues dhe ndërmjetësimin, me qëllim parandalimin e sjelljeve antisociale dhe konfliktuese në grupmoshat shkollore.

Shtrirja dhe përmirësimi i zbatimit të programit “Shkolla Komunitare”, duke theksuar institucionalizimin e programeve të edukimit dhe përfshirjes së prindërve, fëmijëve dhe komunitetit në përgjithësi.

Përmirësimi i shërbimit psikosocial në shkolla dhe ndërlidhjes së sistemit shkollor me sistemin e mbrojtjes së fëmijëve.

Përmirësimi i kurrikulës për arsimin e mesëm profesional dhe krijimi i mundësive për praktikimin e aftësive të nxëna në bashkëpunim me partnerë privatë dhe publikë.

Përmirësimi i angazhimit të qeverisjes vendore për të ofruar shërbim cilësor të kujdesit dhe zhvillimit të fëmijëve në çerdhe dhe rritje të aksesit.

Shfrytëzimi i çerdheve dhe kopshteve si një hapësirë për të ndihmuar prindërit drejt modeleve të prindërimit pozitiv nëpërmjet trajnimeve, këshillimeve, etj.

Forcimi i ndërveprimit mes sistemit të arsimit e formimit profesional dhe industrisë dhe orientimi i arsimit profesional në një drejtim të kërkesave reale të tregut të punës.

## E drejta për kujdes shëndetësor

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve sanksionon të drejtën e fëmijëve për të përfituar kujdes cilësor shëndetësor. Kjo e drejtë përcaktohet edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës, “shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti dhe kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor”<sup>147</sup>. Ky angazhim kushtetues mbështetet edhe nga parimet për shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirëse shëndetësore, të cilat gjenden në ligjet “Për Shëndetin Riprodhues”<sup>148</sup> dhe “Për Shëndetin Publik”<sup>149</sup>.

Politika për ofrimin e sigurimit të shërbimeve të përshtatshme për të garantuar kujdes shëndetësor për fëmijët është trajtuar në disa dokumente strategjike kombëtarë, të tillë si: Strategjia e Shëndetit Riprodhues, Plani Kombëtar i Veprimit për fëmijë, Plani i Veprimit të Romëve dhe Egjiptianëve, si edhe Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Këto strategji janë mbështetur tek Plani i Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin (Kajro, 1994), si dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit<sup>150</sup>, ku zvogëlimi i vdekshmërisë amtare, foshnjore dhe fëmimore janë tre nga tetë indikatorët e zhvillimit të lidhura direkt me kujdesin parësor shëndetësor të nënës dhe fëmijës.

Reformimi i sistemit të kujdesit shëndetësor me qëllim sigurimin e shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse, është një nga objektivat themelore të programit të ri të qeverisë (2013). Në këtë program, i kushtohet vëmendje zvogëlimit të pabarazive si edhe rritjes së cilësisë të shërbimeve shëndetësore, duke përcaktuar edhe ndryshime thelbësore në mënyrën e financimit me qëllim mbulimin e plotë të kostos dhe zvogëlim të barrës financiare mbi kurrizin e qytetarëve, sidomos të atyre që vijnë nga grupe shoqërisht të përjashtuara.

### Kujdesi shëndetësor për nënën dhe fëmijën

Politikat e kujdesit shëndetësor të nënës dhe fëmijës kanë synuar përmirësimin e vazhdueshëm të treguesve të ushqyerjes dhe shëndetit të nënës dhe fëmijës me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. I gjithë shërbimi i kujdesit për shtatzëninë dhe lindjen dhe kujdesi për mirërritjen e fëmijës ofrohet pa pagesë<sup>151</sup> (përfshirë edhe gratë pa sigurim shëndetësor).

Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve dhe arritjeve, sistemi i kujdesit shëndetësor, në veçanti, sistemi i kujdesit shëndetësor të nënës dhe fëmijës, përballet me probleme kritike<sup>152</sup>. Mbrojtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shëndetit të nënës dhe fëmijës, ndonëse nuk trajtohet si komponent i veçantë i reformës shëndetësore të saponërmarrë, konsiderohet prioritetet i politikës publike të kujdesit shëndetësor.

147. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998, Neni 55.

148. <http://www.ishp.gov.al/ep-content/uploads/2012/03/P%C3%ABr-sh%C3%ABndetin-riprodhues.pdf>

149. <http://www.ishp.gov.al/ep-content/uploads/2012/03/Ligji-i-shendetit-publik.pdf>

150. Pas vitit 2015 Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit janë zëvendësuar me Objektivat për Zhvillimit të Qëndrueshëm

151. Urdhër i Ministrisë të Shëndetësisë, Nr. 528, datë. 9/10/2013.

152. Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, 2013-2014

Janë miratuar “Standartet e cilësisë së konsultoreve të gruas dhe fëmijës”<sup>153</sup>, si edhe udhëzime dhe protokolle të përditësuara lidhur me kujdesin prenatal, postnatal për gratë dhe foshnjën e porsalindur dhe kujdesin për mirërritjen e fëmijës 0-6 vjeç<sup>154</sup>.

Kujdesi paralindjes	Kujdesi pas lindjes	Monitorimi
Vizitat antenatale për gruan shtatzënë	Vizitat e kontrollit për kujdesin shëndetësor të nënës pas lindjes	Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 0-6 muajsh
Shtimi në peshë gjatë shtatzënisë	Kujdesi paslindjes për foshnjën e porsalindur	Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 6-24 muajsh
Shtesat në vitamina dhe minerale për gruan shtatzënë	Menaxhimi i problemeve shëndetësore të nënës pas lindjes	Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 2-6 vjeç
Menaxhimi i shqetësimeve dhe problemeve që shfaqen gjatë shtatzënisë	Menaxhimi i problemeve shëndetësore tek i porsalinduri	Monitorimi i zhvillimit të fëmijës 0-6 vjeç
Këshillimi për ushqyerjen me gji gjatë shtatzënisë	Menaxhimi i shqetësimeve të nënës pas lindjes	Ndjekja e rritjes sipas kurbave të rritjes
	Shenjat kërcënuese të neonatit	Vlerësimi i dëgjimit tek fëmijët 0-6 vjeç Vlerësimi i shikimit tek fëmijët 0-6 vjeç

Mbi këtë bazë ligjore u rishikua dokumentacioni shoqëruar për monitorimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës. Është përditësuar kartela e re për konsultoret e gruas dhe kartela e re për konsultoret e fëmijës.

Paralelisht me hartimin e udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike po vijon puna edhe për hartimin e setit të treguesve të performancës dhe atij të standardeve të cilësisë së këtyre shërbimeve.

Për kujdesin spitalor janë përpiluar 15 protokolle klinike kombëtare për obstetrikën dhe neonatologjinë si dhe 27 protokolle klinike për pediatriinë, të akredituara nga Qendra Kombëtare e Akreditimit dhe Cilësisë<sup>155</sup>.

Ministria e Shëndetësisë (MSH) në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetit (OBSH) kanë hartuar protokollin për vlerësimin e cilësisë së kujdesit për nënën dhe të porsalindurin në maternitete. Ky protokoll është një mjet i unifikuar për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve të kujdesit për lindjen dhe foshnjën e porsalindur mbi bazën e standarteve ndërkombëtare<sup>156</sup>. Bazuar në këtë instrument janë realizuar vlerësime në disa rrethe të vendit si Vlorë, Shkodër, Kukës dhe Durrës. Vlerësimi u ndoq nga trajnimi i personelit shëndetësor dhe hartimi i planeve të ndërhyrjes në këto institucione. Si rezultat i procesit në këto rrethe si p.sh. Kukës u vu në jetë rooming-in (praktikë që nuk ekzistonte) - vënia e foshnjës në kontakt me nënën menjëherë mbas lindjes, dhe krijimi i dhomave individuale të lindjes. U realizua përpilimi i një protokollit vendor për spitalin, si shembull se si mund të përshtaten protokollat kombëtarë. Në Durrës, u përmirësua respektimi i të gjitha hapave për menaxhimin e të porsalindurit normal dhe plotësimi i rregullt i partogramës.

153. Urdhër i Ministrisë të Shëndetësisë nr 62, date 19/02/2014

154. VKM nr 101, date 4.02.2015 - Paketa e re e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në kujdesin shëndetësor parësor.

155. Raporti vjetor i monitorimit të planit të veprimit për fëmijë 2012 – 2015, për periudhën qershor 2012 – maj 2013, ASHMDF, MPCSSHB

156. Raporti vjetor i monitorimit të planit të veprimit të fëmijëve 2011 – 2012. ASHMDF

Me qëllim përmirësimit e përkujdesjes së fëmijëve të sëmurë, MSH dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore kanë përgatitur draft Rregulloren për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohshme në punë, ku në dallim nga rregullorja ekzistuese<sup>157</sup> limiti i moshës së fëmijëve për të cilën nëna mund të përfitojë raport mjekësor deri në 14 ditë, do të jetë 14 vjeç dhe jo 7 vjeç.

Gjatë vitit 2014, me asistencën e ILO-s, në kuadër të projektit IPA 2010, MSH ka kontribuar në hartimin e draft-VKM që transponon Direktivën e Këshillit 92/85 EEC “Mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë për punëtorët shtatzëna dhe punëtorët të cilat sapo kanë lindur ose janë me fëmijë në gji”, ku përcaktohen masat dhe standartet minimale që duhet të ndërmerren.

## Parandalimi i kequshqyerjes, obezitetit dhe mbipeshës tek fëmijët

Në kuadër të bashkëpunimit të Qeverisë me OKB, për reduktimin e Kequshqyerjes për Fëmijët është miratuar “Dokumenti Strategjik i Komunikimit Për Ushqyerjen”<sup>158</sup>, nëpërmjet të cilit synohet që problemet e ushqimit, të sigurisë ushqimore të bëhen më të rëndësishme në axhendën e qeverisë, duke ndihmuar dhe në hartimin e ndërhyrjeve të fokusuara drejtpërdrejt në grupet e popullsisë që preken më shumë nga këto probleme; të arrihet një komunikim intensiv rreth ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve në Shqipëri, duke synuar ndryshimin e qëndrueshëm të sjelljes së njerëzve dhe jo thjesht informimin e tyre.

Arritje thelbësore konsiderohet përmirësimi i kuadrit rregullator në këtë fushë. Gjatë vitit 2014 u përfunduan “Udhërrëfyti për Ushqyerjen e Gruas Shtatzënë, Foshnjës dhe Fëmijës së Vogël” si dhe Protokolle Klinike për Ushqyerjen e Gruas Shtatzënë, Foshnjës dhe Fëmijës<sup>159</sup>

Protokollet klinike
Hapat për një ushqyerje të suksesshme me gji në komunitet
Shtesat në mikronutiente tek fëmijët
Ushqyerja e fëmijës me formule foshnjore
Fillimi i ushqyerjes shtesë tek fëmijët
Ushqyerja me gji tek nënat me HIV/AIDS
Ushqyerja me gji në rast sëmundjeje të nënës dhe kur trajtohet me barna

Këto protokolle janë risi, të cilat synojnë ushqyerjen e shëndetëshme të gruas gjatë shtatzënisë, pas lindjes dhe ndjekjen e ushqyerjes së fëmijës 0-6 vjeç sipas eksperiencave edhe të vendeve të zhvilluara të BE dhe të përditësuara sipas rekomandimeve të fundit të OBSH.

157. Rregullore nr. 494, e ISSH-së dhe MSH datë 05.10.1993 “Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohëshme në punë”

158. Urdhërin e Ministrisë të Shëndetësisë Nr.86, dt.20.02.2012

159. Miratuar me Urdhër të Ministrisë të Shëndetësisë nr 157, datë 21.04.2014

Mbështetur në kuadrin rregullator të miratuar<sup>160</sup>, janë hartuar module të akredituara të trajnimit për ofruesit e shërbimit për monitorimin e rritjes dhe ushqyerjes së fëmijëve. Kanë përfunduar trajnimet e personelit shëndetësor në rrethe lidhur me ushqyerjen e fëmijës, ushqyerjen me gji, ndjekjen e rritjes dhe zhvillimit. Gjithsej, vetëm për periudhën mars 2013- mars 2014 janë trajnuar 600 mjekë familjeje dhe infermiere, mami<sup>161</sup>.

Qendrat shëndetsore raportojnë në formularin e vizitës lidhur me ushqyerjen me gji, ushqyerjen komplementare. Gjithashtu nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) janë zhvilluar 6 indikatorë lidhur me ushqyerjen, në listën e indikatorëve kyç (bazë) të shëndetit në Shqipëri, bazuar në qasjen drejt një sistemi të integruar të informacionit për shëndetin në Evropë, sipas marrëveshjes së BE dhe Zyrës Rajonale të OBSH-së për Evropën.

Maternitetet në Tropojë, Shkodër e Kukës janë vlerësuar për t'u certifikuar si institucione që mbrojnë dhe nxisin ushqyerjen me gji. Inspektoriati shtetëror shëndetësor ka kryer inspektime të zbatimit të ligjit për mbrojtjen e ushqyerjes me gji në spitalet, maternitete dhe qendrat shëndetsore në të gjithë vendin, specifikisht mbi zbatimin e hapave për ushqyerjen me gji<sup>162</sup>.

Raporti i katërt i monitorimit të praktikave të tregtimit të formulave foshnjore dhe ushqimeve të industrializuara për foshnja dhe fëmijë të vegjël<sup>163</sup> pati si synim kryesor të shikonte përputhshmërinë e këtyre praktikave të tregtimit me "Ligjin për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Gji". Gjatë procesit të monitorimi u vëzhguan dhe u analizuan praktikat e institucioneve që ofrojnë kujdes për nënat dhe foshnjat, si maternitete, pavione pediatrike, këshillimore të fëmijës. Janë evidentuar thyerjet e ligjit në promovimin e formulave, shqetësim i vërejtur edhe nga Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve në 2012, duke nxjerrë në pah nevojën për fuqizimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nga Inspektoriati i Shëndetësisë.

Çështjet që lidhen me ushqyerjen e shëndetshme për fëmijët, ndonëse kanë pak vite që trajtohen, janë shndërruar në prioritare, për shkak të ndikimit të thellë që kanë mbi shëndetin e fëmijës. Ministria e Shëndetësisë, në kuadrin e Programit Kombëtar "Zvogëlimi i Kequshqyerjes së Fëmijëve Shqiptar" në bashkëpunim me disa Ministri të linjës,<sup>164</sup> u angazhuan për hartimin e "Planit të Veprimit për Ushqimin dhe Ushqyerjen 2013-2020". Ky plan është hartuar në përputhje me kapacitetet kombëtare dhe profilin epidemiologjik të vendit dhe promovon mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit publik. Plani Kombëtar i Veprimit për Ushqimin dhe Ushqyerjen i ka kushtuar një fokus të veçantë kontrollit dhe reduktimit të mbipeshës dhe obezitetit të popullatës shqiptare në përgjithësi, dhe fëmijëve të vegjël në veçanti, duke planifikuar edhe një sërë aksionesh të vazhdueshme në nivel kombëtar dhe vendor për përmbushjen e këtij objekti, nën optikën e një përqsajeje të integruar për reduktimin e faktorëve të rrezikut, të lidhur me sëmundjet kronike, ku bën pjesë edhe obeziteti. Miratimi, buxhetimi dhe monitorimi i zbatueshmërisë së tij në të ardhmen do të jetë subjekt i raportimeve të mëvonshme.

160. VKM nr 101, date 4.02.2015 - Paketa e re e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në kujdesin shëndetësor parësor.

161. Të dhëna administrative MSH, 2015

162. Të dhëna administrative MSH, 2015

163. Qendra për Fëmijëri të Shëndetshme (2014) "Raporti i katërt i monitorimit të praktikave të tregtimit të formulave foshnjore dhe ushqimeve të industrializuara për foshnja dhe fëmijë të vegjël", Tiranë, Shqipëri

164. Memorandum mirëkuptimi mbi ushqimin dhe ushqyerjen, datë 18.06.2010 (Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financës, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta



Instituti i Zhvillimit Arsimor në bashkëpunim me ISHP dhe me mbështetjen e UNICEF, përfundoi paketën kurrikulare për edukimin e Ushqyerjes së Shëndetshme në arsimin e detyruar (Klasa 1-9). Ky edukim është pjesë e moduleve “kros-kurrikulare”. 20 shkolla kanë pilotuar modulet në Kukës, Shkodër, Tiranë dhe Durrës. Rreth 300 sesione të hapura edukimi si edhe 10 evente me pjesëmarrjen e mësuesve, nxënësve dhe prindërve janë organizuar gjatë 2013-2014. Në vazhdimësi pritet aplikimi i moduleve në të gjithë shkollat e vendit<sup>165</sup>.

Fushata sensibilizuese janë ndërmarrë për mënyrat e reja dhe më të mira të ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve në Shqipëri, me synim përmirësimin e qëndrueshëm të praktikave të ushqyerjes së fëmijëve dhe reduktimin e kequshqyerjes<sup>166</sup>. Gjatë vitit 2014 janë prodhuar dhe shpërndarë postera me temë: “Hani 5 herë në ditë fruta e perime!” si dhe fletëpalosje për nxënësit e shkollave me temë: “Ushqehu shëndetshëm!”. Në vazhdimësi të fushatës me mesazhin “Jeta e mirë fillon nga një ushqyerje e mirë!”, u shpërndanë në 10 qarqe të vendit Tiranë, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Dibër, Korçë, Berat, Elbasan, Durrës dhe Lezhë, 5 lloje posterash, 4 fletë palosje, libri me receta gatimi për fëmijët nga 6 muajsh në 5 vjeç. Jane hartuar materialet: posterit me temë “Dita fillon me mëngjesin!”, fletë palosja me temë: “Ushqehu shëndetshëm dhe qëndro aktiv!”, fletëpalosja me temë: “Dhjetë këshilla për të qenë të shëndetshëm!”<sup>167</sup>.

## Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe reduktimi i nivelit të sëmundjeve kryesore të fëmijërisë

Përqindja e fëmijëve të vaksinuar sipas kalendarit rutinë vazhdon të jetë mbi 97%. Për të gjithë fëmijët e lindur që nga 1 mars 2014 dy dozat e para të vaksinës së poliomielitit bëhen me IPV. Kjo përbën një element të rëndësishëm në lidhje me përditësimin e kalendarit me vendet e BE-së dhe rritjen e sigurisë së vaksinave.

56

MSH, ISHP në bashkëpunim me organizatat Rome, kanë krijuar një bazë të dhënash me zonat e banuara nga komuniteti Rom (hartë e zonave Rome) në të gjithë vendin. Kështu, të gjitha Drejtoritë e Shëndetit Publik të rretheve janë udhëzuar që të kenë në vëmendje të veçantë edhe trajtimin shëndetësor të kësaj popullate. ISHP bën depistim të zonave ku jetojnë familjet rome dhe egjiptiane për të identifikuar fëmijët e pavaksinuar. Gjatë vitit 2014, ISHP ndërmori iniciativën për të mbuluar me më shumë se 95% të çdo komuniteti dhe ka punuar për të përshtatur të gjithë dokumentet e lidhura me ta, për të përfshirë në këtë mënyrë edhe komunitetin Rom dhe Egjiptianë. Të gjithë fëmijët rom dhe egjiptianë vaksinohen falas edhe kur ato nuk kanë dokumente. Në shumë raste, infermieret që bëjnë vaksinat, bashkëpunojnë me punonjës social, ose mediatorë për të përmirësuar komunikimin me komunitetin dhe për të vaksinuar më shumë.

ISHP me mbështetjen e MSH ka bashkëpunuar me OBSH dhe organizatën PASH (Programi për Teknologji në Shëndetësi), për zbatimin e një sistemi informativ të imunizimit online, i cili fokusohet në integrimin e të dhënave individuale të vaksinimit dhe menaxhimin e vaksinave në të gjitha nivelet. Ky sistem është pilotuar në rrethin e Shkodrës, ku aktualisht janë trajnuar 30 persona dhe punojnë në sistem të gjithë vaksinuesit. Sistemi funksionon online pas një sërë trajnimesh dhe testimesh. Përsa i përket sistemit elektronik të imunizimit, pas trajnimit të

165. ISHP 2014

166. Insituti i Shëndetit Pulbik 2012

167. Të dhëna administrative MSH, 2015

vaksinatoreve në rrethin e Shkodrës janë trajnuar dhe 25 persona nga ISHP dhe Drejtorive të Shëndetësisë të rretheve Fier, Lushnjë, Pukë, Malësi e Madhe, Kurbin, Lezhë, Bulqizë e Kavajë. Në vitin 2014 ISHP ka përgatitur një plan veprimi me buxhetin përkatës për të zbatuar këtë sistem në të gjithë vendin. Më konkretisht, Lezha dhe Malësia e Madhe sapo kanë filluar zbatimin e këtij sistemi. Me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, ISHP do të vazhdojë shtrirjen e këtij sistemi në të gjitha rrethet dhe gradualisht, gjatë pesë viteve në vijim do të mbulohen të gjitha rrethet e Shqipërisë<sup>168</sup>.

## Kontrolli dhe parandalimi i IST/HIV/AIDS

Çështje të lidhura me parandalimin dhe trajtimin e HIV/AIDS janë pjesë e PVF 2012-2015, edhe pse Shqipëria është ende një vend i konsideruar me shkallë të ulët prevalence.

Parandalimi i transmetimit të HIV nga nëna tek fëmija është konsideruar si një nga komponentët kryesorë të Strategjisë Kombëtare të HIV/AIDS. Përgatitja e “Protokollit kombëtar të parandalimit të transmetimit të agjentëve infektivë nga nëna tek fëmijët” dhe “Udhëzuesit të kujdesit shëndetësor parësor për këtë shërbim në qendrat këshillimore të nënës dhe fëmijës”, synojnë të adresojnë nevojat e identifikuara për përmirësim e shërbimit, aksesin dhe uljen e rasteve të transmetimit.

Programi Kombëtar i HIV/AIDS në bashkëpunim me Organizatën e Personave që jetojnë me HIV/AIDS gjatë vitit 2014 kanë realizuar takime në Tiranë dhe Vlorë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve HIV pozitiv. Në rastin e Vlorës, ky bashkëpunim është shtrirë edhe me Zyrën Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Trajtimi i fëmijëve të infektuar me HIV bëhet vetëm në një qendër, Shërbimi Pediatrik, Qendra Spitalore “Nënë Terereza” Tiranë. Qendra Kombëtare e referencës për parandalimin e transmetimit të HIV nga nëna te fëmija shtë e vendosur pranë Spitalit Obstetrik-Gjinekologjik “Koco Gliozheni” në Tiranë. Barnat antiretrovirale për parandalimin e transmetimit nga nëna te fëmija, si dhe ato për trajtimin e fëmijëve me HIV/AIDS janë të disponueshme dhe sigurohen falas nga Ministria e Shëndetësisë.

## Rekomandime

Sigurimi i aksesit për të gjithë fëmijët dhe adoleshentët përmes mbulimit universal të shërbimeve shëndetësore.

Rritja e rolit parandalues të strukturave të shëndetit ndaj dhunës kundër fëmijëve, duke përforcuar praktika si vizitat në familje. Vendosja dhe zbatimi i detyrimit të personelit shëndetësor për raportin e rasteve të abuzimit ndaj fëmijëve.

Përmirësimi i shërbimeve të ndjekjes së mirërritjes dhe zhvillimit të fëmijëve, përmes hartimit të mekanizmave të nevojshëm për zbatimin e protokollove – standardet e shërbimit dhe instrumentat e monitorimit dhe vlerësimit.

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të fëmijës në tre nivelet e kujdesit, nëpërmjet unifikimit të udhëzuesve dhe protokolleve standart për ndjekjen e shëndetit të fëmijës

Rritja e njohurive dhe aftësive të personelit shëndetësor në këto shërbime, nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm të gjithë personelit shëndetësor që punon në këto shërbime

Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore për të realizuar manaxhimin efektiv dhe ofrim cilësor të shërbimeve shëndetësore.

Kostimi i shërbimeve për kujdesin e fëmijëve dhe adoleshentëve për të mundësuar buxhetimin e nevojshëm për një ofrim cilësor të kujdesit shëndetësor.

Miratimi dhe zbatimi i planit kombëtar të ushqyerjes për të adresuar problemet e kequshqyrjes dhe mbiushqyerjes tek fëmijët dhe adoleshentët dhe pasojat që ato sjellin në shëndetin e tyre.

Informatizimi i sistemit të vaksinimit për të siguruar një shërbim cilësor, në kohë dhe që përmbush nevojat e fëmijëve në nevojë, si ata në lëvizje.

Fuqizimi i programeve të prindërimit, përfshirë ato në komunitet me qëllim përmirësimin e praktikave pozitive të kujdesit për fëmijët.

## E drejta për mbrojtje ligjore

Të drejtat e fëmijëve kanë pësuar përmirësime të ndjeshme përmes iniciativave dhe reformave të gjithanshme ligjore dhe institucionale, duke i afruar ato me standardet Evropiane. Ministria e Drejtësisë, së fundmi, ka përfunduar një draft të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, e cila përbën një hap të rëndësishëm në lidhje me zgjidhjen e të gjitha çështjeve ligjore që lidhen me fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijëve nën 14 vjeç si dhe fëmijët viktime dhe dëshmitarë. Pavarësisht draftit të këtij dokumenti strategjik, sfida më e madhe në praktikë mbetet ngritja e një sistemi të drejtësisë miqësore, i cili merr parasysh si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës si dhe zbatimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse me qëllim identifikimin e hershëm të fëmijëve me sjellje delinkuente dhe trajtimin e tyre jashtë sistemit të drejtësisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka marrë masa efektive institucionale për të miturit në përmbushje edhe të prioritetit 5 të Bashkimit Evropian. Trajtimi i të miturve në konflikt me ligjin në sistemin penitenciar, mbështetet në parimin e individualizimit të trajtimit, duke vlerësuar nevojat individuale psikologjike, shoqërore, të moshës, gjinisë, gjendjes shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i dënuari ose i paraburgosuri, faktorët e riskut dhe motivimin për t'u përfshirë në veprimtaritë që organizohen në institucion. Për çdo të mitur të paraburgosur ose të dënuar përgatitet një plan individual rehabilitimi dhe riintegrimi, i cili merr në konsideratë arsimin e tij, vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, dëshirat dhe mundësitë e tij/saj për të ndjekur kurse profesionale ose për të avancuar në arsim<sup>169</sup>.

Për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) për të mitur, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka miratuar një sistem të vlerësimit të performancës së shërbimeve, mbështetur në indikatorë të matshëm. Për institucionet që akomodojnë të mitur, zbatohet një sistem specifik treguesish për vlerësimin e shërbimeve<sup>170</sup>.

Në funksion të përafrimit të legjislacionit të sistemit të burgjeve me standardet e Kombeve të Bashkuara, të cilat garantojnë trajtimin me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të paraburgosurve dhe të dënuarve në sistemin penitenciar, në muajin prill 2014, janë miratuar disa amendime në Ligjin nr. 8328 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve". Këto amendime sanksionojnë parimet bazë të trajtimit të miturve, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës.

### *Fëmijët në konflikt me ligjin*

Gjatë vitit 2013 numri i fëmijëve të denoncuar, bazuar në statistikat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka qenë 1437 në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2014 vetëm 123 raste.

Numri i fëmijëve të dënuar në vite tregon se ka një tendencë në rritje të problematikës, sidomos nga viti 2012 në vitin 2013, nga 380 në 624 fëmijë të dënuar. Ata janë kryesisht djem të dënuar për vepra penale.

169. Të dhëna administrative, Ministria e Drejtësisë, 2015

170. Po aty.

Vite	2012	2013	2014
Fëmijë të dënuar	380	624	691

Nga statistikat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve rezultojnë se në vitin 2014, numri mesatar i fëmijëve në paraburgim çdo muaj është rreth 96 dhe numri mesatar i fëmijëve që vuajnë dënimin me burgim çdo muaj rreth 14. Në 2013, numri mesatar i fëmijëve në paraburgim çdo muaj ishte rreth 84 fëmijë, ndërsa numri mesatar i fëmijëve që vuajnë dënimin me burgim ishte rreth 22. Numri i të miturve në paraburgim mbetet shqetësues dhe fakti se shumica prej tyre ndodhet në paraburgim për vjedhje ose krime ndaj pronës private.

Në muajin Maj 2015 është miratuar Rregullorja e re e Burgjeve. Kjo rregullore përfshin një pjesë të veçantë për të miturit, e cila rregullon disa aspekte procedurale dhe parashikon mekanizma, që garantojnë trajtim sipas standardeve dhe monitorim të rregullt të situatës së të miturve në sistemin e burgjeve.

Në zbatim të planit të Qeverisjes, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka ngritur një sistem motivimi për sjellje pozitive të të miturve dhe forcimin e sistemit të monitorimit të brendshëm<sup>171</sup>.

Fëmijët në konflikt me ligjin gëzojnë të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tyre<sup>172</sup>, të drejtën për ndihmë juridike dhe psikologjike që në kontaktin e tyre të parë me punonjësit e policisë<sup>173</sup>. Megjithatë, jo rrallë procesi i drejtësisë për të miturit nuk është i përshtatshëm dhe miqësor për fëmijët. Marrja e tyre në pyetje bëhet në ambiente të papërshtatshme, nga punonjësit policie që nuk kanë kualifikimin e duhur dhe në disa raste pa ndihmën e një avokati apo psikologu. Një hap pozitiv në këtë drejtim është miratimi i Urdhrit Nr. 300, datë 08.07.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Procedura Standarde Pune për trajtimin e të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake”, me qëllim përcaktimin dhe qartësimin e procedurave që duhet të ndjekin dhe zbatohen punonjësit e Policisë së Shtetit për trajtimin e të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake<sup>174</sup>. Në disa Drejtori Rajonale të Policisë, me ndihmën e donatorëve, është ndërhyrë për krijimin e dhomave të intervistimit të të miturve.

Në IEVP, zhvillohet procesi arsimor i detyrueshëm i ciklit 9 vjeçar për personat me liri të kufizuar. Procesi shkollor në IEVP, zhvillohet në bazë të marrëveshjes midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit, mbi bashkëpunimin rreth procesit arsimor në IEVP. Kurikulat mësimore, planet, regjistri i shkollës dhe dokumentacionet e tjera, janë të njëtrajtshme me shkollat publike, duke qenë se shkollat në IEVP janë vartëse të tyre. Regjistrimi i nxënësve në shkolla kryhet mbi bazën e dokumentit të mbarimit të shkollës. Me përfundimin e shkollës, i mituri përfiton dëftesën nga shkolla përkatëse ku është regjistruar. Në total 45 të mitur kanë përfunduar ciklin mësimor 2013-2014. Aktualisht janë 61 të mitur që ndjekin arsimin e detyrueshëm<sup>175</sup>. Të miturit, gjithashtu, janë të punësuar sipas mundësive që ofrojnë institucionet. Në total, 9 të mitur janë aktivizuar në aktivitetet punësori<sup>176</sup>.

171. Po aty.

172. Neni 28, Kushtetuta e R.Sh. Neni 40/I KDF parashikon se “çdo fëmijë i dyshuar, i akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, ka të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon tek ai ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e tij si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj”.

173. Neni 35, 48-49, Kodi i Procedurës Penale

174. Ky protokoll u përgatit nga Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara dhe Terre des Hommes me kontributin financiar të UNICEF, Bashkimit Europian dhe Save the Children Albania.

175. Të dhëna administrative, Ministria e Drejtësisë, 2015.

176. Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, 2013-2014. Unicef

Personeli mjekësor viziton çdo ditë të miturit dhe kontrollon periodikisht të gjithë të miturit, sipas një grafiku të hartuar nga drejtoria e institucionit.

Elementë të rëndësishëm në edukimin dhe rehabilitimin e të miturve, është trajnimi profesional dhe pajisja me aftësi profesionale. Për këtë qëllim, organizohen kurse profesionale si zdruckhtari, hidraulik, kompjuter, gjuhë e huaj, etj. Aktualisht, MMSR dhe MD kanë miratuar Memorandumin e Bashkëpunimit me qëllim përgatitjen për ri-integrim të personave të paraburgosur dhe të dënuar me burgim, nëpërmjet organizimit të formimit profesional në IEVP, dhe krijimit të mundësive për riintegrimin e tyre në shoqëri, pas lirimit. Formimi profesional i personave të paraburgosur dhe të dënuar me burgim realizohet përmes kurseve të formimit profesional që zhvillohen në ambiente të veçanta të përshtatura për dhënie mësimi dhe praktikë profesionale pranë IEVP. Kurset e formimit profesional në IEVP zbatohen nga Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional. Të rinjtë raportojnë<sup>177</sup> si shumë të rëndësishëm procesin e formimit profesional gjatë kohës që ata vuajnë dënimin, duke qenë se ndihmon që ata të mund të gjejnë një vend pune pasi kanë përfunduar vaujtjen e dënimit. Ndërkohë që, nga ana tjetër është e nevojshme që të zhvillohen programe për një integrim të shëndetshëm të fëmijëve në komunitet pas përfundimit të dënimit.

Bazuar në të dhënat e studimit për sistemin penitenciar në Shqipëri, të realizuar nga Save the Children Albania në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara dhe ARSIS, si dhe intervistimit të 25 fëmijëve në IEVP Kavajë, rezulton se periudha mesatare e paraburgimi është 0-6 muaj dhe vetëm për 2 % prej tyre është më shumë se 18 muaj kohë qëndrimi në institucion<sup>178</sup>.

Administrimi i drejtësisë penale për të miturit, sipas standardeve ndërkombëtare, parashtron si prioritet krijimin e një sistemi bashkëkohor, që synon zbatimin e politikave me një qasje miqësore për riintegrimin e të miturve në konflikt me ligjin. Si rezultat Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë pasur prioritet forcimin e bashkëpunimit me të gjithë aktorët e drejtësisë penale për reduktimin e masave me burgim për të miturit në konflikt me ligjin dhe forcimin e drejtësisë restauruese, si dhe aplikimin e më shumë masave alternative<sup>179</sup>.

Prej vitit 2008, janë të zbatueshme dënimet alternative për të miturit<sup>180</sup>, të cilat përfshijnë: gjysëm-lirinë, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë ose punë në interes publik dhe qëndrimi në shtëpi<sup>181</sup>. Llojet e dënimeve alternative të dhëna nga Gjykatat, gjatë vitit 2013-2014, për të miturit kanë qenë kryesisht punë në interes publik, kohë provë me detyrimin për të kryer një kurs profesional. Të miturve të dënuar me dënime alternative i garantohet e drejta e mbrojtjes dhe konfidencialiteti në dosjen personale. Zbatimi i dënimeve merr në konsideratë moshën, mirëqenien fizike dhe mendore, zhvillimin, kapacitetet dhe rrethanat personale dhe ato shoqërore.

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 622, dt. 17.09.2014 “Për përcaktimin e vendndodhjes dhe kompetencave tokësore të zyrave vendore të Shërbimit të Provës”, janë hapur 22 zyra vendore në gjithë territorin e Shqipërisë duke mundësuar afrimin e këtij shërbimi më pranë të miturve dhe rritjen e zbatueshmërisë me sukses të dënimeve alternative<sup>182</sup>.

177. Takim me të mitur në IEVP Kavajë

178. Po aty.

179. Të dhëna administrative Ministria e Drejtësisë, 2015

180. Ligji Nr. 10024, Datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8331, Datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, VKM Nr. 302, Datë 25.3.2009 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e funksionimit e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”.

181. Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, 2013-2014. Unicef

182. Të dhëna administrative. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, 2015

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës me mbështetjen e UNICEF, në tetor 2014, lançoi programin “Google mapping”, me të cilën bëhet i mundur identifikimi i zyrave vendore të shërbimit të provës si dhe i qendrave pritëse me të cilat mund të bashkëpunojnë për zbatimin e dënimit alternativ për të miturit. Ky program do të ndihmojë në menaxhimin më efektiv të të miturve në konflikt me ligjin, të cilët kanë marrë dënimin alternativ “punë në interes publik” si dhe do të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet gjykatave, njësive vendore dhe shërbimit të provës.

Shërbimi i Provës me mbështetjen e OSBE-së, ka hartuar “Sistemin e Vlerësimit për të Miturit dhe të Rinjtë në Moshë Madhore” me qëllim vlerësimin e rrezikshmërisë së të miturve dhe të rinjve në moshë madhore. Gjithashtu, pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Shërbimit të Provës është ngritur “Sektori i të Miturve, Shërbimeve Komunitare, Lirimit me Kusht dhe Statistikave”, i cili inspekton punën e zyrave vendore me qëllim ruajtjen e standardeve të shërbimit të ofruar, rritjen e cilësisë së tyre si dhe zbatimin e kuadrit ligjor<sup>183</sup>. Pavarësisht ecurisë së deritanishme të Shërbimit të Provës, mbetet ende sfidë mungesa e ambienteve të përshtatshme në funksion të ruajtjes së privatësisë së të miturit gjatë intervistimit të tij. Aktualisht, intervistimi i të miturve bëhet në ambiente të njëjta me të rriturit dhe në prani të personave të tjerë, të dënuar me dënime alternative apo staf i shërbimit të provës dhe nga punonjës të shërbimit të provës të cilët nuk kanë kualifikimin e nevojshëm për të trajtimin e këtyre rasteve. Largësia e vendbanimit nga zyrat e Shërbimit të Provës, bën që të miturit të kenë vështirësi për t’u paraqitur, pasi kjo sjell kosto shtesë për të dhe familjen e tij duke pasur parasysh faktin, se këta fëmijë vijnë nga familje me vështirësi ekonomike.

Dhënia e dënimeve alternative nga gjykata, veçanërisht për të miturit është e një rëndësie të veçantë. Ajo kërkon së pari një bashkëpunim efektiv të të gjithë aktorëve të përfshirë, shërbimit të provës, prokurorisë, gjykatës, organeve shtetërore qendrore dhe organeve të njësive të qeverisjes vendore, OJF etj. Nevojitet gjithashtu më shumë sensibilizim për gjykatësit në dhënien e dënimeve alternative si dhe hapje e zyrave vendore të shërbimit të provës në të gjithë vendin që t’i ofrojnë të miturve mbështetje gjatë kohës së kryerjes së dënimit.

E një rëndësie të veçantë është ngritja e urave të bashkëpunimit ndërmjet shërbimit të provës dhe zyrave të punësimit me qëllim përfshirjen e kësaj kategorie automatikisht si punëkërkues dhe qendrave të formimit profesional, të cilat të mundësojnë ofrimin e kurseve profesionale pa pagesë për këtë kategori. Mbështetje e vazhdueshme për shërbimin e provës është i nevojshëm, duke pasur parasysh ngarkesën e secilit specialist, pra numri i rasteve që ndjek një specialist i vetëm dhe nevojave specifike që paraqet ndjekja e rastit të një të mituri. Për lehtësimin e përmbushjes së detyrimit për t’u paraqitur pranë Shërbimit të Provës, është e nevojshme të zgjerohet numri i zyrave vendore duke e afruar më shumë këtë shërbim me të dënuarit.

Nga analiza vjetore e Shërbimit të Provës ka rezultuar rritje prej 16% në përdorimin e masave alternative të dënimit me burgim për të miturit për vitin 2014 krahasuar me vitin 2013. Për periudhën janar-maj 2015 janë dhënë 163 dënime alternative për të miturit<sup>184</sup>.

Në kuadrin e rritjes së përdorimit të masave alternative të dënimit me burgim për të miturit Shërbimi i Provës ka realizuar disa tryeza të rrumbullakëta me prokuroritë dhe gjykatat në shkallë vendi me fokus ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e dënimeve alternative. Gjithashtu, institucioni i Shërbimit të Provës ka nënshkruar marrëveshje të reja bashkëpunimi me 10 drejtori arsimore

183. Urdhër Nr. 2, datë 11.01.2012 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës”.

184. Të dhëna administrative. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, 2015

rajonale dhe 3 drejtori spitalore rajonale për adresimin më adekuat të çështjeve të integritetit të miturve me dënime alternative përmes orientimit drejt formimit profesional dhe programeve psikosociale të këshillimit dhe rehabilitimit. Bashkëpunimet me shoqërinë civile kanë vijuar të jenë aktive, sidomos në kuadër të organizimit të trajnimeve, studimeve të përbashkëta, aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe integruese për të miturit. Për rrjedhojë, ka patur një ulje të shkallës së braktisjes së shkollave, të shfaqjes së sjelljeve devijante dhe abuzimit me substancat nga të miturit, ndonëse kryerja me sukses e periudhës së provës për të miturit vazhdon të paraqesë sfida për Shërbimin e Provës<sup>185</sup>.

### *Viktimat/dëshmitarët e mitur*

Mbrojtja e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë sanksionohet në mënyrë të përgjithshme, në kuadrin e së drejtës së fëmijëve për mbrojtje të veçantë<sup>186</sup>. Mbrojtja e moralit dhe dinjitetit të fëmijës nga dëmtimi i kundërligjshëm nuk parashikohet në kontekstin e fëmijës si viktimë<sup>187</sup>. Duke marrë parasysh faktin që fëmijët viktimë/dëshmitarë janë të cënueshëm dhe kërkojnë mbrojtje të veçantë, është e nevojshme të merren të gjitha masat për të parandaluar dhe për t'i mbrojtur ata nga dëmtimi, përfshirë kanosjen, hakmarrjen dhe riviktimizimin. Nevoja për të shmangur riviktimizimin është themelore në rastet kur fëmija është viktimë e abuzimeve të rënda siç janë ato seksuale, ku intervistimi i përsëritur i fëmijës nga autoritetet e ndryshme e detyron fëmijën të përjetojë sërish traumën e abuzimit.

### *Drejtësia restauruese*

Institucioni i Shërbimit të Provës ka vijuar të ketë prioritet bashkëpunimin me Fondacionin e Zgjidhjes së Konflikteve dhe Paqimit të Mosmarrëveshjeve, në funksion të rritjes së zbatueshmërisë së praktikave të drejtësisë restauruese për të miturit. Një komponent i rëndësishëm i këtij bashkëpunimi kanë qënë dhe trajnimet e punonjësve të Shërbimit të Provës mbi praktikën e drejtësisë restauruese në ndërmjetësimin e konflikteve viktimë- kundravajtës. Po kështu, gjatë vitit 2014 në bashkëpunim me QSHPLI dhe Save the Children është trajnuar stafi i Shërbimit të Provës për ngritjen e kapaciteteve profesionale në punën me të miturit e dënuar me dënime alternative, ndërkohë që është në fazë implementimi instrumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë për të miturit dhe të rinjtë në moshë madhore<sup>188</sup>.

### *Ndihma juridike falas*

Në vitin 2011 u miratua kuadri ligjor për ofrimin e ndihmë juridike falas<sup>189</sup> dhe përcaktimin e përgjegjësiave konkrete të agjencive shtetërore dhe atyre publike në implementimin e standardeve të ndihmës juridike. U krijua Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike (KSHNJ), i cili më pas miratoi aktet nënligjore të domosdoshme për të bërë të mundur zbatimin e ndihmës juridike. Gjatë vitit 2011, KSHNJ ka refuzuar 27 kërkesa aplikuesish për ndihmë juridike (14 çështje penale dhe 13 çështje civile) për shkak të mangësive në dokumentacion të tyre. Në vitin 2012, KSHNJ ka miratuar dhënien e ndihmës juridike për 8 raste (5 raste penale dhe 3 civile). Duke konsideruar numrin e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe duke patur parasysh se shumë prej krimeve i kanë

185. Të dhëna administrative. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, 2015

186. Neni 54, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

187. Ligji "Për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve".

188. Të dhëna administrative. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, 2015

189. Ligji Nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për Ndihmën Juridike".



rrënjët në kushtet e varfërisë në të cilën ndodhet familja, numri i rasteve që kanë përfituar ndihmë ekonomike falas mbetet shumë i ulët në krahasim me nevojat<sup>190</sup>.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është rritja e kapaciteteve të stafeve të I.E.V.P mbi instrumentet e punës për përgatitjen për ri-integrim të fëmijëve në konflikt me ligjin. Gjatë vitit 2014 janë zhvilluar trajnime ku kanë marrë pjesë 88 përfaqësues të sistemit të referimit në rajon si Zyrat e Punës, Qendrat e Formimit Profesional, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, Komuniteti i biznesit, Shërbimi i Proves etj. Në këtë kuadër janë zhvilluar takime me 96 përfaqësues të insitucioneve qeveritare, joqeveritare si dhe komunitetin e biznesit<sup>191</sup>.

DPB po bashkëpunon me Komitetin Holandez të Helsinkit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve të Holandës për zbatimin e një projekti që synon rritjen e kapaciteteve të stafit të IEVP Vlorë dhe Lezhë për përgatitjen për ri-integrim të miturve në konflikt me ligjin, mbështetur në modelin bashkëkohor YOU-TURN<sup>192</sup>.

Është nënshkruar Marrëveshja Nr. 504, datë 19.05.2014, midis Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Fondacionit “Save the Children” dhe Fondacionit “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”. Si rezultat i nënshkrimit dhe zbatimit të kësaj marrëveshje, Policia e Shtetit ka përfituar trajnim për 44 punonjës policie me temë “Menaxhimi i konfliktëve penale përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit viktimë- kundërvajtës, në rastet e të miturve”. Janë zhvilluar tre seminare për përdorimin e pajisjeve specifike të dhomave të intervistimit të të miturve, në DPQ Fier, Korçë dhe Shkodër. Këto seminare u zhvilluan në bashkëpunim me “Save the Children”. Është zhvilluar edhe trajnimi i punonjësve të policisë, me temë: “Trajtimi i të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake”<sup>193</sup>.

190. Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, 2013-1014. Unicef

191. Të dhëna administrative, Ministria e Drejtësisë, 2015

192. Të dhëna administrative, Ministria e Drejtësisë, 2015

193. [http://www.punetebrendshme.gov.al/files/programs\\_files/Materaili\\_i\\_MPB\\_në\\_kuadër\\_të\\_takimit\\_të\\_Komitetit\\_të\\_Stabilizim\\_Asociimit,\\_Mars\\_2015](http://www.punetebrendshme.gov.al/files/programs_files/Materaili_i_MPB_në_kuadër_të_takimit_të_Komitetit_të_Stabilizim_Asociimit,_Mars_2015)

## Rekomandime

Përmirësimi i kuadrit ligjor, nëpërmjet hartimit dhe adoptimit të një Kodi të drejtësisë për të mitur për ndërtimin e një sistemi drejtësie miqësor ndaj fëmijëve, që krijon mundësinë për një akses të drejtë, efikas dhe në kohë për fëmijët, si edhe për zgjidhje të përshtatshme. Përmirësimi i procedurave dhe praktikave për të reflektuar interesat më të lartë të fëmijës në të gjitha fazat e procesit që mund të gjendet fëmija.

Burgimi dhe paraburgimi i fëmijëve duhet përdorur si masë e jashtëzakonshme vetëm në kushte të një rrezikshmërie të lartë dhe jo si praktikë e zakonshme. Gjithashtu, duhen promovuar alternativat ndaj burgimit dhe burgimi i fëmijëve duhet përdorur si alternativa e fundit. Realizimi i programeve integruese dhe riintegruese të qëndrueshme më qëllim uljen e nivelit të recitvizmit të fëmijëve.

Me qëllim promovimin e dhënies së dënimeve alternativë për të miturit dhe riintegrimin e tyre në shoqëri, është e nevojshme të hartohen programe integrimi në komunitet, të forcohen më tej zyrat e shërbimit të provës përmes ngritjes/përmirësimit të kapaciteteve të punonjësve të shërbimit të provës.

Garantimi përmes legjislacionit, politikave dhe udhëzimevë të një qasjeje multidisiplinare të aksesit dhe shërbimeve të fëmijëve në sistemin e drejtësisë. Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive të qarta për të gjithë profesionistët kryesorë që mbështesin aksesin dhe shërbimet në drejtësi për fëmijët, duke përfshirë policinë, prokurorët, gjyqtarët, avokatët, punonjësit socialë, psikologët, ofruesit e shërbimeve të shëndetit mendor, personelin e burgjeve dhe personelin që mbështet viktimat – dëshmitarë, ndërmjetësit, arsimtarët, ofruesit e drejtësisë informale dhe ata të shëndetësisë. Për një koordinim efektiv, mekanizma dhe protokolle të bashkëpunimit duhet të ngrihen për të mbështetur shkëmbimin, bashkërendimin dhe referimin e informacionit dhe reagimeve rasti pas rasti.





Zhvillimi i kapaciteteve të të gjithë profesionistët që punojnë me fëmijët në kontakt me sistemin e drejtësisë, për të promovuar, respektuar dhe përmbushur të drejtat e fëmijëve.

Me qëllim përmirësimin e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë, të përmirësohen mekanizmat e ankimit të fëmijëve, të hartohen standarde dhe procedura efektive të monitorimit dhe vlerësimit, të përmirësohet mbledhja dhe raportimi i të dhënave me fokus fëmijët në sistemin e drejtësisë. Forcimi i institucioneve të të drejtave të njeriut për të monitoruar e raportuar mbi situatën e fëmijëve në sistemin e drejtësisë. Kjo duhet të shoqërohet me krijimin e mekanizmave të përfshirjes së fëmijëve dhe ndërgjegjësimit të komunitetit të gjerë për përdorimin e strategjive apo instrumentave kombëtarë dhe ndërkombëtarë.









Të sigurohet e drejta e fëmijës për t'u dëgjuar në çdo çështje gjyqësore, në një mënyrë të përshtatshme me moshën dhe miqësore për fëmijën, duke përfshirë çështjet civile dhe penale, si dhe në procedurat administrative që ndikojnë mbi fëmijët në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.














Duhet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për vënien në zbatim të ligjit dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse që të garantohet e drejta për ndihmë juridike falas, si një e drejtë kushtetuese, veçanërisht për fëmijë.











## Progresi i treguesve të Planit të Veprimit






Përshkrimi i realizimit të treguesit	Simboli
Tregues i pamatshëm/ur	
Tregues i porealizuar	
Tregues i realizuar pjesërisht	
Tregues i realizuar plotësisht	

## E drejta për Mbrojtje dhe Përfshirje Sociale












Treguesit	Statusi i Realizimit	Shpjegime
Numri i qarqeve që kanë miratuar strategji rajonale për të drejtat e fëmijëve.		7 nga 12 Qarqe
Numri i raporteve të progresit dhe vlerësimit të zbatimit të strategjive.		2 Raporte vlerësimi (Fier dhe Shkodër)
% e rritjes së buxhetit për fëmijë në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale në çdo qark		
Numri i Njësive të qeverisjes vendore për pilotimin e skemës së re të ndihmës ekonomike		3 Qarqe që janë përfshirë në pilotim (Tiranë, Elbasan dhe Durrës)
Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ndryshimeve të ligjit Nr.9355 dt. 05.12.2006		VKM nr.904 datë 12.12.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot” dhe udhëzimi nr. 9 datë 23.06.2014 në zbatim të tij, i përcakton qartë të gjitha kriteret dhe procedurat e përfitimit të masës së ndihmës ekonomike në zonat pilote.
Numri i NJDF dhe stafit të zyrave të Ndihmës Ekonomike të trajnuar		
Numri i shërbimeve të reja për fëmijë		Hapjes së Qendrës Kombëtare Tranzitore të Emergjencës për Kategoritë në Nevojë si dhe hartimi i standardeve të shërbimeve të emergjencës.
Transformimi i qendrave rezidenciale në Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Korçë		Në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr 55 datë 02.03.2015 “Për Miratimin e Planit të Veprimit të Deinstitutionalizimit për Shtëpinë e Fëmijës Zyber Hallulli”, MMSR, dhe partnerët <sup>194</sup> kanë filluar implementimin e aktiviteteve për transformimin e shërbimeve rezidenciale në shërbime komunitare në këtë institucion.

Numri i shtëpive-familje në shërbimet rezidenciale dhe numri i fëmijëve që trajtohen aty		Shtëpi-familje Tiranë, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Shkodër (OJF)
Raportet e inspektoriatit të shërbimeve		Maj 2012 - Prill 2013: 40 Inspektime Maj 2013 - Maj 2014: 57 Inspektime Maj 2014- Maj 2015: 53 Inspektime
Standartet e reja të miratuara për tipologjitë e reja të shërbimeve për fëmijë		
Harta e shërbimeve sociale në nivel kombëtar dhe sipas njësive të qeverisjes vendore		<a href="http://www.sherbimisocial.gov.al/">http://www.sherbimisocial.gov.al/</a>
Planet zonale ku përcaktohen nevojat e komunitetit për shërbimet për fëmijë		Plane Rajonale Elbasan, Berat, Fier
Numri i kontratave të lidhura me ofrues të shërbimeve për fëmijë		
Raporti i vlerësimit të pilotimit të shërbimit të kujdestarisë		Raporti i publikuar tek: <a href="http://www.unicef.org/albania/Protection-Albania_fostering_evaluation-oct13.pdf">http://www.unicef.org/albania/Protection-Albania_fostering_evaluation-oct13.pdf</a>
VKM e miratuar mbi kujdestarinë		VKM Nr 89 datë 26.01.2012 dhe udhëzimin Nr 6 datë 01.08.2012 “Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurës së shërbimit të kujdestarisë”
Numri i komiteteve të vlerësimit të familjeve të ngritura në 6 bashki		
Numri i familjeve kujdestare të trajnuara		
Numri i anëtarëve të komisioneve që përzgjedhin familjen kujdestare të trajnuar		
Numri i fëmijëve të birësuar		2012-2013: 80 birësime 2013-2014: 41 birësime 2014- 2015: 67 birësime
Monitorime periodike nëpër institucione publike dhe jopublike për zbatimin e afateve ligjore për fillimin e procedurave për birësim		












Hartimi i standarteve të shërbimit të birësimit		
Monitorime të periudhës pasbirësuese		Viti 2012: 40 raporte pasbirësuese Viti 2013-2014: 50 raporte pasbirësuese
Raportet vjetore të gjendjes së realizimit të të drejtave të fëmijëve		Raporte të ASHMDF Viti 2012, 2014, 2015
Mbledhjet e Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve (KKDF) për të diskutuar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në vend, çdo 6 muaj		2012: I 2014: I 2015: I
Rekomandimet e dalë nga mbledhja e KKDF		
Numri i seminareve për qark lidhur me ligjin e ri për të drejtat e fëmijëve dhe aktet e tij nënligjore		2013: 12 seminare (mbulimi i të gjitha qarqeve) <sup>195</sup> Aktivitete të mbështetura nga UNICEF.
Numri i trajnimeve për stafin e ASHMDF		Trajnuar mbi: “Mbrojta e Fëmijëve” “Përmirësimi i sistemit të regjistrimit dhe raportimit të lindjes së Fëmijëve” “Përgjigja e Shërbimeve Publike ndaj Fenomenit të fëmijëve në lëvizje” Etj, etj.
Rritja e numrit të stafit të ASHMDF		2012: 6 persona 2014: 7 persona Rritja me 1 person pranë departamentit të statistikave
Akti nënligjor i miratuar mbi të dhënat		VKM NR 267, datë 12.04.2012 “Për Llojet, Mënyrën e Shkëmbimit të Informacionit dhe të Dhënave Statistikore të Kërkuara nga Agjencia e nga Strukturat Shtetërore Përgjegjëse, në Nivel Qendror dhe Vendor”
Institucionet përgjegjëse përcjellin informacionin statistikor të kërkuar në ASHMDF		2013-2014 78% e NJMF kanë raportuar rregullisht në vitin 2013. Në vitet e tjera???

Numri trajnimeve të sektorit të statistikës në ASHMDF dhe rrjetit të NJDF në qarqe		
Lista e treguesve e përfshirë në legjislacionin për mbledhjen e statistikave		
VKM-të e miratuara për bashkëpunimin		VKM NR 263, datë 12.04.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për bashkëpunimin midis mekanizmave institucionale dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”
Marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OJF		Marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OJF në kuadër të ndërhyrjes “Ndhmë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge” gjatë vitit 2014
Numri i seminareve të organizuara dhe numri i pjesëmarrësve		

## E drejta për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik









Treguesit	Statusi i Realizimit	Shpjegime
Miratimi i akteve nënligjore për regjistrimin e fëmijëve		
Mbajtja e aktit të lindjes për të gjithë fëmijët e lindur brenda vendit		
Mbajtja e aktit të lindjes/regjistrimi për të gjithë fëmijët e lindur jashtë vendit		
Numri i takimeve dhe i pjesmarrësve në nivel lokal për zbatimin e ligjit		
Numri i NJMF dhe NJDF të ngritura		2012: NJMF – 49; NJDF - 10 2014: NJMF- 196; NJDF – 12 2015: NJMF- 202; NJDF – 9
VKM e miratuar për bashkërendimin e punës		VKM NR 266, datë 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”
Udhëzimi i Ministrisë për metodologjinë e veprimit të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve/Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik.		
Takimet e grupeve multidisiplinore për menaxhimin e rastit të fëmijëve në rrezik		
Rregullore të miratuara në qarqet ku janë ngritur Komitetet Drejtues dhe në Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) ku janë ngritur ekipet teknike multidisiplinore		Miratuar nga cdo qark rregullore e sugjeruar nga ASHMDF  Rregulloret për NJQV të pa miratuara.
Numri i trajnimeve dhe personave të trajnuar NJMF/NJDF		
Statusi i punonjësit social i miratuar		Ligji 163/2014 “Për statusin e punonjësit social



Numri i kontrolleve/monitormi		2014: Hartimi i metodologjisë së monitorimit të punës në terren. Monitorime të kryera tek 10 NJMF
Numri i avokatëve në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar për mënyrat e reja të disiplinimit (MRD)		
Numri i mësuesve dhe drejtuesve të shkollave të trajnuar për MRD		Janë trajnuar 2645 drejtores dhe nëndrejtores shkollash, mësues, psikologe, staf nga DAR/ZA <sup>196</sup>
Numri i aktiviteteve promovuese në nivel DAR/ZA		Në të gjitha kopshtet dhe shkollat e arsimit parauniversitar është ngritur këndi i programit COMBI me materiale informuese për MRD <sup>197</sup> .
Emisione televizive dhe radiofonike, artikuj sensibilizues në shtypin e përditshëm për MRD		
Krijimi i Aleancave Rajonale të MRD (DAR/ZA komunitetit i prindërve)		
Raporte mujore për diskutimin e zbatimit të MRD në të gjithë shkollat e arsimit parauniversitar		
Raporte vlerësuese për zbatimin e MRD në fillim dhe në fund të zbatimit të programit COMBI		
Numri i shkollave që kanë psikolog		Viti 2014: 138 psikologe në nivel kombëtar Udhëzuesi për miratim (informacion më poshtë) pritet të përmirësojë strukturën ekzistuese
Trajnimi i psikologëve		
Ngritja e sistemit koordinues dhe supervizues së shërbimit të psikologut në shkolla		








196. MAS

197. ibid

Një Kod Kombëtar sjelljeje, etike ndërmjet të gjithë aktorëve		VKM Nr. 182 datë 13.03.2013 u miratua Kodi i Sjelljes "Për përdorim të sigurtë dhe të përgjegjshëm të rrjeteve të komunikimeve elektronike" ndërmjet operatorëve të komunikimeve elektronike" <sup>198</sup> Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit
Marrëveshje bashkëpunimi ofruesit e shërbimeve të internetit dhe operatorëve celularë etj.		Më 11 shkurt 2014, Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike në bashkëpunim me AKSHI nënshkruan dy memorandume mirëkuptimi për bashkëpunim midis Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, operatorëve celularë
Nënshkrimi i marrëveshjeve të Bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe biznesit		Si më sipër
Miratimi i ndryshimeve në Kodin Penal		Ndryshimet në Kodin Penal me ligjin nr. 144/2013, dt. 20.5.2013, ofrojnë garanci për mbrojtjen adekuate të fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik.
Aktivitete ndërgjegjësuese në të gjithë qarqet e vendit kundër shfrytëzimit për punë të fëmijëve		
Studimi i INSTAT për punën e fëmijëve		
Institucionalizim i bashkëpunimit në përputhje edhe me Ligjin për inspektimin Nr10433 dt 16.6.2011		
Trajnimi i 120 inspektorëve të ISHP		

198. <http://www.akep.al/informacion/legjislatoni/245-ceremonia-e-firmosjes-se-kodit-te-sjelles>  
<http://plus.al/download/Kodi-i-sjelljes-07-02-2013.pdf>

## E drejta për zhvillim dhe arsim

Treguesit	Statusi i Realizimit	Shpjegime
Studimi kombëtar për zhvillimin e hershëm të fëmijëve 0-3 vjec është zhvilluar dhe ka evidentuar problematikat dhe hapat për të ardhmen		
Standardet për çerdhet, për fëmijët 0-3 vjeç, janë përgatitur dhe miratuar		
Buxheti i pushtetit lokal për fëmijët 0-3 vjeç është rritur me 5%		
Programe prindërimi sidomos me fokus shtresat në nevojë janë krijuar dhe implementuar		Protokolli/udhëzuesi i vizitave shëndetësore në komunitet është hartuar dhe miratuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me UNICEF, të zbatuara vetëm në kuadër të një projekti në familjet Rome <sup>199</sup> .
Rritje e numrit të fëmijëve 5 vjeçar me 10% dhe fëmijëve 3-4 vjeçarë në arsimin parashkollor		
Numri kopshteve të reja dhe atyre të rikonstruara		Viti 2011-2012 Total Kopshte 1907 (1761 publike dhe 146 private) Viti 2012-2013 Total kopshte 1941 (1778 publike dhe 133 private) Viti 2013-2014 Total Kopshte 1900 (1773 Publike dhe 127 private) <sup>200</sup> <i>Analizimi i të dhënave tregon se numri total i kopshteve nuk është në rritje, por në 2014 ka 12 kopshte publike me shumë se në 2012 l paraportuar numri i kopshteve të rikonstruara</i>
Rishikimi i kurrikulave të arsimit të detyruar		Urdhri Nr. 323, datë 07.08.2014 “Për pilotimin e kurrikules së re në institucionet arsimore të arsimit bazë nd sistemin arsimor parauniversitar”

199. Informacion i raportuar nga UNICEF tek ASHMDF

200. Ministria e Arsimit dhe Sporteve

Numri i shkollave të reja për arsimin e detyruar



Viti 2011-2012  
Total Shkolla Arsimit Bazë 1473 (1341 publike dhe 132 private)  
Viti 2012-2013  
Total kopshte 1472 (1346 publike dhe 126 private)  
Viti 2013-2014  
Total Kopshte 1464 (1340 Publike dhe 124 private)<sup>201</sup>  
*Analizimi i të dhënave tregon se numri total i shkollave të arsimit bazë është në ulje, dhe në vitin 2014 ka një shkollë më pak publike se në 2012)*

Përqindja e buxhetit të shtetit dhe Përqindja e fondeve që do të alokohen nga të ardhurat e njëjësive të qeverisjes vendore për përhapjen e shkollave të reja dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese në to



Për arsimin bazë  
2012: 1,976,687 ALL Shpenzime kapitale  
2013: 1,245,335 ALL Shpenzime kapitale  
2014: I paraportuar shpenzimi, buxheti i planifikuar 1,800,000 ALL

Për arsimin e mesëm  
2012: pa informacion  
2013: pa informacion  
2014: 1,171,738 ALL shpenzime kapitale  
Arsimi profesional  
2012: 281,628 ALL  
2013: 344,949 ALL  
2014: 193,613 ALL<sup>202</sup>  
I paraportuar informacioni për njësitë e qeverisjes vendore.

Ngritja apo rehabilitimi i bibliotekave; ngritje e kabineteve dhe laboratorëve  
Sigurimi i lidhjes me internet dhe laboratorët e teknologjisë



Hartimi dhe përgatitja e modeleve alternative për trajnimin e mësuesve dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve në përputhje me nevojat e tyre



Rritja e treguesit të regjistrimit me 4.5% ose 160 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 2% për nxënësit me AK



201. Ministria e Arsimit dhe Sporteve

202. Instituti i studimeve bashkëkohore. 2014. Vlerësimi afatshkurtër i buxhetit dhe shpenzimeve në përmbushje të Planit Kombëtar të Veprimit të Fëmijëve 2012-2015. Tiranë: ISB/EU

Programe pune, kurrikula për fëmijët me aftësi të kufizuara që studiojnë në shkolla



Aktet e miratuara për arsimin e fëmijëve me nevoja të kufizuara



Urdhri i Kryeministrit Nr. 232, datë 2.12.2013 “Per ngritjen e grupit ndërinstucional të punës për zyrtarizmin e gjuhës së shenjave në RSh”. Urdhri Nr. 66, datë 18.03.2014 për “Ngritjen e grupit teknik për zyrtarizmin e gjuhës së shenjave në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdimi i shpërndarjes së teksteve falas në arsimin e detyruar 9-vjeçar, për të siguruar aksesin e duhur në arsim të fëmijëve që i përkasin familjeve përfituese të Ndihmës ekonomike.



Kompesimi i teksteve falas ne arsimin baze shprehet përmes shpenzimeve për këtë zë<sup>203</sup> :  
2012: 300,098 ALL  
2013: 277,289 ALL  
2014: 246,000 ALL

Vendosja e transportit për fëmijët dhe mësuesit



2012: 393,803 ALL  
2013: 523,000 ALL  
2014: 560,000 ALL

Uljen e braktisjes shkollore në Arsimin Bazë nën 0.3%







Sipas MAS treguesi zyrtar i braktisjes shkollore vlerësohet të jetë 0.43% 2013-2014

Hartimi i instrumentave dhe modaliteteve për pjesmarrjen e fëmijëve në:  
a.informimin dhe marrjen e vendimeve së bashku me trupin pedagogjik.  
b.të marrin përgjegjësi kundrejt vetvetes, shkollës, familjes dhe komunitetit.  
c.të praktikojnë forma të delegimit dhe përfaqësimit.  
d.të marrin pjesë në bordet drejtuese të shkollës monitorim të zgjedhjes dhe të funksionimit të qeverisë së nxënësve.





Funksionimi i Qeverisë së nxënësve, në shkollat e arsimit parauniversitar realizohet në zbatim të nenit 37 të Dispozitave normative të arsimit parauniversitar.  
Pothuajse në të gjitha shkollat e inspektuarara nga IKAP në 2013<sup>204</sup>, janë ngritur organet kolegjiale si: Bordi i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli Pedagogjik, Qeveria e Nxënësve dhe Këshilli i Disiplinës, por funksionimi i tyre vazhdon të mbetet një sfidë e vazhdueshme. Mungesa e një bashkëpunimi efikas me to reflekton një hallkë “të këputur” të funksionimit të mirë të institucioneve arsimore.

203. Instituti i studimeve bashkëkohore. 2014.Vlerësimi afatshkurtër i buxhetit dhe shpenzimeve në përbushje të Planit Kombëtar të Veprimit të Fëmijëve 2012-2015.Tiranë:ISB/EU

204. Gjedia, R., et al (2013) “Raport Vlerësimi i fushave Klima dhe Etika në Shkollë dhe Kujdesi ndaj Nxënësit” IKAP

Lloji i materialeve të shpërndara		Ky informacion nuk mblidhet apo raportohet nga ndonjë institucion në përgjithësi
Numri i shkollave ku janë shpërndarë		Ky informacion nuk mblidhet apo raportohet nga ndonjë institucion në përgjithësi
Numri i Qeverisë së Nxënësve të trajnuar		Ky informacion nuk mblidhet apo raportohet nga ndonjë institucion në përgjithësi
Lloji i aktiviteteve ku fëmijët kanë ushtruar të drejtën e tyre për pjesmarrje (në shkolla, struktura vendimmarrëse në NJQV)		Ky informacion nuk mblidhet apo raportohet nga ndonjë institucion në përgjithësi

## E drejta për Kujdes Shëndetësor

Treguesit	Statusi i Realizimit	Shpjegime
Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore me 3% në vitin 2014 nga niveli bazë i vitit 2012. Zvogëlimi i vdekshmërisë amtare me 2% në vitin 2014 nga niveli aktual i 2012.		Ministria e Shëndetësisë Viti 2012: vdekshmëria foshnjore (deri në një vjeç) shënon 7.9/1000 për lindje të gjalla. Viti 2013: 7.3/1000 lindje të gjalla  INSTAT: Viti 2013: 8.84/1000 lindje të gjalla  Ministria e Shëndetësisë Viti 2012: vdekshmëria amtare rezulton e ulur në 5.7 vdekje në 100 mijë lindje Viti 2013: 11.8 për 100.000 lindje të gjalla 2014: i paraportuar akoma  <b>Në progres</b> për vdekshmërinë foshnjore. <b>Në regres</b> për vdekshmërinë amtare.
Përqindja e grave shtatzënë që marrin vizitën e parë brenda tremujorit të parë të shtatzënisë		2012: 62% (MSH) 2013: 57.7% (MSH) 2014: i paraportuar akoma 97% e grave shtatzënë kanë marrë vizitën e parë brenda tremujorit të parë të shtatzënisë. <sup>205</sup>
Përqindja e grave që asistohen nga personel mjekësor gjatë lindjes		Viti 2012: 99.06% (MSH) Viti 2013: 99.95% (INSTAT) 99.97% (MSH) 2014: dhe 98% e grave asistohen nga personel mjekësor gjatë lindjes
Numri protokolleve të përgatitura për kujdesin për të porsalindurin.		2012-2014: 6 protokolle të miratuar për kujdesin e të porsalindurit dhe nënës pas lindjes. Puna për këtë ka nisur në 2012, mbështetur nga UNICEF <sup>206</sup> . Protokollet <ul style="list-style-type: none"> <li>Vizitat e kontrollit për kujdesin shëndetësor të nënës pas lindjes</li> <li>Kujdesi paslindjes për foshnjën e porsalindur</li> </ul>

205. Statistikat administrative MSH

206. Ministria e Shëndetësisë, Urdhër No. 62/18.02.2014 dhe 157/26.04.2014

- Menaxhimi i problemeve shëndetsore të nënës pas lindjes
- Menaxhimi i problemeve shëndetsore tek i porsalinduri
- Menaxhimi i shqetësimeve të nënës pas lindjes
- Shenjat kërcënuese të neonatit

Numri punonjësve të trajnuar të kujdesit shëndetësor të përfshirë në ofrimin e kujdesit obstetrikal dhe neonatal, lidhur me praktikat e kujdesit holistik për lindjen dhe porsalindurin



Numri institucioneve shëndetësore të akredituar për menaxhimin e ushqyerjes me gji



2012: 5 institucione  
2013: 8 institucione  
2014: 9 institucione (nga 12 në gjithë Shqipërinë)

Numri i personalit shëndetësor të trajnuar për ushqyerjen me gji dhe çështjet gjinore lidhur me të.



2013: 40 punonjes te rretheve Gjirokastrë, Delvinë, Sarandë, Shkodër  
2014: 170 punonjës të shëndetësisë, shërbimi kujdesit parësor shëndetësor

Treguesit e ushqyerjes me gji të përcaktuar dhe të agreguar sipas gjinisë, vendndodhjes dhe gjendjes social ekonomike dhe të mbledhur periodikisht.



Tregues i plotësuar në vitin 2013 (Instituti i Shëndetit Publik).

Numri fushatave në media lidhur me ushqyerjen me gji



Udhëzuesit dietetikë për fëmijët të përgatitur sipas moshës dhe gjinisë



2012-2014: 6 Udhërrëfyes janë hartuar dhe miratuar <sup>207</sup>  
Hapat për një ushqyerje të sukseshme me gji në komunitet  
Shtesat në mikronutiente tek femijët  
Ushqyerja e femijës me formule foshnjore  
Fillimi i ushqyerjes shtesë tek femijet  
Ushqyerja me gji tek nënat me HIV/AIDS  
Ushqyerja me gji në rast sëmundjeje të nënës dhe kur trajtohet me barna



Protokollet për ndjekjen e rregullt të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve nga kujdesi parësor shëndetësor



2012-2014: 6 Udhërrëfyes janë hartuar dhe miratuar <sup>208</sup>  
Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 0-6 muajsh  
Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 6-24 muajsh  
Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 2-6 vjeç  
Monitorimi i zhvillimit të fëmijës 0-6 vjeç  
Ndjekja e rritjes sipas kurbave të rritjes  
Vleresimi i dëgjimit tek fëmijët 0-6 vjeç  
Vleresimi i shikimit tek fëmijët 0-6 vjeç

Numri i treguesve lidhur me ushqyerjen e fëmijës të përfshira në sistemin e monitorimit të performancës së qëndrave shëndetësore



Numri i personelit shëndetësor të trajnuar për ushqyerjen dhe këshillimin për ushqyerjen.



Numri i trajnimeve të kryera



Kurrikulat shkollore për ushqyerjen të përgatitura dhe të përfshira në programet shkollore.



Nxënësit e klasave 1-9 të arsimit bazë janë prezantuar me kurrikulat e edukimit mbi ushqyerjen, hartuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit. Ky edukim është pjesë e moduleve kros kurrikulare.

Përqindja e personelit arsimor të trajnuar për rëndësinë e ushqyerjes dhe aktivitetit fizik



Numri fushatave promociionale lidhur me aktivitetin fizik për fëmijët



Viti 2013-2014: 5 fushata <sup>209</sup>

Përqindja e fëmijëve të vaksinuar sipas kalendarit rutinë



2012-2014.  
Përqindja e fëmijëve të vaksinuar sipas kalendarit rutinë për të tre vitet është mbi 97%

208. Ministria e Shëndetësisë, Urdhër No. 62/18.02.2014 dhe 157/26.04.2014

209. Ky informacion është raportuar nga UNICEF tek ASHMDF, por pa detaje mbi fushatat.

Numri vaksinave te reja te përfshira në kalendarin kombëtar të vaksinimit



2012-2014: I - Vaksina e IPV  
Për të gjithë fëmijët e lindur që nga I Mars 2014 dy dozat e para të vaksinës së poliomielitit bëhen me vaksinën inaktive IPV. IPV nuk është antigen i ri, por ndryshim i llojit të vaksines nga ajo orale me pika në atë inaktive me injeksion.

Përqindja e popullatës rome të vaksinuar sipas kalendarit rutinë



Numri i personelit shëndetësor të trajnuar lidhur me imunizimin, dhe sistemin e raportimit



Viti 2012: 500  
Viti 2013: 200  
Viti 2014: 600  
*Burimi: Instituti i Shëndetit Publik*

Numri i personelit shëndetësor të trajnuar për zinxhirin ftohës



**Viti 2012: 500**  
75 persona të ritrajnuar për pajisjet e reja si frigoriferët ice-lined dhe rregjistruesit e temperaturave (Fridge-Tag). Këta persona kanë trajnuar në vazhdim të gjithë stafin vaksinator në Shqipëri.  
**Viti 2013: 200**  
**Viti 2014:** Në fund të 2014 është parashikuar trajnimi për një pajisje të re monitoruese të temperaturave për rreth 600 punonjës sipas skemës në komentimin e mësipërm.

Numri i kontrolleve të bëra për sëmundjet infektive dhe joinfektive.



Numri i aktiviteteve promovionale, edukimi shëndetësor i komunitetit, familjeve, lidhur me rëndësinë e vaksinimit të fëmijës. Fuqizimi i sistemit ALERT



Ky tregues nuk mblidhet dhe raportohet nga asnjë institucion.

Numri i aktiviteteve promovionale dhe edukuese për parandalimin e sëmundjeve infektive/ higjena ushqimore, vetjake dhe e ambientit, masat mbrojtëse ndaj sëmundjeve ngjitëse, etj












Ky tregues nuk mblidhet dhe raportohet nga asnjë institucion.

Numri i temave/orëve mësimore të zhvilluara në shkollë mbi sëmundjet infektive



Ky tregues nuk mblidhet dhe raportohet nga asnjë institucion.

Observatori i shëndetit në ISH		2012-2013: Në proces diskutimi për funksionin dhe mënyrat e punës së tij 2013-2014: Asnjë ecuri zhvillimi
Protokollet e unifikuara, rregulloreve, etj për monitorimin e rregullt të rritjes dhe zhvillimit të fëmijës		Hapat për një ushqyerje të sukseshme me gji në komunitet Shtesat në mikronutiente tek femijët Ushqyerja e femijës me formule foshnjore Fillimi i ushqyerjes shtesë tek femijet Ushqyerja me gji tek nënat me HIV/AIDS Ushqyerja me gji në rast sëmundjeje të nënës dhe kur trajtohet me barna
Numri i qendrave shëndetësore që ofrojnë ndjekjen e rritjes dhe zhvillimit të fëmijës		2012-2014: 413 (të gjitha Qendrat Shëndetësore)
Përqindja e fëmijëve të moshës 0-1 vjeç që marrin vizitat e detyrueshme sipas protokollit klinik		Ky informacion nuk mbledhet dhe raportohet nga Insituti i sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.
Numri i trajnimeve dhe personelit të trajnuar për monitorimin e rritjes, zhvillimit si dhe përmirësimin e aftësive këshilluese për shëndetin e fëmijës.		Mbështetur në kuadrin rregullator të miratuar, u hartuan module të akredituara të trajnimit për ofruesit e shërbimit për monitorimin e rritjes dhe ushqyerje
Numri personelit te trajnuar		
Numri i komunave që janë përfshirë në modelin e MISF komunitar		Viti 2012-2013: 70 mjek dhe 40 infermierë të Kujdesit Shëndetësor Parësor Korçë 45 mjek familjeje Durrës Viti 2013-2014: I paraportuar
Numri i fëmijëve dhe nënave me HIV/AIDS		Specialistët e Institutit të Shëndetit Publik raportojnë shqetësimin e formulimit të treguesit për nënat me HIV/AIDS. Ato sugjerojnë zëvendësimin e tij me një tregues “Nr i grave shtatzene te testuara per HIV/AIDS rezultuar me status pozitiv”.
Numri qendrave të referencës nëpër maternitete dhe që janë të pajisuara me reagentë dhe pajisje laboratorike për HIV/AIDS		Viti 2012-2014: 1 Qendra Kombëtare e referencës për parandalimin e transmetimit të HIV nga nëna te fëmija pranë Spitalit Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni” në Tiranë.

Numri qendrave shëndetësore që ofrojnë trajtim për HIV/AIDS



---

Numri i materialeve informative për HIV/AIDS të përgatitura dhe shpërndara



---

Ofrimi i egzaminimeve dhe trajtimi i fëmijëve që vuajnë me HIV/AIDS, në një qendër të specializuar










Trajtimi i femijeve të infektuar me HIV bëhet vetëm në I qendër, Shërbimi i Pediatriisë, Qendra Spitalore “Nënë Tereza”, Tiranë.

---

Numri i fushatave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që vuajnë me HIV/AIDS



## E drejta për Mbrojtje Ligjore

Treguesit	Statusi i Realizimit	Shpjegime
Ulja e kohëzgjatjes së mbajtjes në paraburgim të të miturve (vlerësohet: 5-7 muaj, synimi: 2-4 muaj).		
Dekreti i Presidentit për seksionet e të miturve në gjykatat e shkallës së parë		
Miratimi i ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale		
Numri i trajnimeve dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mitur me të trajnuar me praktikat më të mira në administrimin e drejtësisë për të mitur.		
Përqindja e të miturve në konflikt me ligjin të devijuar nga procesi gjyqësor dhe referuar në masa alternative të dënimit me burgim (vlerësim: 20%, synimi: 40%)		
Protokolle, rregullore për zbatimin e dënimeve alternative për të miturit		<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës me mbështetjen e UNICEF, në Tetor 2014, lancoi program “Google mapping”, me të cilën bëhet i mundur identifikimi i zyrave vendore të shërbimit të provës si dhe i qendrave pritëse me të cilat mund të bashkëpunojnë për zbatimin e dënimit alternativ për të miturit.</p> <p>Me Urdhrin Nr. 100, datë 21.02.2014 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të provës”, numri i stafit të shërbimit të provës është rritur nga 104 në 134 punonjës të arsimuar në fushën e drejtësisë, punës sociale dhe psikologjisë.</p>
Krijimi i dhomës së ndërmjetësve		Në mbështetje me Ligjin nr.10385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, më datë 07.07.2013 , nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë dhe JUST-USAID, datë, 07.07.2013 u zhvillua Mbledhja e parë e Ndërmjetësve

% e të miturve në institucionet e paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit, që ndjekin arsim të detyruar (vlerësim: ska, synimi: 100% e të miturve që nuk kanë kryer arsimimin e detyruar ndjekin shkollën).



Viti 2013-2014:  
Në IEVP, zhvillohet procesi arsimor i detyrueshëm i ciklit 9 vjeçar për personat me liri të kufizuar. Procesi shkollor në IEVP, zhvillohet në bazë të marrëveshjes midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit, mbi bashkëpunimin mbi procesin arsimor në IEVP. Kurrikulat mësimore, planet, regjistri i shkollës dhe dokumentacionet e tjera, janë të njëtrajtshme me shkollat publike, duke qenë se shkollat në IEVP janë vartëse të tyre. Regjistrimi i nxënësve në shkolla kryhet mbi bazën e dokumentit të mbarimit të shkollës. Me përfundimin e shkollës, i mituri përfiton dëftesën nga shkolla përkatëse ku është regjistruar. Në total 45 të mitur kanë përfunduar ciklin mësimor 2013-2014. Të miturit, gjithashtu, janë të punësuar sipas mundësive që ofrojnë institucionet. Në total, 9 të mitur janë të aktivizuar në aktivitetet punësimi.<sup>211</sup>









% e të miturve që kryejnë programe formimi profesional dhe programe rintegrues (vlerësim:50%, synimi: 90% kryejnë programe formimi profesional dhe programe rintegrues).



Viti 2014:  
MMSR dhe MD janë në fazën e rishikimit të Memorandumit të Bashkëpunimit me qëllim përgatitjen për ri-integrim të personave të paraburgosur dhe të dënuar me burgim, nëpërmjet organizimit të formimit profesional në IEVP, dhe krijimit të mundësive për ri-integrimin e tyre në shoqëri, pas lirit. Formimi profesional i personave të paraburgosur dhe të dënuar me burgim do të realizohet përmes kurseve të formimit profesional që do të zhvillohen në ambiente të veçanta të përshtatura për dhënie mësimi dhe praktikë profesionale pranë IEVP. Kurset e formimit profesional në IEVP do të zbatohen nga Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik.

210. [http://www.dhkn.gov.al/?page\\_id=5909](http://www.dhkn.gov.al/?page_id=5909)

211. Informacion I dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve tek ASHMDF

Treguesit për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të miratuara		
Ligji dhe akte nënligjore të miratuara për zbatimin e masave educative për fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale.		
50 % e të miturve që kryejnë krim dhe janë nën moshën e përgjegjësisë penale të përfshirë në programe edukuese		Sipas legjislacionit Shqiptar të miturit nën moshën 14 vjec përjashtohen nga ndjekja penale, por ata mund të jenë subjekt i masave edukuese apo rehabilituese <sup>212</sup> . Këto programe nuk janë aplikuar asnjëherë për shkak të mungesës së infrastrukturës së nevojshme <sup>213</sup> .
Hartimi i një set treguesish		
Rregullimet në KPP, KP të miratuara		
Protokolle dhe sistemi i monitorimit të trajtimit të miturve si viktime dhe dëshmitarë		
Ndryshime në infrastrukturën e policisë për mjedise miqësore ndaj të miturve		Viti 2013 Me mbështetjen e organizatës Save the Children, Albania, janë ngritur dhoma të intervistimit miqësor për fëmijët në 6 komisarate të policisë së Tiranës.
Numri i trajnimeve dhe i personave të trajnuar (gjykatë, prokurorë, polici gjyqsore, etj)		

212. Neni 12, 46 Kodit Penal.

213. Xhafellari, M., Gjoni, O., 2013 Fëmijët nën moshën për përgjegjësi penal. Tirana: ARSIS/QSHPLI/Save the Children, p. 28

## Shtojca A

### Kuadri Ndërkombëtar për të Drejtat e Fëmijëve

Protokolli opsional mbi procedurat e komunikimit	2013
Konventa e këshillit të europës mbi parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje	2012
Konventa europiane mbi statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martese	2011
Konventa europiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve	2011
Konventa e këshillit të europës për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit	2009
Protokolli opsional mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosuar	2008
Protokolli opsional mbi trafikimin e fëmijëve, prostituimit të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve	2008
Konventa e Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve	2007
Konventa mbi mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrant dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre	2007
Protokolli opsional i parë dhe i dytë i marrëveshjes ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike	2007
Konventa për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja e detyruar	2007
Konventa e këshillit të europës për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore	2006
Konventa mbi juridiksionin, ligjin e ushtruar, njohjen, implementimin dhe kooperimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve	2005
Konventa mbi juridiksionin, ligjin e aplikuar, njohjen, detyrimin dhe kooperimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve	2005
Konventa për reduktimin e pashtetësisë	2003
Konventa në lidhje me statusin e personave pa shtetësi	2003
Protokolli opsional i konventës mbi eliminimin e diskriminimit kundër grave	2003
Protokolli kundër kontrabandës së migrantëve nga toka, deti dhe ajri, duke suplementuar konventën e kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar transkombëtar	2002
Protokolli për të parandaluar, frenuar dhe dënuar trafikimin e personave, vecanërisht gra dhe fëmijë, duke suplementuar konventën e kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar transkombëtar	2002
Konventa kundër krimit të organizuar transkombëtar	2002
Karta sociale europiane	2002
Konventa mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe kooperimin për birësimin e fëmijëve jashtë vendit	2000
Konventa në lidhje me ndalimin dhe veprimin e menjëhershëm për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve	2000



Konventa europiane dhe protokollet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirisë themelore	1996
Konventa europiane për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit degradues ose çnjerëzor	1996
Konventa kundër torturës dhe trajtimeve të tjera ose dënimit degradues ose çnjerëzor	1994
Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial	1994
Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave	1994
Konventa mbi të drejtat e fëmijës	1992
Konventa dhe protokollin në lidhje me statusin e refugjatëve	1992
Konventa mbi të drejtat civile dhe politike	1991
Konventa mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore	1991
Konventa e lirisë së shoqatës dhe mbrojtjes së të drejtës për tu organizuar	1957

## Konventat e ratifikuara të ILO

<b>Konventat ILO të përzgjedhura të ratifikuara nga Shqipëria</b>	
Konventa e formave më të këqija të punës së fëmijëve	2001
Konventa e moshës minimale	1998
Konventa e zhdukjes së punës së detyruar	1997
Konventa e diskriminimit (punësimi dhe profesioni)	1997
Konventa në lidhje me punën e detyruar ose të detyrueshme	1957

## Shtojca B

### Kuadri rregullator kombëtar

Ligjet që përfshijnë/prekin fëmijët	Viti
Për policinë e shtetit	2014
Mbi përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuar	2014
Rezoluta mbi mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në Shqipëri	2013
Arsimi parauniversitar	2012
Mbrojtja e të drejtave të fëmijës	2010
Mbrojtja kundër diskriminimit	2010
Për ndihmë juridike	2009
Statusi civil	2009
Procedurat e birësimit dhe Komiteti Shqipëtar i Birësimeve	2007
Masat kundër dhunës në familje	2006
Për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi me alkoolin	2006
Për ndihmën dhe shërbimet sociale	2005
Integrimi dhe ribashkimi familjar i personave me azil në Republikën e Shqipërisë	2003
Kodi i familjes	2003
Azili në Republikën e Shqipërisë	2002
Shëndeti riprodhues	2002
Promovimi dhe mbrojtja e ushqyerjes me gji	1999
Statusi i jetimëve	1996
Mbrojtja e të miturve që punojnë (VKM)	1996
Kodi Penal	1995
Kodi i Proçedurës Penale	1995
Kodi i Punës	1995
Kodi Civil	1994

## Shtojca C

### Kuadri Strategjik lidhur me fëmijët

Strategjia	Komente	Periudha
Plani i veprimit për të rinjtë	Plani bazohet në 6 kolona kryesore 1) Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e vendimarrjes; 2) Nxitja e punësimit të të rinjve nëpërmjet politikave efektive që kërkon tregu i punës; 3) Shëndeti, sporti dhe mjedisi; 4) Edukimi i të rinjve; 5) Mbrojtja sociale; 6) Kultura dhe vullnetarizmi.	2015-2020
Strategjia e mbrojtjes sociale	Angazhimi i MMSR që të marrë të gjitha hapat e nevojshëm në mënyrë që lidhjet dhe sinergjitë të ekzistojnë midis politikave në mënyrë që të gjithë qytetarët shqiptarë të jenë të siguar, të mbrojtur nga rënia në varfëri, dhe të ndihmohen dhe fuqizohen për menaxhimin sa më të mirë të rreziqeve e goditjeve përgjatë periudhave aktive dhe joaktive të jetës.	2015- 2020
Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar (APU)	Strategjia e krijuar nga MeES orienton politikat afatmesme dhe afatgjata sektoriale për përsosjen e APU-së, sipas vizionit të Qeverisë. Strategjisë parashtrohet përparësitë arsimore kombëtare dhe përbën një platformë gjithëpërfshirëse, brenda së cilës të mund të kontribuojnë aktorët institucionalë dhe grupet e interesuara.	2014 – 2020
Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi	Strategjia e krijuar nga MMSR ka në qendër të saj rritjen e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave efikase të tregut të punës, ofrimin e arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, si dhe fuqizimin e tregut të punës dhe të sistemit të kualifikimeve.	2014 – 2020
Përfshirja sociale – Dokument i Politikave	Pikëpamja e tij është për një shoqëri përfshirëse ku shtetasit shqipëtarë kanë akses të pakufizuar në shërbimet publike të cilësisë së lartë për të lehtësuar dhe mbështetur pjesëmarrjen e tyre aktive në shoqëri pavarësisht të ardhurave, gjinisë, moshës, paaftësive, origjinës etnike, orientimit seksual, rezidencës apo bindjeve.	2014-2020
Strategjia e anti-trafikut dhe Plani i veprimit	Një komponent i vecantë i planit të veprimit targeton fëmijët.	2014-2017

Plani i veprimit për fëmijët	Fokusimi tek të drejtat e fëmijës për zhvillim, edukim, kujdes shëndetësor dhe mbrojtje ligjore.	2012-2015
Barazia gjinore dhe reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.	Ndër-sektoriale, kërkon të garantojë integrimin gjinor me nëpërmjet: 1) mekanizmave të përforcuara ligjore dhe institucionale, 2) pjesëmarrjen së shtuar të grave në vendimmarrje, 3) fuqizimit ekonomik të grave dhe vajzave; 4) reduktimit të dhunës me bazë gjinore.	2011-2015
Shëndeti riprodhues	Strategjia e hartuar nga Ministria e Shëndetësisë identifikon komponentët e Shëndetit Riprodhues, duke përfshirë Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës dhe Shëndetin e Adolehentëve	2010-2015
Strategjia Kombëtare dhe Plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuar	Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuar konsiderohet si një dokument gjithëpërfshirës i politikave në arritjen e të drejtave ligjore të këtyre individëve, bazuar në parimet e barazisë dhe antidiskriminimit. Fëmijët janë në fokus të këtyre dokumenteve, sic është rasti për arsim, dhe akses në shërbime të tjera	2005-2015

# Raporti i Implementimit të Planit të Veprimit për Fëmijë

2012- 2015



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



**Save the Children**